

Përmes Solidaritetit të Grave deri tek Paqja e Drejtë



Koalicioni i Grave për Paqe
Beograd Prishtinë



Përmes Solidaritetit të Grave deri tek Paqja e Drejtë

Raport i bazuar në Konferencën e Dytë Vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe





Përmes Solidaritetit të Grave deri tek Paqja e Drejtë

Koalicioni i Grave për Paqe

Mirënjohjet

Ky publikim është rezultat i punës së madhe të më se gjashtëdhjetë aktivisteve të cilat morën pjesë në konferencën e dytë vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe. Pa energjinë që ato shpenzuan gjatë identifikimit të pengesave dhe prioritetëve të koalicionit, njohurinë e tyre mbi çështjet me të cilat përballen komunitetet e tyre, dhe përkushtimin për të bashkëpunuar në drejtim të ndërtimit të një të ardhme të përbashkët, nuk do të ishte i mundshëm as publikimi i këtij materiali. Atyre u shprehim falënderim të posaçëm që bënë që kjo konferencë të jetë një ngjarje energjike që ofroi rezultate të vlefshme.

Koalicioni i Grave për Paqe shpreh mirënjohje për partnerët tonë ndërkombëtarë që ofruan përkrahje morale për përpjekjet tona dhe paraqitën përvojat e tyre në diskutimet e realizuara gjatë konferencës: përfshirë Fondin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM), Fondacionin Kvinna till Kvinna, Urgent Action Fund, Gratë në të Zeza – Izrael, Rachel Wareham dhe Global Fund for Women.

E rëndësishme së veçantë është se Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Demokraci (UNDEF) ka ofruar përkrahjen financiare të domosdoshme për organizimin e konferencës dhe përpilimin e këtij publikimi.

Përmbajtja

Hyrje	1
Historia e Koalicionit të Grave për Paqe	1
Çështjet e Identifikuara gjatë Konferencës së Parë të Koalicionit të Grave për Paqe	2
Qëllimi i Konferencës së Dytë	3
Strategjia për të ardhmen	4
Pengesat Kryesore për Proceset e Drejtësisë Tranzicionale dhe Arritjen e Paqes së Drejtë	4
Objektivat Strategjike	8
Programet dhe Aktivitetet e Propozuara për vitet 2008-2010	9
Agjenda e Konferencës	13
Dita e parë. Drejtësia Tranzicionale	15
Fjalët Hyrëse	15
Drejtësia Tranzicionale – Qasje feministe: Përvoja e Grave në të Zeza - Stasha Zajoviq	17
Roli i Shoqërisë Civile nga Serbia në Drejtësinë Tranzicionale dhe Modelet e Drejtësisë Tranzicionale - Biljana Kovaceviq-Vuco	19
Modelet e Drejtësisë Tranzicionale: Përvoja e Grave në të Zeza – Millosh Urosheviq	21
Nga Mosdëshkimi tek Përgjegjësia dhe Drejtësia - Veprorë (Lola) Shehu	22
Drejtësia Tranzicionale: Roli i Shoqërisë Civile, Vështirësitë dhe Sfidat - Nexhmije (Cuca) Fetahu	25
Përmbledhje	25
Rekomandimet e Grupit Punues mbi Drejtësinë Tranzicionale	29
1. Modelet e Drejtësisë Tranzicionale dhe Përvojat e Grave në të Zeza	29
2. Vizita Vendeve të Krimeve të Kryera në Emrin Tonë dhe Politika e Faljes	30
3. Falja: Brengat Etike Feministe dhe Përcjellja e Gjykimeve	31
4. Etika dhe Përgjegjësitë Feministe: Roli i Shoqërisë Civile në Drejtësinë Tranzicionale	31
Vërejtjet Përmbledhëse	33

Aktivitetet tjera	33
Dita e dytë. Siguria dhe Rrjetëzimi Horizontal	35
Fjalët Hyrëse	35
Ridefinimi i sigurisë: Përvoja e Grave në të Zeza, Izrael - Haya Shalom	37
Solidariteti i Grave: Përvojat e Mira dhe Vështirësitë - Marija Perkoviç	39
Unë jam grua solidare? - Jasmina Mitrinoviç	42
Gratë, Paqja dhe Siguria - Mima Rashiç	44
Gratë, Paqja dhe Siguria: Përpjekjet e Aktivisteve nga Kosova drejt Implementimit të Rezolutës 1325 – Igballe Rogova	45
Aspektet Rajonale të Sigurisë të Ndërlidhura me Rezolutën 1325 -Flora Macula	50
Rekomandimet e Grupit Punues: Rrjetëzimi Horizontal	55
Përmbledhja e Konferencës, Konkluzionet dhe Hapat e Ardhshëm	61
Bashkëpunimi i KGP në të ardhmen: Përshtypjet dhe Pritjet pas Konferencës	
Në Krahët e Faljes Politike: Përshtypjet dhe Pritjet e Aktivistëve pas Vitit të Dytë në Strugë	63
Letra aktivisteve nga Kosova pas konferencës së dytë	69
Letra aktivisteve nga Serbia pas konferencës së dytë të KGP	70
Material leximi mbi çështjet e ndërlidhura me konferencën	71
Etika Feministe e Përgjegjësisë - Milka Roshiç	71
Përcjellja e Krimeve të Luftës: Dënimi i Krimeve – Rruga drejt Paqes së Drejtë - Gordana Stojilkoviç	73
Nga Krimi i Organizuar tek Gënjeshtria e Organizuar: mbi gjykimin e Suharekës – Millosh Urosheviç	76
Vizita Vendeve ku janë Kryer Krime në Emrin Tim – Lilana Radovanoviç	84
Arti i rezistencës: Motivët, Simbolizmi dhe Simbolet në Estetikën e GZ – Nevenka Marinkoviç dhe Snezhana Tabaçki	87
Lista e pjesëmarrësve në konferencë	91

Hyrje

Ky publikim përshkruan procesin, rezultatet dhe rekomandimet nga konferenca e dytë vjetore e Koalicionit të Grave për Paqe, të quajtur “Përmes Solidaritetit të Grave deri tek Paqja e Drejtë”, që u mbajt në Strugë të Maqedonisë mes datave 31 gusht – 3 shtator të vitit 2007. Me ndihmë financiare nga Fondi i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Demokraci (UNDEF) dhe përkrahje morale e teknike nga Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM), Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) dhe Rrjeti i Grave në të Zeza (RrGZ) nga Serbia organizuan këtë konferencë për të vlerësuar punën e deriatëhershme të Koalicionit të Grave për Paqe, planifikuar iniciativat e përbashkëta të aktivisteve Serbe dhe Kosovare, dhe për të sjuar këtë raport që përmban strategjinë për punën e koalicionit në të ardhmen. Gjithsej, 69 gra nga Serbia dhe Kosova, si dhe mysafirë ndërkombëtarë, morën pjesë në konferencë.

Historia e Koalicionit të Grave për Paqe

Koalicioni i Grave për Paqe u themelua nga Rrjeti i Grave në të Zeza dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës, në mars të vitit 2006, si iniciativë e pavarur qytetare që bazohet në solidaritetin e grave që tejkalon ndasitë etnike dhe fetare, si dhe kufijtë dhe barrierat shtetërore. Koalicioni vepron duke u bazuar në parimet vijuese:



Koalicioni i Grave për Paqe lufton për arritjen e paqes së drejtë dhe të qëndrueshme dhe punon për përfshirjen e grave në proceset e ndërtimit të paqes si partnerë të barabartë, duke theksuar faktin që gratë nuk janë viktima, në fakt ato janë mbijetues të luftës dhe akterë dinamikë të lëvizjeve paqësore.



Koalicioni i Grave për Paqe evokon fuqimisht për implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, si dhe për avancimin e pozitës politike, ekonomike dhe sociale të grave, duke kundërshtuar tendencat specifike kombëtare dhe proceset regresive që e pengojnë atë në arritjen e synimeve të veta.



Koalicioni i Grave për Paqe bashkëpunon dhe përfshin në punën e vet të gjithë aleatët relevantë për kauzën e tij, duke e mbajtur autonominë e vet.

Që nga themelimi, Koalicioni i Grave për Paqe ka iniciuar fushata të shumta avokimi, që parimisht ndërlidhen me monitorimin e negociatave mbi statusin final politik të Kosovës. Koalicioni ka mëtuar të ofrojë një opinion analitik dhe alternativ mbi statusin e Kosovës nga një këndvështrim human e jo politik. Deklarata e parë e koalicionit adresonte dështimin e vendimmarrësve në

Kosovë dhe Serbi që të përshijnë gratë në procesin e negociatave mbi statusin politik të Kosovës. Deklarata e dytë kishte për qëllim t'i informojë negociatorët si dhe qytetarët e Kosovës dhe Serbisë mbi synimet e koalicionit që të mbrojnë dhe rezervojë trashëgiminë kulturore, që atëbotë, diskutohej nga negociatorët në Vjenë.

Si pjesëtarë të Koalicionit, RrGZ kanë qenë të përfshira në monitorimin e proceseve gjyqësore lidhur me krimet e luftës dhe aktivisht kanë përkrahur dëshmitarët dhe viktimat gjatë dhënies së dëshmimeve, aktivitete këto që përfshihen më në detaje në fjalimet e aktivisteve të Rrjeti i Grave në të Zeza - Serbi që janë dhënë në vijim të këtij raporti.

Çështjet e identifikuara gjatë Konferencës së parë të Koalicionit të Grave për Paqe

Përveç aktiviteteve tjera, Koalicioni i Grave për Paqe mbajti konferencën e vet të parë mbi temën "Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara - Gratë, Paqja dh Siguria", më 1-2 shtator 2006 në Strugë të Maqedonisë. Konferenca është organizuar nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës në bashkëpunim me RrGZ, me përkrahje nga UNIFEM-i.

66 pjesëmarrësit në konferencë, që përfaqësonin organizata nga qytete dhe fshatra të Serbisë dhe Kosovës, diskutuan mbi katër çështje primare:

- * Përballja me të kaluarën dhe këmbimi i përvojave të aktivisteve nga Kosova dhe Serbia
- * Siguria dhe ndërtimi i paqes nga perspektiva e gruas
- * Të drejtat riproduktive të grave dhe siguria
- * Planifikimi i aktiviteteve të ardhme për Koalicionin e Grave për Paqe

Konferenca përfshinte seanca plenare me folës në të gjitha këto çështje si dhe punëtori në të cilat diskutohej më tej dhe përcaktoheshin strategjitë gjegjëse.

Një nga rezultatet e konferencës ishte plani strategjik bazik për aktivitetet e ardhme të koalicionit, që përfshin:

- * Ngritjen e nivelit të pjesëmarrjes së grave në të gjitha proceset e vendimmarrjes, me qëllim të krijimit të një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme
- * Përdorimin e aktivisteve të RRGK dhe GZ për të shtuar dialogun mes grave të të gjitha grupeve etnike në Kosovë, përmes organizimit të takimeve dhe diskutimit të çështjeve lidhur me sigurinë, statusin final

politik të Kosovës dhe domosdoshmërinë e përfshirjes së grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes.

- * Rritjen e frekuencës së aktiviteteve të përbashkëta rrejtëzuese mes organizatave anëtare të RrGZ dhe RRGK.

Në përmbyllje të konferencës, koalicioni lëshoi deklaratën vijuese:

Kjo konferencë si dhe të gjitha aktivitetet e Koalicionit të Grave për Paqe kanë për synim të ndriçojnë aktivitetet e lëvizjeve të grave, caqet e të cilave janë që të arrihet një paqe e drejtë dhe e qëndrueshme në rajon. Gjatë konferencës, që ndodhi në të njëjtën kohë me negociatat për statusin final politik të Kosovës mes Prishtinës dhe Beogradit, 60 aktivistë nga Kosova dhe Serbia arritën tek përfundimi se paqja në rajon nuk është e mundshme pa pjesëmarrjen aktive të grave. Gjithashtu Koalicioni i Grave për Paqe fuqimisht përkrah pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës si shtet funksional, që siguron që:

- * Nevojat e të gjithë qytetarëve të përbëjnë bazën e paqes dhe sigurisë.
- * Institucionet relevante pranojnë konceptin e sigurisë njerëzore, në veçanti të sigurisë në baza gjinore, në pajtueshmëri me Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.
- * Gratë të jenë të përfshira në të gjitha nivelet në proceset e vendim marrjes.

Ndryshe nga politika zyrtare, Koalicioni i Grave për Paqe vazhdon të punojë drejt ndërtimit të besimit, solidaritetit dhe përkrahjes së ndërsjellë. Aktivitetet tona të për-



Pjesëmarrësit në konferencën e parë vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe në Strugë.

bashkëta kontribuojnë drejt ndërtimit të një paqeje të vërtetë dhe afatgjate në rajon. Përveç kësaj deklarate dhe planifikimit strategjik që u ndërmor, konferenca u dha aktivistëve hapësirë që të ndajnë përvojat e tyre personale të luftës dhe të iniciojnë proceset e shërimit. Aktivistët e GZ bënë kërkimfaljen e parë të njohur publike për krimet e kryera kundër shqiptarëve në vitin 1999 dhe gjatë viteve që shpjerë tek lufta. Kjo deklaratë e tyre më tej u emitua në stacionin televiziv Kosovar RTV 21, ndërsa qytetarët i kishin kumtuar RRGK-së se kishin qarë kur kishin parë apologjinë e parë, shtatë vjet pas luftës. Përpjekjet e mëtejme të Koalicionit të Grave për Paqe do të sendërtoheshin në themelet e besimit që u përforcuan gjatë konferencës së parë.



Qëllimi i Konferencës së Dytë

Pas konferencës së parë, anëtarët e Koalicionit të Grave për Paqe u zotuan të implementojnë synimet strategjike të identifikuar gjatë konferencës. Ato vazhduan të ushtrojnë presion mbi qeveritë e Serbisë dhe Kosovës, si dhe mbi vendimmarrësit ndërkombëtar për të involvuar gratë në negociatat lidhur me statusin politik të Kosovës. Me përkrahjen e UNIFEM-it, përfaqësueset gjegjëse shprehën qëndrimet e koalicionit gjatë një takimi me Presidentin Martti Ahtisaari, i Deleguar Special për Procesin e Statusit të Ardhshëm të Kosovës, si dhe gjatë një takimi joformal me një delegacion të Këshillit të Sigurimit të OKB-së që vizitonte Kosovën. Përfaqësues të koalicionit gjithashtu vizituan enklava serbe në tentativë për të ngritur nivelin e dialogut mes grave të të gjitha grupeve etnike në Kosovë.

Për fat të keq, organizatat individuale në Koalicionin e Grave për Paqe nuk kishin mundësi që të ndërmarrin rrjetëzimin horizontal që e kishte planifikuar koalicioni. Dy pengesat më të theksuara paraqiteshin mungesa e fondeve për grupet e shoqërisë civile dhe mosposedimi i dokumenteve përkatëse të udhëtimt nga aktivistët Kosovarë, që rrjedhimisht nuk mund të hynin në Serbi dhe nuk mund të kyçeshin në aktivitete rrjetëzimi.

Me të kuptuar këto çështje dhe pasi që kishin vlerësuar se ekzistonte nevoja e zhvillimit të caqeve më konkrete strategjike për punën e koalicionit në të ardhmen, RRGK dhe GZ organizuan konferencën e dytë vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe, me qëllim të krijimit të një strategjie më konkrete, më afatgjate për koalicionin. Konferenca gjithashtu do të sillte në një vend aktivistë nga Serbia dhe Kosova, duke shtrënguar më tej lidhjet dhe bashkëpunimin që tejkalojnë kufijtë nacional, etnik dhe fetar.

Strategjia për të Ardhmen

Qëllimi kryesor i mbajtjes së konferencës së dytë të Koalicionit të Grave për Paqe ishte të hartojë strategjinë për punën e ardhme të koalicionit. Konkluzionet dhe rekomandimet e konferencës janë të prezantuara këtu në formë të një plani fillestar strategjik, që përfshin një përmbledhje të pengesave kryesore për proceset e drejtësisë tranzicionale dhe arritjen e paqes së drejtë; objektivat strategjike; dhe programet e aktiviteteve të propozuara për koalicionin mes viteve 2008-2010. Koalicioni i Grave për Paqe do të vazhdojë të punojë në finalizimin e kësaj strategjie në të ardhmen.

Pengesat Kryesore ndaj Proceseve të Drejtësisë Tranzicionale dhe Arritjen e Paqes së Drejtë

Në qeveri dhe mes liderëve politikë lokal:

- Mungesa e drejtësisë për ata që kanë kryer krime, posaçërisht për shtetin që ka kryer krime në emër të qytetarëve
- Refuzimi i identifikimit, pranimit, apo marrjes së përgjegjësisë për krimet e kryera në të kaluarën nga elita politike dhe shteti Serb; mos marrja e përgjegjësisë nga autoritetet e Serbisë për shkaktimin e luftës dhe krimeve të luftës.
- Përgjegjësia masive bën zbatimin e drejtësisë të vështirë: gjenocidi kushtëzohet me ekzistimi e një strukture të organizuar që përfshin organizatorë dhe akterë të shumtë, përfshirë edhe akterët ligjor dhe politik. Është vështirë të dënohet një infrastrukturë aq masive që organizoi dhe kreu këto krime, e kjo në veçanti ndërlidhet me Serbinë.
- Mungesa e ligjeve, masave ligjore dhe reformave, siç janë ligji mbi sanksionimin dhe emërtimin e krimeve nga urrejtja apo gjuhës së urrejtjes.
- Qeveria e Serbisë vazhdon të ketë shumë ndikim mbi komunitetin serb në Kosovë
- Qeveria, në të dyja shoqëritë, fokusohet më shumë në 'racat politike për mbajtjen apo forcimin e autoritetit' se sa në mirëqenien e popul latës.
- Mungesa e njohjes institucionale të nevojave të viktimave të dhunës seksuale dhe dhunës në baza gjinore në të dyja shoqëritë, që do të ndihmonte në hartimin e legjislacionit që do të ishte përfitues për këto viktima, si dhe për integrimin e tyre në shoqëri
- Mungesa e përkrahjes nga publiku dhe vendimmarrësit për gratë që punojnë në proceset e drejtësisë tranzicionale; elita politike e Serbisë dhe shteti Serb 'dehumanizojnë' pjesëtarët e shoqërisë civile dhe punën e tyre, në veçanti gratë. Kjo është në veçanti e vërtetë për Serbinë, ngase rrjeti i GZ mbetet jashtë dhe në distancë të caktuar nga konsensusi politik dhe kombëtar, ndërsa Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës gjendet brenda konsensusit shtetformues dhe social.

Në shoqëri, posaçërisht sa i përket ndikimit në gjeneratat e ardhme:

- Dhuna potenciale nga qytetarët në Serbi apo Kosovë, pas vendimit mbi statusin politik të Kosovës. Rreziku është posaçërisht serioz për rrjetin e GZ, për shkak se janë 'tradhtarë', si aktivistë që mbesin larg nga kon sensusi kombëtar dhe politik
- Familjet dhe praktikat tradicionale sociale që bëjnë që gratë të mbesin të heshtura lidhur me krimet seksuale të kryera ndaj tyre, që do të thotë traumatizim i vazhdueshëm për vikimat dhe mungesë e drejtësisë për ata që i kanë kryer krimet. Për më tej, mungesa e pranimit në komunitet të grave që kanë përjetuar dhunë seksuale, dhe potencialisht dhunë të mëtejme që kryhet ndaj tyre (p.sh. 'ato veç kanë qenë të dhunuara, pse të mos i dhunojnë prapë?') për shkak se dhuna interpre tohet si 'humbje e nderit të një gruaje', në vend se të konsiderohet si krim i patolerueshëm kundër dinjitetit të gruas.
- Refuzimi i komunitetit Serb të Kosovës që të bashkëpunojë dhe inte grohet në shtetin e ri të Kosovës, që mund të jetë rezultat i qeverisë në Beograd. Megjithatë, ky refuzim mund të jetë i ndërlidhur me çështjen edhe reale edhe të imagjinuar të sigurisë për komunitetin serb dhe komunitetet tjera pakicë në Kosovë.
- Informatat e pamjaftueshme mes popullatës, posaçërisht mungesa e informatave dhe komunikimit mes komunitetit Serb dhe Shqiptar në Kosovë dhe Serbi.
- Sistemet arsimore në të dyja shoqëritë nxisin një diskurs nationalist, injorojnë të kaluarën dhe nuk marrin përgjegjësi për të kaluarën; eduki mi formal nuk përmend kulturën e paqes apo vlerave demokratike
- Të rinjtë në Serbi nuk shfrytëzojnë mundësitë që shoqëria civile i ofron sa i përket dialogut për paqe

Mes administratorëve, institucioneve dhe vendimmarrësve ndërkombëtarë:

- Dështimi i komunitetit ndërkombëtar në përkrahjen e vendimeve të menjëhershme lidhur me statusin final politik të Kosovës; mungesa e vullnetit politik global për definimin e statusit politik të Kosovës
- Dështimi i komunitetit ndërkombëtar që administron Kosovën që të zbulojë fatin e shqiptarëve të pagjetur të Kosovës dhe të sigurojë kthimin e të gjithë trupave të shqiptarëve të Kosovës që janë vrarë gjatë luftës, si dhe trupave të etniciteteve tjera
- Mungesa e përkrahjes nga institucionet ndërkombëtare, në veçanti në ndërlidhje me krimet, përballjes me të kaluarën dhe drejtësinë tranzi cionale
- Presioni nga administratorët ndërkombëtarë apo donatorëve që të krye jnë projekte për zgjidhjen e konflikteve ndëretnike që në fakt nuk adresojnë nevojat reale
- Dështimi i komunitetit ndërkombëtar në komunikimin me dhe përfshir

jen në procesin e planifikimit të akterëve lokal, aktivistëve, ekspertëve dhe qytetarëve gjatë gjetjes së metodave më të mira për proceset e drejtësisë tranzicionale.

- Komuniteti ndërkombëtar imponon plane nga shtete tjera, duke mos u bazuar në konsultime dhe vlerësime të nevojave lokale
- Komuniteti ndërkombëtar insiston që aktivistët nga Serbia të komunikojnë dhe të shfrytëzojnë kanalet institucionale të tyre, por aktivistët konsiderojnë institucionet e Serbisë të jenë nacionaliste dhe kontradiktore me vlerat që ata i përfaqësojnë

Për grupet e shoqërisë civile:

- Aktivistët nuk ndihen mjaft të sigurt në kushtet në të cilat jetojnë; posaçërisht aktivistët nga Serbia që janë në rrezik nga reperkusionet
- Problemet administrative, siç janë pasaportat, në veçanti për gratë në Kosovë që duan të vizitojnë Serbinë, për shkak se nuk posedojnë dokumentacion përkatës. Mungesa e pasaportave apo dokumenteve të udhëtimit pengon proceset e shërimit dhe drejtësisë tranzicionale
- Mungesa e kohës adekuate për diskutimin e të kaluarës dhe për proceset e shërimit, përfshirë takimet e shkurtra dhe të pakta
- Mungesa e konsensusit përbrenda shoqërisë civile në Serbi, posaçërisht sa i përket përgjegjësisë së regjimit serb për luftën dhe krimet e luftës në ish-Jugosllavi
- Mungesa e solidaritetit të duhur mes grupeve dhe aktivistëve
- Financimi joadekuat apo kushtet joadekuate financiare për sektorin e shoqërisë civile



Objektivat strategjike

- I. Përmirësimi i cilësisë dhe influencës ndaj proceseve të drejtësisë tranzicionale, përfshirë proceset gjyqësore, mekanizmat ligjorë, drejtës inë për viktimat e dhunës seksuale dhe proceset më të gjera të drejtësisë tranzicionale që arrijnë të gjitha nivelet e shoqërisë.
- II. Ngritja e vetëdijes ndërkombëtare mbi praktikat më të mira për përkrahjen e integriteteve aktuale dhe të ardhme të situatave të paskonfliktit dhe bashkëpunimit ndëretnik.
- III. Ngritja e nivelit të këmbimit të informatave dhe interaksionit mes komunitetit serb dhe shqiptar të Kosovës, përfshirë përmirësimin e sigurisë për civilët serb, siç premtohet nga Shqiptarët.
- IV. Përmirësimi i kapaciteteve të KGP për adresimin e situatave emergjente dhe promovimi i paqes përmes zhvillimit të një strategjie gjegjëse.



Programet dhe Aktivitetet e Propozuara për vitet 2008-2010

Programet dhe aktivitetet e propozuara për 2008-2010 korrespondojnë direkt me objektivat strategjike. Çdo program apo aktivitet mëton të adresojë pengesat e drejtësisë tranzicionale që janë identifikuar gjatë konferencës.

- I. Përmirësimi i cilësisë dhe influencës ndaj proceseve të drejtësisë tranzicionale, përfshirë proceset gjyqësore, mekanizmat ligjorë, drejtësinë për viktimat e dhunës seksuale dhe proceset më të gjera të drejtësisë tranzicionale që arrijnë të gjitha nivelet e shoqërisë.
 - 1.1 Forumet qytetare të organizuara nga gratë shqiptare dhe serbe në Kosovë dhe Serbi, në të cilat qytetarët flasin mbi krimet e kryera në emër të tyre dhe krimet e kryera ndaj tyre, si alternativë për procesin e drejtësisë tranzicionale.
 - 1.2 Performansat rugore për të tërhequr vëmendjen tek bashkëpunimi mes grave Shqiptare nga Kosova, grave Serbe nga Kosova dhe grave nga Serbia, si dhe për tu ofruar qytetarëve mundësi që t'i qasen qytetarëve që u përkasin grupeve tejsra etnike.
 - 1.3 Monitorimi i proceseve gjyqësore mbi krimet e luftës të kryera në Kosovë dhe përpilimi i raporteve mbi procedurat gjyqësore, si formë e përgjegjësisë qytetare dhe përgjegjësisë për arritjen e paqes.
 - 1.4 Dhënia e përkrahjes morale për familjet shqiptare nga Kosova gjatë procedurave gjyqësore në Këshillin e Veçantë për Krime Luftë të Gjykatës së Qarkut në Serbi, si dhe dhënia e përkrahjes morale për familjet serbe nga Kosova që janë viktimat e krimeve të luftës.
 - 1.5 Hartimi dhe avokimi i një ligji që sanksionon dhe përcakton krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes në Serbi, dhe themelimi i mekanizmave efektivë ligjor për realizimin e të drejtave të viktimave dhe familjeve të tyre.
 - 1.6 Avokimi për mekanizma ligjorë me qasje humane ndaj dënimit të krimeve të dhunës seksuale që janë kryer gjatë luftës.
 - 1.7 Fushata të ngritjes së vetëdijes publike për të njohur dhunën seksuale si krim dhe edukimi i shoqërisë për të eliminuar stigmatizimin e viktimave të dhunës seksuale. Gjithashtu, përmes fushatës për ngritjen e vetëdijes publike të inkurajohen viktimat që të thyejnë heshtjen dhe dokumentojnë krimet ndaj tyre.

- II. Ngritja e vetëdijes ndërkombëtare mbi praktikat më të mira për përkrahjen e integriteteve aktuale dhe të ardhme të situatave të paskonfliktit dhe bashkëpunimit ndëretnik.
 - 2.1 Fushatë avokimi përfshirë përpilimin e letrave të dërguara vendimarrësve dhe shkrimin e artikujve në gazeta të huaja që kërkojnë një vendim të menjëhershëm lidhur me situatën politike të Kosovës.
 - 2.2 Fushatë avokimi përfshirë përpilimin e letrave dhe takimet me liderët politikë në Kosovë dhe Serbi, si dhe vendimmarrësit ndërkombëtarë, duke kërkuar zgjidhjen e menjëhershme të çështjes së personave të pagjetur dhe trupave të tyre.
 - 2.3 Raporti me leksionet e mësuara nga përkrahja që komuniteti ndërkombëtar i dha bashkëpunimit ndëretnik në Kosovë, me rekomandime specifike për misionet e ardhme paskonfliktuozë dhe të ndërtimit të paqes. Procesi i duhej kohë dhe duhet të ndodhë sipas kushteve të përçaktuara nga njerëzit më të prekur nga situata.



Planet e KGP janë të organizohen më shumë demonstrime publike, sikur kjo e mbajtur gjatë konferencës në Strugë. Aktivistët ishin veshur si larva për të simbolizuar transformimin.

- III. Ngritja e nivelit të këmbimit të informatave dhe interaksionit mes komuniteti serb dhe shqiptar të Kosovës, përfshirë përmirësimin e sigurisë për civilët serb, siç premtohet nga Shqiptarët
- 3.1 Seminarë me gra serbe në enklava në Kosovë. Fillimisht, diskutime të përgjithshme. Më tej, këmbim informatash, diskutime mbi përvojat e përbashkëta, dhe ndarje opinionesh. Gjatë vizitave në terren, aktivistët shqiptarë nga Kosova i 'shtrijnë dorën' komunitetit serb, duke dërguar mesazhin se Kosova është edhe shtëpi e tyre. Gjithashtu, fushatë për ngritje të vetëdijes publike me demonstrime, përfshirë posterë me mesazhe politike, të realizuara në qytete të Kosovës; fushata inkurajon Shqiptarët e Kosovës që të mbrojnë dhe ofrojnë siguri për serbët e Kosovës.
- 3.2 Program edukativ që ngrit vetëdijen mbi 'tjerët' dhe thyen paragjykimet, përfshirë: 1) radio programet në Serbi me gra shqiptare nga Kosova që flasin për tregimet e tyre duke siguruar informata mbi pozitën e grave shqiptare nga Kosova; 2) gratë nga Serbia flasin lidhur me bom bardimin dhe përvojat e tyre për audiencat Kosovare; dhe 3) publikimi i një libri me storie të aktivistëve nga të dyja rrejetet.



Në të ardhmen, Koalicioni shpreson të promovojë këmbim më të mirë informatash mes aktivistëve në Serbi dhe Kosovë.

- IV. Përmirësimi i kapaciteteve të KGP për adresimin e situatave emergjente dhe promovimi i paqes
- 4.1 Zhvillimi i një strategjie emergjente të KGP: një plan proaktiv për siguri individuale dhe grupore, përfshirë një të tillë për rezultatet e mundshme pozitive dhe negative të një vendimi mbi statusin final të Kosovës dhe mënyrat e veprimit të koalicionit në secilin skenar. Strategjia duhet të përfshijë sistemin që përcakton detyrat specifike që duhet ndërmarrë nga individë të të dyja palëve, me qëllim të informimit të rregullt të njëri-tjetrit mbi incidentet e dhunshme dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, përfshirë edhe procedurat për shkrim dhe lëshim të menjëher shëm të deklaratave të përbashkëta që dënojnë aktet e tilla të dhunës. Strategjia gjithashtu do të përfshijë procedurat e një sistemi të raportim it të dymuajshëm mbi situatën politike, përfshirë sistemin për reagim të menjëhershëm me deklarata të përbashkëta, posaçërisht në Serbi për shkak të çështjeve të sigurisë. Ky plan do të diskutohet me Urgent Action Fund paraprakisht, në rast të paraqitjes së pasojave negative.
- 4.2 Krijimi i dy listave të dërgimit të postës elektronike për gratë në Kosovë e Serbi, për të shpërndarë dhe pranuar informata mbi punën e rrjetit tjetër; këmbimi i profileve të organizatave anëtare të koalicionit.
- 4.3 Seminare dy-tri ditore që fokusohen në të kaluarën, të quajtur "Më tako për të më kuptuar", me ç'rast aktivistë nga Kosova e Serbia do të këmbajnë përvoja personale, mbajnë punëtori për të identifikuar hapat drejt arritjes së paqes dhe familjarizimit me punët aktuale të njëri-tjetrit; realizimi i vizitave publike përmes mediave.

Agjenda e Konferencës

Dita I **Tema: Drejtësia Tranzicionale**

Fascilitatore: Marija Perkoviç

9.00 - 9.30 Mirëseardhje dhe përmbledhje nga konferenca e parë
(Osnat Lubrani - UNIFEM, Igballe (Igo) Rogova - RrGGK, dhe
Stasha Zajoviç - RrGZ)

9.30 - 10.30 Fjalimet e Panelit:

“Çka është drejtësia tranzicionale? – Pse është me rëndësi
qasja feministe?” - Stasha Zajoviç

“Modelet e drejtësisë tranzicionale. Përvoja e Grave në të
Zeza” - Milosh Urosheviç

“Prej mos ndëshkimit deri te përgjegjësia dhe drejtësia” -
Veprorë (Lola) Shehu

“Drejtësia tranzicionale: Roli i shoqërisë civile, vështhtësitë dhe
sfidat” - Nexhmije Cuca Fetahu

10.30 - 11.00 Kafe-pauzë

11.00 - 11.30 Diskutime

11.30 - 12.00 Formimi i grupeve punuese

12.00 - 13.00 Punëtoritë: “Modelet e drejtësisë tranzicionale. Përvoja e
Grave në të Zeza”
Punëtoritë do të moderohen nga RrGZ

13.00 - 14.00 Dreka

14.00 - 15.30 Vazhdimi i Punëtorive

15.30 - 16.00 Kafe-pauzë

16.00 - 17.00 Prezentime nga grupet punuese

19.00 - 20.00 Performansa në rrugë:
“Gratë ndërtuese të paqes: Shkojmë ngadalë për të arritur sig-
urtë”

20.30 - Darka dhe parti

Dita II **Tema: Siguria dhe Rrejtëzimi Horizontal**

Fascilitatore: Violeta Selimi

9.00 - 9.30 Përmbledhje nga dita e parë - Marija Perkoviq

9.30 - 10.30 Fjalimet e Panelit:

“Solidariteti mes grave. Përvojat e mira dhe sfida”t- Marija Perkoviq dhe Jasmina Mitrinoviq

“Gratë, paqja dhe siguria” - Mima Rashiç dhe Igo Rogova

“Aspektet rajonale të sigurisë” - Flora Macula

10.30 - 11.00 Kafe-pauzë

11.00 - 12.30 Punëtoritë: Rrejtëzimi horizontal
Punëtoritë do të zhvillohen në mënyrë simultane.
Fascilitatore të punëtorive: Marija Perkoviq, Emina Shkreli, Igo Rogova and Veprorë Shehu

12.30 - 13.30 Dreka

13.30 - 14.30 Prezentime nga grupet punuese

14.30 - 15.00 Kafe-pauzë

15.00 - 16.00 Përmbledhje, hapat e ardhshëm dhe konkluzionet
- Stasha Zajoviç, Igo Rogova dhe Flora Macula

16.30 Vizitë në Ohër

20.30 - 21.30 Darka

Dita e parë. Drejtësia tranzicionale



Nga e majta në të djathtë, Marija Perkoviç, Stasha Zajoviç, Osnat Lubrani, dhe Igballe Rogova, gjatë hapjes së konferencës.

Fjalët hyrëse

Konferenca u hap nga Osnat Lubrani, Drejtoreshë e Programit Rajonal e UNIFEM-it. Ajo tha që do të vazhdojë të mobilizojë përkrahje për përpjekjet e Koalicionit të Grave për Paqe. “Une e di të puna nuk është gjithnjë e lehtë” tha Lubrani. “Dhe ne në UNIFEM do të vazhdojmë të qendrojmë pas jush”.

Më pas, Stasha Zajoviç, Koordinatore e Rrjetit të Grave në të Zeza – Serbi, dha një përmbledhjes të kontekstit aktual dhe hapave që janë ndërmarrë që nga konferenca e kaluar e Koalicionit të Grave për Paqe në vitin 2006. “Ne po ofrojmë përkrahje dhe solidaritet në kohëra të vështira” tha ajo. Që nga viti i kaluar, anëtarët e koalicionit kanë tentuar që të përmirësojnë marrëdhëniet mes tyre, tha ajo. Përderisa janë organizuar disa takime në Beograd e Prishtinë, në të cilët janë ftuar disa anëtarë të koalicionit, ato shprehën dëshirë për të mbajtur takime më të mëdha me më shumë anëtarë të ftuar. Zajoviç besonte se konferenca do të ofronte një mundësi për pjesëmarrësit që të punojnë së bashku, të ideojnë plane për të ardhmen e koalicionit dhe aktiviteteve të tij. “Ne aktivistët e shoqërisë civile duam të marrim përgjegjësi për paqen dhe respektimin e të drejtave të njeriut”, u shpreh ajo, “Ne duam të punojmë së bashku dhe të realizojmë të drejtën tonë në paqe. Krahas të qenit të dukshëm për njërit tjetrin, ne duam të jemi të dukshëm në komunitetet tona. Me relacionet tona, duam të nxisim rela-

cione mes vendeve nga të cilat vijmë. Ne duam të dëgjojmë fjalët e njëjta përmes medimeve të ndryshme të homogjenizuara.” Duke cituar ‘etikën femiste’ të koalicionit, Zajović komentoi më tej se aktivistët serbë vinin nga një shtet që bartte përgjegjësi për spastrim etnik. “Populli i Kosovës ishte viktimë e kësaj politike etnike”, tha ajo, për të vazhduar:

Ne nuk mund të harrojmë. Ky është një fakt që tregon politikën tonë paqësore; ne jemi të marginalizuara në vendin tonë për shkak të atmosferës ekstreme politike. Ne jemi tradhtarë për shkak të relacionit që kemi me çështjen e statusit të Kosovës. Ne duam të respektojmë popullatën e Kosovës. Si feministë, ne duhet të dijmë se çfarë kemi të përbashkët dhe çfarë na lidh. Ne jemi të lidhur jo vetëm për shkak se jemi gra, por gjithashtu se vijmë nga shoqëria civile, nga Serbia e Kosova. Ne kemi qenë të përjashtuara nga negociatat për statusin e ardhshëm të Kosovës. Ne jemi të lidhur, sepse të dyja vendet kanë kul turë të rënjosur patriarkale të karakterizuar me diskriminim ndaj grave. Tradita jodemokratike politike gjithashtu është prezente në të dyja komunitetet. Prezenca e nacionalizmit dhe militarizmit gjithashtu është e evidente. Në të dyja vendet paraqitet çështja e pandëshkueshmërisë. Ne nga Serbia jemi duke e luftuar këtë fenomen.

Igballe Rogova, Drejtoreshë Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës mori fjalën më tej, për të deklaruar se në vitin 2006 aktivistët e filluan një proces shumë të rëndësishëm të përballjes me të kaluarën. “Ne jemi mbledhur këtu së bashku për të vazhduar ku e lamë vitin e kaluar” tha ajo. Rogova më shprehi mirënjohjet për mysafirët prezentë në konferencë që ‘demonstruan dëshirën për të përkrahur’ punën e koalicionit. Së pari ajo theksoi rolin special që UNIFEM-i ka luajtur në përkrahjen e Koalicionit të Grave për Paqe, në veçanti Osnat Lubrani dhe Flora Macula. Ajo më pas falënderoi Christina Wassholm dhe Ida Udović nga Fondacioni Kvinna till Kvinna, Ariella Futral nga Urgent Action Fund, Haya Shalom nga Gratë në të Zeza – Izrael dhe Rachel Wareham për pjesëmarrje në konferencë dhe përkrahje të saj.

Pas fjalëve hyrëse, moderatori i ditës së parë, Marija Perković nga Rrjeti i Grave në të Zeza – Serbi, hapi diskutimin e parë në panel, që i qasej temës së drejtësisë tranzicionale. Folës ishin Stasha Zajović, Bilijana Kovaceviq - Vuco, Millosh Urosheviq, Veprora (Lola) Shehu, dhe Nexhmije (Cuca) Fetahu. Në vijim janë parashtruar fjalimet e tyre.

Drejtesia tranzicionale – Qasje Feministe Përvoja e Grave në të Zeza

Nga Stasha Zajović

Pse është e domosdoshme që të konfrontohemi me të kaluarën?

Etika feministe do të thotë që unë gjithnjë duhet të jem e vetëdijshme se nga ku vij, nga cila pikë emocionale, morale dhe politike i qasem tjerëve-nga një shtet agresor, në një periudhë që pason pas një regjimi kriminal. Është në të vërtetë aksidentale që i përkas një grupi etnik, por regjimi i kaluar në mënyrë të qëllimshme, me paramendim dhe në mënyrë sistematike ka organizuar dhe kryer krime në emrin tim. Vendimi që pandërprerë, qartë dhe publikisht t'i kundërvihem atij është pjesë e etikës sime feministe. Kam vendosur të di, të përsëris dhe të kërkoj përgjegjësi për krimet e panumërta të kryera në emër tim dhe në emër tonë. Me këtë rast do t'i numëroj vetëm disa prej tyre.

- Formacionet e armatosura serbe mbajtën nën rrethim Sarajevën për 1425 ditë
- Gjenocidi i korrikut të vitit 1995 la të vranë më se 8000 Boshnjakë.
- Operacioni 'Patkoi' në Kosovë në vitin 1999 – me ç'rast formacionet e armatosura serbe dogjën 127000 shtëpi që u përkisnin njerëzve që kishin emra shqiptarë, ndërsa që vranë edhe më se 12000 njerëz të tillë. Afro 2000 persona me emra shqiptarë u dënuan pas Marrëveshjes së Kumanovës (në qershor të vitit 1999) dhe u mbajtën nëpër burgje serbe. Të gjitha këto procese bartnin veshje politike.
- Qendra Hulumtuese në Sarajevë ka mbledhur 25000 emra të njerëzve që kanë marrë pjesë apo kanë bashkëpunuar në krimet e kryera në Bosnjë e Hercegovinë.
- Në Bosnjë e Hercegovinë janë gjetur afro 300 varre masive.

A do të jemi në gjendje të ndërtojmë një të ardhme me një sistem aq të deranzhuar të vlerave sot në Serbi? Një sistem në të cilin kriminelët glorifikohen ndërsa ata që kërkojnë përgjegjësi për krime të kryera në emrin tonë dejonizohen dhe kriminalizohen? Natyrisht se jo!

A mund të dërgohet e kaluara kriminale në një pako për në Hagë? A mund të bëjmë diçka tjetër? Vetëm të shfrytëzojmë komunitetin ndërkombëtar, gjykatat ndërkombëtare? Natyrisht se jo! Akademia Serbe e Shkencës dhe Artit, Kisha Ortodokse Serbe, dhe shumë institucione tjera që kanë krijuar kushte kulturore dhe ideologjike që kanë shkaktuar, justifikuar dhe përjashtuar nga përgjegjësia luftën dhe krimet e luftës ende mbesin në Serbi.

A mund të mbyllet e kaluara kriminale në një kuti ashtu që ne të mund t'i hapim derën një të ardhme më të ndritur? Natyrisht se jo! E kaluara kriminale është vorbull. Asaj nuk mund t'i kalosh pranë. Ajo gjithnjë na kthehet në forma të ndryshme. 'Nga kamionët frigoriferë të Danubit në Tribunalin e Hagës' thoshte Nenad Dimitrijeviq. Kamionët frigoriferë në të Danubit transportonin trupat e shqiptarëve nga Kosova në Serbi.

A është adresimi i të kaluarës kriminale vetëm pragmatike, e domosdoshme për



shkak të integritetit në komunitetin ndërkombëtar dhe në qëllim të shlyerjes së kredive të jashtme? Natyrisht se jo! Ballafaqimi me të kaluarën kriminale përbën kryesisht një kategori morale, të domosdoshme për vetë neve. Krijimi i një sistemi të ri të vlerave nuk varet nga tranzicioni apo nga integriteti ndërkombëtar. Ballafaqimi me të kaluarën kriminale është parakusht për sajimin e integritetit dhe dinjitetit moral. Është obligim ndaj viktimave të krimeve të kryera në emrin tonë. Është marrëdhënie mes vet nesh në Serbi.

Pa ballafaqim serioz me të kaluarën kriminale nuk ka drejtësi. Nuk ka të ardhme pa demokraci! Si rrjedhojë e kësaj, drejtësia tranzicionale paraqitet si imperativ i etikës sonë feministe.

Stasha Zajović i bie ziles gjatë një demonstrimi të KGP-së në Strugë të Maqedonisë.

Roli i Shoqërisë Civile nga Serbia në Drejtësinë Tranzicionale dhe Modelet e Drejtësisë Tranzicionale

Nga Bilijana Kovaçević – Vuco

Iniciativat e drejtësisë tranzicionale në Serbi janë iniciuar nga shoqëria civile. Komuniteti ndërkombëtar ka pranuar një model të plotë të integritit të shoqërisë civile në institucione...armiqtë e drejtësisë tranzicionale janë pjesëtarët e elitës që nuk duan të ndahen nga e kaluara, jo vetëm nga ajo që ka bërë Millosheviqi, por nga ajo që ka bërë qeveria jonë. Mendoj se kjo është pengesa kryesore në negociata.

Organizatat joqeveritare dhe sektori i OJQ-ve në Serbi janë themeluar në një periudhë të vështirë kur Serbia ishte duke bërë luftëra në emër tonë. OJQ-të udhëhiqnin fushata për dezertorë të luftës. Asgjë nuk ishte e rregulluar, dhe ne donim t'i jepnim fund pengesave negative dhe luftimit kundër dezertimit...Albin Kurti u lëshua nga burgu në atë kohë. Kjo ndodhi duke u falënderuar OJQ-ve dhe presionit të komunitetit ndërkombëtar.

Një model tjetër i asaj kohe: ne kishim një program të demilitarizimit. Kishim një lëvizje të negociatorëve. Ne organizuam një listë nënshkrimesh dhe tentuam të ndërmarrim ndryshime funksionale. ...

Ekzistojnë modele të shumta të drejtësisë tranzicionale. Ekziston rreziku i krijimit të stereotipeve...Ajo që domosdoshmërisht duhej bërë nuk u bë. Politika e Millosheviqit gëzonte përkrahje të përgjithshme nga komuniteti ndërkombëtar. Në atë moment, mendohej që Serbia të lihej siç është tani...

Kishim persona që luftonin kundër sistemit të vjetër të vlerave, krijonin sisteme të drejtësisë tranzicionale, merreshin me të kaluarën dhe krijonin një sistem të ri për tejkalimin e krimeve. OJQ-të dhe shoqëria civile që merreshin me këtë nuk kishin kurrfarë përkrahje. Ata ishin bërë viktimë të diskriminimit të dyfishtë nga elita politike dhe nga shteti, të cilët i kanë dehumanizuar akterët e shoqërisë civile, të cilët luftonin për drejtësi politike. Liderët politikë sjellin me vete stereotipe që u kundërvihen grave që luftojnë për drejtësi tranzicionale. Ata janë duke na shtypur në mënyrë sistematike dhe janë duke krijuar një inversion moral të rimeve dhe gjërave negative që Serbia i ka kryer atëbotë. Tani, që jemi të distancuar nga krimet e kryera në emër tonë, evenimentet negative dhe sjelljet serioze, drejtësia ende mbetet minimale... Sipas përvojave tona personale dhe shembujve tonë, ne jemi tani 'viktimë' dhe viktimat rrallë luajnë rol në ndryshimin e sistemit. Ju mund të jeni aktiv dhe mund të ndryshoni sistemin. Gjykimet bëhen kundër nesh, ndërsa ne nuk kemi kryer kurrfarë krimi. ...

Tani kemi shumë dilema. Kemi një organizatë që merret me të drejtat e njeriut...

Jemi denoncues dhe përgjegjës. Nuk na lejojnë të punojmë në këtë çështje ngase organizatat që punojnë në të drejtat e njeriut nuk mund të punojnë në çështjet e drejtësisë tranzicionale.... ne duhet të denoncojmë bartësit e politikës kriminale... ata duhet të jenë bartësit e politikës. Ata duhet të merren me politikën që ka sjellë deri tek krimet e mëdha.

Ndërsa pjesa tjetër e tregimit është që njerëzit që punojnë në çështjet e drejtësisë tranzicionale janë gra dhe ato nuk përkrahen moralisht nga ata që do duhej t'i respektonin këto vlera në Serbi.



Bilana Kovačević - Vuco në liqenin e Ohrit, gjatë konferencës.

Modelet e Drejtësisë Tranzicionale: Përvoja e Grave në të Zeza

Nga Millosh Urosheviq

Aksionet e para ishin në rrugë: demonstratat kundër krimeve të luftës në Kroaci dhe Bosnjë mes 1991 dhe 1995 dhe më pastaj kundër atyre në Kosovë. Këto veprime ishin komemoracione, dhe çdo vit ne shënojmë përvjetorin e Srebrenicës, Shtërpcës dhe Suharekës.

Fushatat: këto nuk janë financiar, do të thotë që kemi vepruar pa fonde, përveç fushatës kundër ligjit për ndihmimin e Tribunalit të Hagës. Gjithashtu kemi dorëzuar peticione nëpër gjykata.

Vizitimi i vendeve të krimit, ku janë kryer krime në emër tonë: ne kemi vizituar vende të krimeve të kryera në emër tonë. Ne tentojmë të tregojmë solidaritetin e grave dhe të identifikojmë krimet e kryera në emër tonë. Aktivistet kanë marrë pjesë në komemoracione.

Gjithashtu, ne shënojmë datat e rëndësishme. Ne ua përkujtojmë njerëzve datat e ndërlidhura me iniciativa kundër luftës dhe iniciativa kundër patriotizmit.

Dëshmimet publike: në vitin 2005, në përvjetor të masakrës së Srebrenicës, ne kemi organizuar dëshmime me gra në Srebrenicë. Ne i këmbësym skoriet tona të luftës.

Përcjellja e gjykimeve: kemi përcjellë shumë gjykime: Flora Brovina, Albin Kurti, [dhe të tjerë]. Kemi monitoruar proceset në Gjykatën Speciale të krijuar në vitin



2003. Gra nga organizata jonë kanë qëndruar me familjet e personave të vrarë në Srebrenicë. Ne gjithashtu kemi përcjellë gjykimin e Skorpionëve për krimet e kryera në vitin 1995. Gjithashtu, kemi përcjellë gjykimin lidhur me vrasjen e 48 civilëve nga Serbia. Kemi kaluar 41 ditë me kushërirë të civilëve që ishin vrarë.

Aktiviteti policore: urat e paqes dhe demokracisë në vitet 1998-2002. Kemi organizuar 30 leksione mbi Tribunalin e Hagës: për dhe kundër. Gjithashtu jemi duke organizuar punëtori mbi temë 'adresimi i të kaluarës'. Kemi pasur promovime autorësh, video projeksione, filma dokumentarë 'nuk vërehen ndryshime' mbi rezistencën paqësore ndaj luftës, duke ofruar shembuj nga Serbia dhe duke kujtuar rezistencën e grave. Rreth 3000 njerëz kanë marrë pjesë në aktivitete të tilla.

Prej mos-ndëshkimit përmes përgjegjesisë drejt drejtësisë

Nga Veprorë (Lola) Shehu

Ata përgojojnë për të thyer shpirtin tënd
Sikur të kishin zbuluar femerinë dhe sikur të kishin thyer trupin
Unë përdor fjalët për të ndërtuar shpirtin
Dhe për të sjell në jetë përsëri

Ti mund të jesh dicka më shumë se që je sot
Ti do të arrish malet e larta si asnjëherë më parë
Sepse je e mbijetuar, luftarake, fitimtare
Triumfo mbi malin me dhimbjen dhe stigmën

Sepse ti ke rendësi
Ti bën ndryshime
Je këtu sot
Përkundër gabimeve dhe dhimbjeve të së djeshmës

Po e hapi këtë prezantim përmes vargjëve të shkrimtarës Janah Ncube nga Uganda e cila ju ka dedikuar këtë poemë 300 grave – nënave të reja të cilat kanë marshuar rrugëve të Gulus më 25 Maj 2007 për të tërhequr vëmendjen për pozitën e të mbijetuarave të dhunës seksuale.

çdo luftë dhe konflikt I ndodhur në botë ka shfrytëzuar dhunën seksuale si një strategji që ka shëndrruar meshkujt në armë dhe femrat në arenë beteje. Viktimat, të cilat kryesisht janë gratë dhe vajzat, ngelin me trupa dhe shpirtra të torturuar, të sakatosur, të thyer dhe të traumatizuar. Familjët dhe shoqëria bëjnë që ato të turpërohen, të stigmatizohen dhe të viktimizohen për krimet që janë berë ndaj tyre. Ndërsa ata që kanë kryer këto krime ngelin të liruar nga ndëshkimi. Dhuna seksuale ushtruar ndaj femrave tona ka ngelur sot e kësaj dite një krim I heshtur. Heshtja për ato është një mënyrë sigurie dhe instrument I mbrojtjes së dinjitetit.

Medica Kosova ka përkahur mjaft femra që kanë kaluar përvoja të tmerrshme të dhunës gjatë luftës në Kosovë. Disa prej klientëve akoma mbajnë gjurmët fizike të dhunimeve gjërsa pasojat psikologjike dhe emocionale janë mjaft të medha. Përkundër dëshirës për të denoncuar autorët e krimeve seksuale gjatë luftës por edhe në kohën e pas luftës, ato preferojnë të heshtin. “Për mua drejtësia duhet arritur në rradhë të parë brenda shoqërisë, aty ku bëjmë pjesë dhe përballemi cdo ditë”, thonë klientet tona. “Po kërkojmë barazi me meshkujt, gjërsa unë nuk ndihem e barabartë as me vet femrat, sepse kam kaluar një përvojë që turpëron femrat dhe rolin e saj në shoqëri”, thotë klientja e Medikës e cila për momentin ndodhët në Hagë duke pritur ri-lokimin në njërin prej vendëve të BE. Ajo ka përjetuar trauma të shumëfishta gjatë luftës: ka qënë dëshmitare e

masakrimet të 3 anëtarëve të familjës dhe është dhunuar sistematikisht për dy javë rresht duke u mbajtur në një vënd në Prishtinë. Ndonëse me masa të rrepta sigurie gjatë dëshimit të parë në Tribunalin për Krimet e Luftës në ish-Jugosllavi, ajo është përballur me pasoja të tmerrshme pas kthimit në fshatin e saj. Shumica kishin kuptuar arsyen e vërtetë të shkuarjes së saj në Hagë. "Përse nuk ka qënë gjykimi publik përderisa ke shkuar të deshmosh për vrasjen e anëtarëve të familjës", kanë komentuar bashkëfshatarët. Për pak ka shpëtuar nga dhunimi prej dy shqiptarëve nga fshati I saj të cilët I ka dëgjuar duke thënë se kjo është dhunuar njëherë prandaj nuk e ka problem të dhunohët përsëri. Kjo ka qënë arsyeja që dëshmimi I saj I dytë në Tribunal është kushtëzuar me mundësinë e ri-lokimit në një vend të tretë ose më e pakëta aprovimi I kërkesës për azil në Holandë.

Gjërë më sot, dhuna seksuale në konfliktët e armatosura kryesisht është ndjekur në nivelin ndërkombëtar – përmes adhoc gjykatat e krijuara nga Kombët e Bashkuara sic është ajo e Tribunalit të Hagës, Gjykata Nderkombëtare Penale për Ruandën dhe gjykatat e përziera sic është Gjykata Speciale për Sierra Leonen. Aktivistët për të drejtat e njeriut në botë kanë përhëndetur krijimin e Gjykatave për krime lufte dhe dokumentimin e dhunimeve si krime lufte dhe krim kundër njerëzimit duke menduar se mosndeshkimi I ketij krimi do të përfundojë dhe do të lindë një fazë intenzive e ndëshkimit të autorëve të krimeve seksuale. Megjithatë, numri I atyre që janë gjykuar për këto krime është akoma mjaft I vogël krahasuar me numrin e lartë të rastëve të dhunimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe në vendët e tjera të konfliktit. Derisa të emërtojmë autorët e këtyre krimeve të tmerrshme, përse kryen këto krime dhe kush u ka dhënë atyre fuqi dhe autorizim, ne nuk jemi në pozitë të prekim mos-ndëshkimin që mbulon këto krime.

Realisht, shumica e ndërvenimeve që bëhen lidhur me dhunën mbi baza gjinore, janë në rradhë të parë të fokusuar në përkrahjen e viktimës dhe përmbushjen e nevojave të tyre për përkujdesje psikosociale, shëndetësore, ndërtimin e vet-besimit dhe vet-vlerësimit, sensibilizimit të shoqërisë për pozitën e viktimave të kësaj dhune etj, gjërsa qeveritë dhe sistemet gjyqësore në nivele të ndryshme kanë dështuar në njohjen e ndikimit të dhunës tek viktimat, në efektët e vecanta që ka kjo dhunë tek femrat dhe nevojat e tyre të vecanta për ti tejkaluar pasojat. Shumë gra dhe vajza viktime të dhunës mbi baza gjinore mendojnë se meshkujt qëndrojnë mbi ligjin dhe se për të inicuar ndëshkimin e tyre duhet të perballën me akuzat të ndryshme, duke filluar nga akuzat për provokim, procedurat ri-traumatizuese të dokumentimit e deri te turpërimi para familjës dhe shoqërisë. Shumë aktivitete avokuese të shoqatës sonë, qoftë me iniciativë vetanake, qoftë përmes fushatave të përbashkëta me Rrjetin e Grave të Kosovës kanë fokusuar thyerjen e tabus për dhunën seksuale gjatë luftës dhe dhunën mbi baza gjinore në periudhën e pas luftës. Ndonëse janë arritur efektët sensibilizuese në mesin

e shoqërisë në përgjithësi, ka munguar njohja institucionale e cila do të lehtësonte dukshëm jo vetëm ndërtimin e legjislativës në favor të këtyre viktimave por edhe integrimin e tyre në shoqëri. “Kur qeveritarët injorojnë dhunimet që janë bërë gjatë luftës dhe preferojnë të shtirën se kinse nuk ka ndodhur asgjë, kush jemi ne që ta ngrisim këtë çështje?”, thonë disa gra që kanë dëgjuar komentët e disa qeveritarëve para gazetarëve menjëherë pas luftës. Është më së e vërtetë që njohja institucionale ka munguar dhe vazhdon të jetë prezente edhe pas tërësimit të këtyre viteve të pas luftës. Përpjekjet e Medicës për të integruar këto femra në Ligjin egzistues për viktimat civile të luftës vazhdojnë akoma të presin momentin e fokusimit të qeverisë kah mirëqenia e popullësisë pas garës politike për të ruajtur apo sforcuar pushtetin. Në anën tjetër, aktivistët e grave do të zhvillojnë strategji për dokumentimin e krimeve seksuale duke thyer heshtjen dhe identifikuar autorët e këtyre krimeve. Dokumentimi është një mjetë vendimtar në ndërtimin e mekanizmave individual, nacional, regional dhe ndërkombëtar për t’l dhënë fund mos-ndëshkimit dhe për të kapur drejtësinë.

Prandaj përfundimisht, janë masat gjithëpërfshirëse ato që ndihmojnë për të dhënë fund mosndëshkimit të krimeve seksuale. është përgjegjësia jonë si aktiviste të sensibilizojmë shoqërinë për eliminimin e stigmatizimit të këtyre viktimave; është përgjegjësia e shtetit për të njohur këto krime dhe për të vënë në



lëvizje mekanizmat ligjor me qasje humane për ndëshkimin e këtyre krimeve dhe është përgjegjësia e vetë të mbijetuarave të këtyre krimeve për të thyer heshtjen dhe dokumentuar krimet e kryera ndaj tyre.

Thyerja e heshtjes është cmimi që viktimat duhet paguar për të përfunduar agoninë dhe frikësuar kriminelët për krime të tjera. E dijmë se heshtja nuk ofron siguri, por hap shtigje për veprim dhe ndëshkim të kriminelëve. “The birth of my words could be the death of my shame and agony” është një thënie e marrur nga aktivistët e grave në botë gjatë procesit të përkrahjes së të mbijetuarave të dhunës seksuale.

Roli i shoqërisë civile në të drejtën tranzicionale – Pengesat dhe Sfidat

Nga Nexhmije (Cuca) Fetahu

Është detyrë e çdo shoqërie që gjatë fazave të tranzicionit të adresoj qartë shkeljet e bëra të të drejtave të njeriut. Gjatë kalimit prej një sistemi shtypës apo një periudhe të konfliktit a luftës drejtë paqes dhe demokracisë, shteti dhe shoqëria civile duhet të ndër marrin veprime të ndryshme që qojnë drejtë zbardhjes dhe njohjes së këtyre shkeljeve dhe dënimit të tyre.

Për tu rindërtuar besimi dhe bashkëjetesa në një shtet të ri e demokratik, në një shtet çfarë ne e dëshirojmë në Kosovë, shoqëria kosovare duhet patjetër të ballafaqohet me peshën e rëndë të kaluarës, në mënyrë që të kalojmë në një fazë kur qytetarët do ta ndiejnë paqen dhe drejtësinë të jetësohet.

Analistë të shumtë e kanë studiuar këtë çështje duke tentuar të gjejnë format më të mira për realizimin e një paqe të drejtë në vendet pas konfliktit. Pyetja është si të bëjmë një familje që ka humbur më të dashurit të ndihet se drejtësia po ndodh dhe se kriminelët po dënohen? Është kjo një çështje e cila ka preokupuar shumë studiues në kohën moderne dhe si rezultat janë krijuar mekanizma të ndryshëm të cilët synojnë të arrijnë realizimin e të drejtave të viktimave dhe familjeve të tyre.

Përkundër shume zërave që vënë në dyshim rolin e mekanizmave që shoqëritë kanë krijuar për realizimin e drejtësisë në faza tranzitore (si gjyqet për krime të luftës, tribunalet dhe format e tjera), është evidente domosdoshmëria e ekzistencës së këtyre mekanizmave që të provohet të dënohet krimi, të tentohet të silltet një ndjenjë e paqes së drejtë tek qytetarët. Them të tentohet, sepse fatkeqësisht deri më sot këto mekanizma nuk janë treguar shumë të suksesshëm në misionin e tyre. Shoqëritë duhet të punojnë vazhdimisht për gjetjen e formave të tjera dhe efektive të dënimit të krimeve, në mënyrë që njerëzit të mund të vazhdojnë jetën në paqe.

Është e pamundur të ndërtohet e ardhmja pa u spastruar e kaluara.

Roli i shoqërisë civile në realizimin e të drejtës së qytetarëve për një të ardhme me sa më pak bagazh nga e kaluara është shumë i madh. Si zë alternativ, si zë i cili është më së afërmi popullit dhe njezh dhimbjet e vuajtjet e tij, aktivistet e shoqërisë civile kanë obligim të merren me këtë problematikë. Të gjejnë mënyra për përkrahjen e qytetarëve në kërkim të së drejtës për të pasur një të ardhme në paqe me veten dhe të tjerët.

Shoqëria kosovare menjëherë pas luftës ishte tejet aktive. Organizata dhe aktivistë të shumtë të shoqërisë civile ndërmorren aktivitete të shumta duke ten-

tuar tu ndihmojnë qytetarëve në një fillim të ri. Shoqëria civile në Kosovë falë një historiku të gjatë të aktivizimit para luftës ishte e gatshme të vazhdojë aktivitet menjëherë pas luftës në ndërtim të një Kosove të re.

Në këtë kohë Kosova u ballafaqua me një gjendje shumë të rëndë, me dhjetëra mijëra të vdekur dhe mbi 3000 të zhdukur, shkatërrime masive, me vendosjen e një misioni ndërkombëtar me rol udhëheqës, huti dhe mosorganizim në çdo fushë të jetës. Ishte një fazë e euforisë dhe gëzimit për lirinë e fituar në një anë dhe në anën tjetër kishte dhimbje dhe tragjedi për familje të shumta kosovare të cilat kishin humbur te afërmit dhe edhe më e vështirë për ata të cilët edhe sot e kësaj dite po ballafaqohen me familjarë të zhdukur.



Ishte nevojë emergjente që shoqëria civile të ngriste zërin në përkrahje të këtyre familjeve dhe të kërkonte drejtësi në emër të tyre. Një nga format e para të aktivizimit pas luftës në Kosovë ishin pikërisht organizimi i protestave gjithëqytetare për të kërkuar përgjegjësi nga vendimmarrësit ndërkombëtar për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur. Për këtë u mobilizuan shumë aktivist të të drejtave të njeriut, shumë gra aktiviste dhe qytetarë. U organizuan protesta të cilat zgjatën me ditë të tëra, letra dhe peticione vendimmarrësve vendorë dhe ndërkombëtarë. Organizatat anëtare të RrGGK (si Medica apo Motrat Qiriaz Has dhe shumë të tjera) u angazhuan në punë direkte në terren me gra të veja dhe gra kryefamiljare të cilat kishin burra të zhdukur. Shumë organizata të shoqërisë civile u morën edhe me aktivitete të cilat synonin hapjen e dialogut ndëretnik në Kosovë, shumë iniciativa për zgjidhjen e konflikteve, gjetjen e fushave të përbashkëta të bashkëpunimit ndëretnik, etj.

Por puna e organizatave të shoqërisë civile nuk ishte e lehtë pas luftës. Gjejmë në këtë kohë edhe një nga pengesat më të mëdha me të cilat u ballafaqua shoqëria kosovare pas luftës. Ishin këto pikërisht organizatat ndërkombëtare të cilat kishin ardhur me plane të gatshme në Kosovë për "pajtim" mes qytetarëve të etnive të ndryshme. Ishte krejtësisht jo logjike dhe e pavend të punohet në pajtim në kohën kur njerëzit ishin aq të lënduar, dërmuar nga lufta, me anëtarë

të vdekur apo të zhdukur të familjeve të tyre!

Kërkese apo edhe më mirë thënë ultimatum i bashkësisë ndërkombëtare në Kosovë pas luftës ishte “harrojeni të kaluarën dhe vazhdoni jetën”!!! Kush mund të ndërtoj të ardhmen në atë mënyrë? Nuk mund të ndërtohet paqja dhe bashkëjetesa mbi baza të brishta. Një paqe tillë do të jetë jo e qëndrueshme, një bashkëjetesë e tillë jo e shëndoshë.

Po pse ndodhi kjo në Kosovë? Pikërisht për arsye të thjeshtë të moskomunikimit të bashkësisë ndërkombëtare me akterë vendor, me aktivistë, ekspertë dhe qytetar, për shkak të mosinvolvimit të këtyre akterëve në planifikim të përbashkët. Një mos analizë e mirëfilltë e gjendjes, vendosja e misioneve me plane të gatshme nga shtetet dhe përvojat e kaluara pa marrë parasysh specifikat e vendit apo natyrën e konfliktit të kaluar, do të sjellë detyrimisht deri te dështimi i një misioni të tillë. Si mund të ndërtohet besimi në baza artificiale? Bashkësia ndërkombëtare në Kosovë që pas luftës ka kërkuar nga shqiptarët të ndërtojnë besimin dhe jetën e përbashkët me serbet në Kosovë. Por e njëjta bashkësi ndërkombëtare nuk ka ndërmarrë asnjë më të voglin veprim për të përmbushur kërkesat legjitime të shqiptarëve të Kosovës, duke filluar nga ato pragmatike, si gjetja e të zhdukurve dhe kthimi i përnjëhershëm i kufomave të shqiptarëve të vrarë gjatë luftës, deri te ajo e përcaktimit të statusit final si bazë e domosdoshme për ndërtimin e të ardhmes.

Drejhtësia duhet realizuar nga aspekte të ndryshme qoftë ajo juridike apo jo juridike, për të shëruar plagët dhe për të mundësuar rindërtimin shoqëror. Duhet të merren parasysh gjithmonë kontekstet unike shoqërore dhe kulturore të shoqërive të dala nga lufta a represioni dhe të ndërmerren veprime në pajtim me këto kontekste, për t'i mundësuar një shoqërie të lënduar një fillim të ri, për të rivendosur besimin mes qytetarëve dhe komuniteteve dhe për të parandaluar shkeljet e të drejtave të njeriut në të ardhmen.

Shoqëria civile në Kosovë ballafaqohet me sfida të shumta në kryerjen e misionit të vet në këtë fazë tranzicionit. Ajo e ndjenë si detyrë primare të shërbejë realizimit të të drejtave të qytetarëve, por për të realizuar këtë mision të saj duhet të tejkaloj shumë pengesa. Pengesat si gjendja e paqartë politike, mungesa e vullnetit politik botëror për definim të statusit politik të Kosovës, lënë vend për huti, për shmangie të përgjegjesisë dhe për mos përmbushje të obligimeve nga institucionet vendore dhe qeveria Kosovare.

Sfide tjetër e Shoqërisë civile në Kosovë është mungesa e vullnetit të komunitetit serb për bashkëpunim dhe integrim në shtetin e ri të Kosovës. Fatkeqësisht edhe pse kanë kaluar 8 vjet pas luftës në Kosovë, ndikimi i qeverisë serbe në qytetaret e komuniteti serb në Kosovë është ende shumë i madh.

Ndikim ky tejte negative, ne radhe te pare per vet qytetaret serb, por edhe për tere shoqërinë kosovare. Andaj kjo do te jete një nga punët me sfiduese per aktivistet e shoqërisë civile ne Kosove, integrimi i komunitetit serb pas statusit. Ekzistojnë iniciativa dhe aktivite te shumta te cilat ndërmerren ne bashkëpunim me komunitetin serb. Edhe RRGK konsideron një nga prioritetet e aktiviteve te veta ofrimin e dorës se bashkëpunimit për qytetaret serbe ne Kosove. Ne duhet ti bëjmë te qarte komunitetit serb ne Kosove se Kosova është vendi i tyre, se ata duhet te punojnë e të jetojnë ne Kosove dhe se sa me e mire te jete gjendja si ekonomike si sociale ne vend aq me e mire do te jete edhe gjendje e tyre dhe familjeve te tyre.

Si një detyrë tjetër të shoqërisë civile në Kosovë unë e shoh edhe analizën e misionit të bashkësisë ndërkombëtare në raport me qasjen kah drejtësia tranzicionale dhe instalimin e mekanizmave për jetësimin e saj. Analiza dhe reko- mandimet për misionet e ardhshme do të ishin të domosdoshme. Kjo mund të jetë një kontribut i vogël për ndryshime të mëdha që do të mund të bëheshin në misionet e ardhshme pas konflikteve në botë. Qasja kah e drejta tranzicionale bazohet vazhdimisht në të drejtën dhe nevojat e viktimës dhe familjeve të tyre. Një qasje e tillë nuk është implementuar në Kosovë, nuk janë krijuar mekanizma efektive për realizimin e të drejtës së viktimave dhe familjeve të tyre, por nga të njëjtis është kërkuar të jenë të durueshme dhe të gatshëm në ditën e parë pas luftës të falin dhe të bashkëjetojnë! Çfarë ironie.

Këto janë mësimet që do të mund të ndihmonin në misionet e ardhshme të bashkësisë ndërkombëtare pas konflikteve, të cilat fatkeqësisht do të ekzistojnë edhe më tej në botë.

Ndërsa ne si aktiviste duhet të punojmë në të dy drejtimet, në vazhdim të ushtrimit të presionit tek qeveritaret tanë për funksionalizimin e mekanizmave ekzistues për realizimin e të drejtave të viktimave dhe familjeve të tyre si dhe të vazhdojmë punën ne teren për krijimin e një ambienti tolerant dhe të shëndoshë për ndërtim të së ardhmes së qytetarëve në një paqe të drejtë.

Përmbledhje

Marija Perkoviç përmbodhi seancën e parë mbi drejtësinë tranzicionale: "Komuniteti ndërkombëtar na ndihmon neve në rajon, por nganjëherë nuk e konsideron situatën në të cilën jetojmë." Ajo theksoi rëndësinë e qasjes ndaj institucioneve ndërkombëtare dhe lokale në aktivitetet e ardhshme të avokimit.

Rekomandimet e Grupit Punues për Drejtësinë Tranzicionale

Pas pauzës së kafes, pjesëmarrësit u ndanë në grupe punuese që u fokusuan në “Modelet e Drejtësisë Tranzicionale dhe Përvojat e Grave në të Zeza”, “Vizitimin e Vendeve të Krimeve të Kryera në Emër tonë dhe Politikën e Faljes”, “Falja: Brengat e Etikës Feministe dhe Përcjelljen e gjykimeve” dhe “Grupi Punues 4: Etika dhe përgjegjësia feministe: Roli i Shoqërisë Civile në Drejtësinë Tranzicionale”. Pas një diskutimi që zgjati dy orë e gjysmë, përfshirë edhe pauzën e drekës, pjesëmarrësit u rimblodhën për të marrë pjesë në prezantimet e ardhshme nga përfaqësuesit e grupeve punuese.

Grupi Punues 1:

Modelet e drejtësisë tranzicionale dhe përvoja e Grave në të Zeza

Grupi ynë ka analizuar atë që është bërë deri tani përmes punës individuale dhe grupore. Pastaj kemi prezantuar një film mbi atë çfarë kanë bërë Gratë në të Zeza deri tani. Pas pauzës për drekë, grupi përcaktoi rezultatet vijuese konkrete.

Aspektet negative apo pengesat ndaj drejtësisë tranzicionale janë:

- Policia serbe
- Indoktrinimi i politikës serbe në enklavat serbe në Kosovë
- Mungesa e informatave dhe komunikimit mes komuniteteve serbe dhe shqiptare
- Mungesa e financave adekuate
- Problemet administrative, siç janë pasaportat, posaçërisht për gratë nga Kosova që vizitojnë Serbinë
- Takimet tepër të shkurta
- Numri i limituar i takimeve, mbase pjesërisht për shkak të mungesës së dokumentacionit
- Mungesa e sigurisë për aktivistët

Iniciativat drejt drejtësisë tranzicionale që mund t'i ndërmarrim së bashku janë:

- Vizitat dhe aktivitetet e përbashkëta për të këmbyer informata lidhur me atë që ka ndodhur, përvojat e përbashkëta, storiet e përbashkëta dhe për të ndarë mendimet.
- Përfshirja e meshkujve të cilët mund të jenë aleatë të punës sonë të përbashkët
- Ndryshimi i pozitës së grave
- Shfrytëzimi i të tjerëve (intelektualëve dhe shqyrtimi i mundësisë së paraqitjeve në media). Ne kemi marrë informata nga jashtë, për shem bull përvojat e aktivistëve nga Palestina dhe Izraeli. Ne kemi mundës inë e sajimit të një pasqyre më të qartë lidhur me atë që është duke ndodhur në vendet tona.

Grupi Punues 2: Vizitimi i vendeve të krimeve të kryera në emër tonë dhe politika e faljes

Grupi ynë përbëhej nga dhjetë pjesëmarrës (pesë shqiptarë dhe pesë serbë), që ishte pozitive ngase mundëm të këmbëjmë informatat dhe përvojat që kanë të bëjnë me vizitimin e vendeve të krimit dhe politikën e faljes. Diskutuam mbi pritjet tona dhe parashtruam pyetje mbi arsyen pse pjesëmarrësit zgjedhën këtë punëtori dhe mbi pritjet që kanë nga ajo. Ishte prekëse që pjesëmarrësit pritin të flasin vetëm mbi krimet e liga dhe mbi kriminelët. Për këtë, shqiptare dhe serbet ndiheshin të mërzitura. Pse? Krimet e kryera në emër tonë ishin të tmerrshme. Përmes punëtorisë ne (aktivistët serbë) kërkua falje nga gratë shqiptare që ishin prezente.

Pastaj, ne ndamë përvojat personale nga vitet 90-a, në veçanti ato të kohës së bombardimeve, por edhe ato para vitit 1999. Ne gjithashtu këmbëjmë përvojat lidhur me atë se si ne mund të kemi ndikim në rrethin tonë, dhe si të bëjmë që të zbulohet e vërteta. Pas kësaj, ne diskutuam lidhur me mundësinë e realizimit të vizitave të përbashkëta në vendet ku ishin kryer krime. Ishte e dhimbshme ngase gratë shqiptare thanë që për to kjo nuk paraqiste problem, por për shkak të natyrës së krimeve të kryera kjo mund të ishte e vështirë për tu përballuar nga viktimat. Ato thanë që mbase është pak herët për të bërë diçka të tillë.

Sa i përket politikës së faljes, ne parashtruam tetë parime themelore të kësaj politike:

- 1) Zhvillimi i dëshirës për të dëgjuar të vërtetën lidhur me krimet e kryera në emër tonë, që në Serbi nuk ekziston mes pjesëtarëve të komunitetit shumicë, atij Serb
- 2) Njohja dhe pranimi i të vërtetës lidhur me krimet e kryera në emër tonë
- 3) Bashkëndjesia dhe solidariteti me viktimat dhe familjet e viktimave të këtyre krimeve
- 4) Përgjegjësia individuale dhe grupore për krimet e kryera në emër tonë
- 5) Përgjegjësia morale
- 6) Gjatë punëtorisë, ne u pajtuam që përmes heshtjes mbi krimet e kryera në emër tonë, ne jemi duke e bërë që kjo heshtje të jetë e pranueshme. Krimet duhet të kualifikohen si të tilla.
- 7) Vizita i vendeve ku janë kryer krime dhe apelimi tek viktimat që i kanë mbijetuar këto krime që të na falin për çka ka ndodhur, në veçanti kur kemi të bëjmë me Kosovën, dhe posaçërisht për krimet e kryera nga

policia.



Grupi Punues 3: Falja:

Brengat Etike Feministe dhe Përcjellja e Gjykimeve

Përmes shembujve personal ne kemi paraqitur etikën tonë të vetëdijes dhe mënyrën se si ne kujdesemi për të tjerët. Ne kemi arritur tek përfundimi, dhe mendoj se do të flasim më shumë mbi këtë nesër, që duhet të planifikojmë disa veprime të përbashkëta. Ne mund të shfrytëzojmë vitin e ardhshëm për të realizuar këto veprimtari që për fat të keq nuk janë realizuar deri tani. Ne kemi vendosur t'i diskutojmë këto gjëra joformalisht. 365 ditët e ardhshme nuk do të kalojnë vetëm me takime, gjatë tyre do të ndërmarrim veprime konkrete së bashku.

Gratë nga Kosova thanë që ato duan të vijnë në Serbi dhe të përcjellin proceset gjyqësore lidhur me krimet e kryera në Kosovë dhe t'i japin përkrahje morale familjeve nga Kosova. Advije Gashi tha që ajo do të dëshironte të pranohet informata lidhur me datat e seancave gjyqësore dhe lidhur me atë që ne shkruajmë për këto seanca. Besoj që në shtator një grup nga Kosova do të vijë për vizitë në Beograd.

Grupi Punues 4: Etika feministe e përgjegjësive:

Roli i shoqërisë civile në drejtësinë tranzicionale

Ne kemi diskutuar drejtësinë tranzicionale dhe stereotipet që parandalojnë zhvillimin e modeleve të drejtësisë tranzicionale:

- 1) Përgjegjësia kriminale nuk është individuale. Ajo është përgjegjësi grupore.
- 2) Gjenocidi kërkon përgjegjësi grupore, ngase kemi të bëjmë me një strukturë mirë të organizuar, që gëzon përkrahje politike, organizimi i të cilit ideohet nga shumë mendje dhe shumë ekzekutorë.
- 3) Mungesa e qartësisë sa i përket nocionit të përgjegjësive kolektive
- 4) Zyrtarët duhet të mbahen përgjegjës
- 5) Njerëzit nga qeveria janë bartës aktivë të politikës kriminale
- 6) Shteti i Serbisë nuk e ka identifikuar krimin. Për këtë arsye krimi nuk mund të dënohet.
- 7) Sistemi i drejtësisë nuk përkrah drejtësinë (shmangia e përgjegjësive institucionale me përkrahjen e komunitetit ndërkombëtar)
- 8) Zgjedhjet janë një instrument i rëndësishëm, por i pamjaftueshëm për demokracinë.
- 9) Roli i shoqërisë civile është t'i bëjë presion shtetit
- 10) Mungesa e konsensusit politike brenda shoqërisë civile kur kemi të bëjmë me përgjegjësinë.

Gjatë pjesës së dytë të grupit punues, ne diskutuam mbi politikën etike të Grave në të Zeza. Së pari, do të prezantojmë seancën e parë të punëtorisë mbi fajin dhe përgjegjësinë. Ne kemi diskutuar mbi përgjegjësinë kriminale. Ne kemi pasur një ekspert ligjor mes nesh dhe kemi përcaktuar një të drejtë që do të na ndihmojë

të merremi me përgjegjësinë individuale dhe kolektive. Ne kemi përmendur që për gjenocid nuk mund të mbahet përgjegjës një individ, ngase ky akt paraqet një krim të sistemuar dhe strukturuar. Gjenocidi kushtëzohet me praninë e një strukture të organizuar me akterë e ideatorë të shumtë, kështu që në këtë kontekst kemi të bëjmë me përgjegjësi masive. Personat juridikë dhe akterët politikë janë ata që bartin përgjegjësi. Një problem është që shteti nuk ka identifikuar të keqen, për këtë arsye kjo e keqe nuk mund të dënohet. Një nga përgjegjësitë e shtetit është të identifikojë krimin apo të keqen dhe mëpastaj ta dënojë atë. Ne vërejmë se në sistemet tona juridike kemi zbrazëti. Ligjet aktuale nuk janë të mjaftueshme për të zbatuar drejtësinë. Për këtë, neve na duhet përkrahje nga komuniteti ndërkombëtar. Zgjedhjet janë gjithashtu të rëndësishme, por të pamjaftueshme për të vënë në zbatim drejtësinë. Roli i shoqërisë civile është tejet i rëndësishëm për drejtësinë tranzicionale. Përbrenda shoqërisë civile ne duhet të arrijmë konsensus mbi përgjegjësitë dhe të flasim mbi përgjegjësinë.

Më tej, shtjelluam pengesat:

- Mungesa e reformave ligjore
- Mohimi i krimeve të urrejtjes
- Reforma arsimore = kulturë e paqes
- Mungesa e konsensusit të ndërlidhur me përgjegjësitë brenga komunitetit
- Komuniteti ndërkombëtar interpreton demokracinë e drejtë tejet formalisht, ngase nuk ka ndonjë qëndrim të qartë për problemet e vërteta të rajonit
- Komuniteti ndërkombëtar kërkon nga OJQ-të dhe institucionet të punojnë sipas standardeve, metodave dhe prioriteteve të vetë komunitetit ndërkombëtar.
- Mungesa e solidaritetit

Përfundimisht, ne diskutuam për parimet e Grave në të Zeza, dhe mënyrën në të cilën ato zbatohen në punën e individëve dhe aktivistëve.



Advije Gashi dëgjon paraqitjen e njërit nga folësit e seancës së parë.

Vërejtjet Përmbyllëse

Igballe Rogova: Gjatë këtyre prezantimeve, dëgjova nga dy grupet mbi rëndësinë e rrjetëzimit të mëtejme dhe aktiviteteve tjera të përbashkëta. Dua të sqaroj që kjo është një temë të cilës do t'i qasemi nesër. Grupet punuese me përfaqësues të Grave në të Zeza dhe RRGK do të punojnë nesër pasdite së bashku për të përcaktuar strategjinë për këtë çështje: rrjetëzimi horizontal. Vitin e kaluar kemi thënë që do të organizohemi por kjo nuk ndodhi. Situata politike kishte ndikimin e vet. Nesër do të kemi mundësi që të diskutojmë lidhur me atë se si do t'i realizojmë këto aktivitete. Kjo nuk do të thotë që ato duhet të influencohen nga dikush apo të varen nga presioni i jashtëm, ato duhet të vijnë spontanisht.


Nada Dabiq: Në mbrëmje do të kemi një demonstrim. Ne kemi helmata ushtarake dhe ushqim. Do të pyesin: si do të shfrytëzoheshin më mirë paratë tona, duke investuar në ushtri apo në programe sociale? Së pari, gra me mesazhe të shkruara do të qëndrojnë para skenës kryesore për 15 minuta në heshtje. Pastaj, do t'i sjellim helmata dhe shportat me ushqim. Ne gjithashtu kemi edhe larva. Në pjesën e dytë, ato do t'i shndërrojnë helmata në vazo lulesh, duke krijuar kështu simbolin e paqes. Në ndërkohë, gratë tjera prezente do të japin mesazhe paqeje. Gratë nga Serbia duhet të vishen me ngjyrë të zezë. Për sa i përket mysafirëve, ata mund të veshin çfarëdo.

Aktivitetet tjera

Në mbrëmjen e hershme, pjesëmarrësit demonstruan në qendër të Strugës, sipas përshkrimit paraprak të demonstratës. Performansa tërhoqi një turmë prej qindra shikuesish, përfshirë një grup turistësh nga Turqia, të cilët në fakt duartrokitnin përpjekjet e KGP për paqe. Kalimtarët ishin të intriguar nga performansa dhe u parashtronin demonstruesve pyetje dhe fotografonin performancën.



Më vonë atë mbrëmje, pas darkës, pjesëmarrësit u mbledhën në një gosti që u organizua në klubin e natës, në katin përdhese të hotelit. Shumë pjesëmarrës vallëzuan deri në agun e hershëm.



Dita e dytë. Siguria & Rrjetëzimi Horizontal

Fjalët hyrëse

Marija Perković hapi ditën e dytë të konferencës, duke bërë një përmbledhje të ditës së parë. Pas fjalimeve, grupi i parë punues me temën "Modelet e drejtësisë tranzicionale dhe përvojat e Grave në të Zeza" përshkroi pengesat dhe aktivitetet të cilat anëtarët e Koalicionit të Grave për Paqe do të mund t'i ndërmerren bashkërisht. Pengesat përfshinin politikën e autoriteteve serbe, që kishte ndikuar në elitën politike Serbe, informatat e pamjaftueshme në popullatë dhe financimi joadekuat apo kushtet jo të përshtatshme financiare për shoqërinë civile në Serbi. Një pengesë tjetër që paraqitet është mungesa e pasaportave apo dokumenteve të udhëtimit, që i pengon aktivistët e Kosovës që të udhëtojnë në Serbi. Një pengesë tjetër është mungesa e kohës. Përfundimisht paraqitet edhe çështja e sigurisë; asnjëri nga ne nuk ndihet mjaft i qetë në kushtet në të cilat jetojmë. Ekzistojnë disa gjëra që mund t'i bëjmë së bashku. Me propozojmë vizitimin e vendeve të krimit, këmbimin e opinioneve, dhe përfshirjen e burrave si aleatë potencialë, krahas përfshirjes së intelektualëve dhe intelektualëve progresivë.

Grupi i dytë punues me temën "vizitimi i vendeve të krimit të kryer në emër tim dhe politika e faljes" bëri një propozim specifik, të cilin do ta diskutojmë më tej sot: vizitimin e vendeve të krimit.

Grupi i tretë punues me temën "falja: bregat etike feministe dhe përcjellja e gjykimeve" gjithashtu diskutoi mbi vizitimin e vendeve të krimeve të kryera në emër tonë. Gratë nga Kosova gjithashtu donin të vizitojnë gjykatat në Serbi dhe të ofrojnë përkrahje morale për familjet që kanë përjetuar humbje.

Grupi i katërt "etika feministe e përgjegjësive: roli i shoqërisë civile në drejtësinë tranzicionale" prezantoi detyrën primare të shoqërisë civile: të bëjë presion ndaj institucioneve në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar për të ndryshuar sistemin e vlerave në shoqëritë tona. Një pengesë për punën e shoqërisë civile është mungesa e përkrahjes nga institucionet ndërkombëtare, në veçanti sa i përket marrjes me krime, përballjes me të kaluarën dhe drejtësisë tranzicionale. Pengesë tjetër është dehumanizimi i një pjese të sektorit civil. Së treti, një çështje që paraqitet brenda shoqërisë civile është problemi që kur punojmë në çështjet e drejtësisë tranzicionale, punojmë me një nivel të lartë të lojalitetit ndaj grupeve etnike në të cilat punojmë. Gjithashtu brenda shoqërisë civile mungon konsensusi. Pastaj, ekziston një nivel i përgjegjësive që autoritetet tona bartin sa i përket shkaktimit të luftës dhe krimeve të luftës. Ne duhet të punojmë në këtë çështje. Një pengesë tjetër është mungesa e ligjit, siç është ligji që sanksionon dhe numëron krimet e urrejtjes, përfshirë këtu edhe mohimin e krimeve

që janë kryer në të kaluarën. Një pengesë tjetër për arritjen e drejtësisë është sistemi i keq arsimor, që nuk përfshin parametra të kulturës së paqes; vlerat demokratike nuk përfshihen në të. Një pengesë tjetër paraqitet me formalitetin në të cilin qaset komuniteti ndërkombëtar, të cilët e kanë më të rëndësishme plotësimin e një formulari të caktuar se sa arritjen e vlerave që mëtojmë të arrijmë. Një pengesë tjetër është që i njëjti komunitet ndërkombëtar insiston që ne të komunikojmë me institucionet tona, të cilat janë nacionaliste dhe në kundërshtim me vlerat që ne përfaqësojmë. Mungesa e solidaritetit është pengesë tjetër për punën tonë të përbashkët. Besoj që ne do të diskutojmë këtë çështje më tej në panelet tjera, dhe do të punojmë më shumë në çështjen e solidaritetit të grave.

Urgent Action Fund

Pasi Marija Perkoviç kreu përmbledhjen e ditës së parë, Ariella Futral ofroi disa informata lidhur me Urgent Action Fund dhe me mënyrën se si ky fond mund t'i përkrah potencialisht pjesëtarët e Koalicionit të Grave për Paqe. Ajo tha që Urgent Action Fund ofron tri lloje të përkrahjes:

- 1) Përgjigje në raste të konfliktit të armatosur, dhunës së eskaluar apo mjediseve të lëvizshme politike
- 2) Në rast të veprimeve ligjore apo legjislative të cilat potencialisht mund të paraqesin precedentë, apo veprimeve që kanë për qëllim mbrojtjen e precedentëve veç të përcaktuar si të tillë.
- 3) Mbrojtjen dhe sigurinë e grave-mbrojtëse të të drejtave të njeriut.

Urgent Action Fund i përgjigjet aplikacioneve për grante brenda 72 orësh ndërsa që fondet i alokon brenda një jave. Ariella Futral tregoi se pjesëmarrësit e konferencës kishin në dispozicion

materialin me informacionet gjegjëse në Serbisht, Shqip dhe Anglisht.

Pas fjalëve hyrëse, moderatori i kësaj dite pune, Violeta Selimi, prezantoi folëset në diskutimet panele: Haya Shalom, Marija Perkoviç, Jasmina Mitrinoviç, Mima Rashiç, Iqballe (Igo) Rogova, dhe Flora Macula, fjalimet e të cilave i kemi parashtruar në vijim.

Violeta Selimi moderon diskutimet në panel mbi sigurinë dhe rrjetëzimin.



Ariella Futral ofron informata lidhur me Urgent Action Fund.



Ridefinimi i Sigurisë: Përvoja e Grave në të Zeza – Izrael

Nga Haya Shalom

Haya Shalom paraqiti një tregim të bazuar në përvojën e saj në punën me Gratë në të Zeza – Izrael.

Ministrja e arsimit inicoi një ligj që siguronte pjesëmarrjen e grave në negociata, por ai nuk kishte ndikim të vërtetë. Ishte më tepër deklarativ. Më pas, dy ditë pas kidnapimit të dy ushtarëve, gratë mbajtën një konferencë me temën gratë dhe siguria. Gratë bënë një listë me qindra gra që do të mund të merrnin pjesë në negociata dhe ia dhanë atë ministres. Menjëherë pas kësaj, aktivistët pyetën se çfarë po ndodhte. Ministrja tha që kidnapimi ishte çështje e sigurisë kombëtare e cila kërkonte reagim të menjëhershëm. Ajo votoi për fillimin e luftës. Në një anë ajo përkrahte përfshirjen e grave në proceset paqësore. Ajo ishte një nga lideret e Peace Now, një lëvizje popullore paqësore në Izrael. Nga ky tregim mund të shihni se si gratë bien në kurthin e militarizimit dhe nacionalizmit në shtetin tonë.

Pas kësaj, koalicioni i grave për paqe filloi një projekt të quajtur “Çka është siguria?”, që shtjellonte sigurinë e të gjithëve. Ne donim të ridefinojmë sigurinë, nga siguria kombëtare tek siguria qytetare. Ne donim që fillimisht të ndryshojmë në realitet konceptin përbrenda shoqërisë civile. Projekti ishte kryesisht edukativ dhe u zhvillua në të gjitha qytetet e Izraelit.

Vitin e kaluar, tre-katër zyrtarë të lartë u akuzuan për ngacmim dhe dhunim. Për muaj të tërë një gjeneral ushtrie dhunonte një ushtar(e) që ishte nën komandën e tij. Ministri i drejtësisë ngacmonte një femër (ushtarë) duke e puthur atë dhe duke e shtyrë gjuhën e tij në gojën e saj. Një grua që punonte në zyrën e presidentit akuzoi presidentin për dhunim. Si pjesë e fushatës sonë për siguri, koalicioni paqësor i grave inicoi një fushatë që i qasej drejtpërsëdrejti këtyre krimeve seksuale. Koalicioni ndërtoi një koalicion edhe më të gjerë. Pasi që koalicioni paqësor i grave përbëhej vetëm nga gratë që luftonin për paqe, ky koalicion u zgjerua dhe përfshiu njëmbëdhjetë organizata grash. Fushata kërkonte largimin e të gjithë funksionarëve, përndjekjen e tyre ligjore, dhe burgimin e tyre. Zakonisht strategjia përfshinte bisedimin me viktimat dhe përqendrimin në problemet e tyre, jo në sulmuesin. Ne e ndryshuam këtë qasje dhe filluam të sulmojmë njerëzit që mbanin pozita të larta, njerëzit që udhëhiqnin shtetin, dhe u thoshim: “Jo. Nuk do të mund t’i ikni kësaj veprë kriminale.”

Për shembull, Kryeministri deshi të promovojë Ministrin e Drejtësisë në një pozitë më të lartë. Ne zbatuam një fushatë për ta gjykuar atë dhe për ta larguar nga qeveria. Ishte interesante se si ndryshuan mediat. Në të njëjtën kohë presidenti, ministri dhe gjenerali u deklarorin mediave “Këto gra merren vetëm me çështje grash. Ato dëshirojnë të na shfrytëzojnë neve për të arritur tek hakmarr-

ja. Ato duan të jenë në tituj gazetash. Asgjë nuk ka ndodhur. Edhe nëse ka ndodhur diçka kjo ka qenë për shkak se ato vetë e kanë inicuar.” Shumë njerëz i përbënë këto argumente. Por për shkak të fushatës sonë, diskutimeve dhe deklarimeve të shumta në media, mediat filluan të ndryshojnë qëndrimin. Mediat tregonin më shumë simpati për viktimat apo të mbijetuarit e krimeve seksuale, por ato gjithashtu filluan të ndryshojnë të kuptuarit të konceptit të sigurisë. Në këtë shtet lufta vazhdon për shkak të sigurisë kombëtare, por njerëzit gjithashtu duhet të kenë siguri ekonomike, të punës dhe personale, ata duhet të jenë të mbrojtur nga këto krime seksuale. Një pjesë shokuese e fushatës ishte ajo kur dymbëdhjetë gra të cilat kishin përjetuar krime seksuale u paraqitën para parlamentit dhe mbajtën një manifestim të heshtur. Ishte hera e parë që ato që kanë përjetuar krimin, pa mburojë, me fytyra të hapura, sy të hapur shikonin njerëzit në sy dhe u thonin: “Nuk jemi duke jetuar në sekret. Nuk do të jetojmë në nëntokë. Ne ju sfidojmë, dhe ju duhet të ndryshoni politikën dhe qëndrimin ndaj grave, grave dhe dhunës, dhe ndaj dhunës seksuale.” Kjo pati ndikim në shoqëri. Më pas u arrit një marrëveshje në sistemin e drejtësisë: prokurori dhe presidenti arritën një pajtim. Presidenti do të pranonte se e ka dhunuar vajzën dhe në fakt do t’i ikte dënimit, pasi që do të shpaguante këtë me shërbim komunitar.

Pastaj tri-katër gra tjera e paditën atë për shkak se ai vazhdimisht i kishte ngacmuar dhe dhunuar gjatë punës së tij në qeveri. Njerëzit ishin aq të nevrkosur sa që u mblodhën spontanisht në sheshin qendror në Tel Aviv pas një publikimi në gazetë dhe pasi që u dërguan disa emaille. Nuk kishte kurrfarë aranzhimi për transportimin e njerëzve, për shembull me autobusë. Megjithatë, tridhjetë deri në dyzet mijë njerëz u bashkëngjitën me vetura apo transport publik, pasi që ishin të irrituar dhe nuk donin që presidenti t’iu shmanget këtyre krimeve. Por ky

fenomen ishte i ri. Zakonisht në demonstrata dalin fytyrat e njëjta, por jo edhe në këtë rast. Rasti ende është në gjyq. Brenda një apo dy javësh do të arrihet vendimi nëse presidenti mund të pranojë këtë ujdi apo jo. Edhe pse organizatat e grave ndonjëherë luftojnë mes veti, ato u bashkuan për këtë iniciativë.

Gjithashtu, presidenti dha dorëheqje, gjenerali u burgos, ndërsa ministri është duke kryer shërbime komunitare.



Haya Shalom ndan me pjesëmarrësit përvojat nga puna e Grave në të Zeza – Izrael.

Solidariteti i grave: Përvojat e mira dhe Vështirësitë Nga Marija Perkoviç

Mendoj se mund të themi që fraza ‘solidariteti i grave’ aktualisht interpretohet së paku në dy mënyra të ndryshme. Interpretimi i parë “Interpretimi Esencial” kërkon solidaritet me të gjitha gratë, duke u bazuar në faktin e thjeshtë biologjik që të gjitha i përkasim të njëjtës gjini. Sipas këtij kuptimi, solidariteti i grave duhet të shpie tek veprimet të cilat, në një anë ‘fuqizojnë gratë’ (përkrahja psiko-sociale) dhe në anën tjetër fokusohen në sistemin ligjor të shtetit, duke kërkuar trajtim të njëjtë ligjor për të dyja gjinitë. Edhe pse ky interpretim etiketon patriarkinë si përgjegjëse për statusin e pabarabartë të grave, në shumicën e rasteve kjo nuk merr në konsideratë realitetin kompleks social që krijohet nga patriarkati modern; diferencat klasore; identitetet nacionale, fetare dhe racore, të cilat paraqesin arsye të represionit dhe luftës që kanë qenë prezente me shënjë të tërë. Duke mos konsideruar të gjitha dallimet dhe diversitetin tonë, por vetëm të gjitha mekanizmat që patriarkati i shfrytëzon për të kontrolluar gratë (por edhe burrat), interpretimi esencialist i solidaritetit të grave nuk ofron mjete për të kritikuar patriarkatin kapitalist. Ky interpretim nuk ka fuqi për të sjuar një solidaritet që do të thyente sistemin kompleks patriarkal.

Interpretimi i dytë, “Interpretimi Kritik” mëton të përfshijë të gjitha pjesët komplekse të patriarkatit dhe të njohë të gjitha format dhe mekanizmat e dominimit dhe eksploatimit të sistemit patriarkal. Angazhimet që bazohen në të kuptuar të tillë të solidaritetit të gruas nuk fillojnë duke kërkuar njohje institucionale të barazisë së grave dhe burrave. Është e kundërta, qasja kritike kritikon institucione (shtetin) dhe sistemet mbizotëruese të vlerave që bazohen bazuar në konkurrencë dhe dhunë (shoqëria). Në këtë rast, solidariteti i grave tejkalon solidaritetin me gratë; ai përfshin solidaritetin me të gjitha grupet e marginalizuara apo të grupet të cilave u mohohen të drejtat. Pasi që ende parashtrrohet pyetja pse flasim kaq shumë për ‘solidaritetin e grave’ dhe jo vetëm për ‘solidaritetin’ – ajo parashtrrohej madje edhe në fillim të shekullit XIX nga majtistët – mendoj se duhet të flasim lidhur me shkaqet e paraqitjes së kësaj vigjilence mes femistëve për të njohur të gjitha mënyrat e represionit (të cilat shokët tonë majtistë nuk kanë marrë në konsideratë për shkak se kjo punë, për shembull eksploatimi emocional i femrave në marrëdhëniet romantike, u duket banal), dhe mënyrën e shprehjes së solidaritetit të grave që nuk përfundon me formalizëm por mëton të krijojë një tërësi të marrëdhënieve ndërpersonale, politike dhe emocionale.

Si rrjedhojë, praktika e Grave në të Zeza sa i përket solidaritetit të grave bazohet në vlerat etike dhe politike të cilat i ndajmë dhe jo në faktet biologjike. Etika feministe e kujdesit dhe etike feministe e përgjegjësisë bazohen në përfshirjen tonë politike, që klasifikon militarizmin, nacionalizmin, klericizmin/fundamentalizmin, homofobinë dhe imperializmin neo-liberal (globalizimin) si forma të represionit patriarkal. Dua tu përkujtoj se etika feministe e kujdesit e shpërbën rolin patriarkal të gruas që kujdeset ekskluzivisht për të afërmit e vet të gjinisë

mashkullore. Etika feministe e kujdesit, në kontrast me këtë, nuk e përjashton idenë e kujdesit për të tjerët, por më ofron lirinë që të zgjedh se për kë do të kujdesem, pa u diktatin e patriarkatit. Etika feministe e përgjegjësive shpërbën idetë kapitaliste të vetëqëndrueshmërisë (apo egoizmit) të 'një shteti, një kombi' dhe mbi rolin e qytetarëve në shoqëri të tilla. Ngjashëm etika feministe e përgjegjësive shpërbën anëtarësinë dhe lojalitetin e verbër ndaj një shteti dhe kombi, por edhe ndaj një feje, race apo klase. Ajo më ofron mundësi që të definojë komunitetin tim në mënyrë të pavarur, si dhe të mbajë marrëdhënie kritike, të përgjegjshme kundrejt komuniteteve të cilat thonë se u përkas për shkak të lidnjes (përfshirë shtetet, kombet dhe fetë).

Angazhimi politik i Grave në të Zeza, praktika konkrete e solidaritetit të grave, zhvillohet nga etika e tillë. Feminizmi ka pranuar se militarizmi dhe nacionalizmi janë produkte të drejtpërdrejta të sistemit patriarkal. Si rrjedhojë, angazhimi politik i Grave në të Zeza është antimilitarist antinacionalist. Për sa i përket përfshirjes antimilitariste, krahas solidaritetit të dukshëm me ato që janë viktimat të luftës kudo në botë, solidariteti i grave pasqyrohet në krijimin e kulturave alternative të paqes dhe marrëdhënies jo të dhunshme. Solidariteti i grave, po ashtu, nënkupton jolojalitet për strukturat militante të shtetit dhe shoqërisë.

Për mua, si aktiviste e Grave në të Zeza nga Serbia, antinacionalizmi është



aktualisht më i rëndësishëm. Realiteti im është se unë jetoj në një shtet agresor në të cilin identiteti kombëtar dhe rrezikimi i supozuar i kombit Serb ishte arsye për politika dominuese dhe luftëra të shumta në ish Jugosllavi. Në këtë rast, përfshirja antinacionaliste

*Marija Perković
moderon diskutimet
e panelit të parë*

nënkupton jolojalitet për kombin i cili më pretendon mua, dhe për shtetin tim. Përderisa parimi im etik është që të kujdesen për të tjerët (që në të vërtetë është thellim i ligjit më të vjetër universal moral, “mos vrit”) dhe unë jam person i vetëdijshëm, i përgjegjshëm që në çdo kohë dëshiron të dallojë të mirën nga e keqja, për nuk ka të tilla “caqe të larta”, “interesa kombëtar” apo “interesa shtetëror” që mund të më detyrojnë që të bëj gjëra të këqija. Një hap më larg të cilin e bëj, në bazë të këtyre parimeve etike, është antinacionalizmi im i përmendur, që nënkupton refuzimin e të gjitha nocioneve romantike mbi kombin, nocione që janë të rrezikshme dhe shoviniste. Këto parime politike dhe etike të cilat i kam pranuar nga Gratë në të Zeza më obligojnë mua që vazhdimisht të kundërshtoj glorifikimin e kriminelëve të cilët udhëhoqën luftëra dhe që kryen krime në emrin tim.

Për më tepër, antinacionalizmi nënkupton internacionalizëm, që shpie në solidaritet me gratë dhe burrat e kombeve dhe shteteve tjera. Duke hequr dorë nga lojaliteti i verbër për kombin tim, unë heq dorë nga të gjitha paragjykimet mbi kombet tjera. Solidariteti im femëror nënkupton se unë lidhem me të gjitha gratë e botës, duke lejuar dallimet tona, por duke insistuar se vlerat në të cilat unë besoj fuqimisht janë universale dhe janë përgjigja e vetme për dhunën që gjithmonë është e pranishme. Kjo do të thotë se unë, si një feministe dhe aktiviste në Serbi, ofroj përkrahje për viktimat e krijuara nga qeveria ime dhe përkrahje për viktimat e besimeve dhe etniciteteve tjera. Kjo nënkupton mbledhjet me ta, përcjelljen e gjykimeve për krime lufte, “rrezikimin për ta”, dhe dëgjimin e tyre. Së bashku, ne mund të krijojmë një hapësirë më ndryshe dhe vlera më ndryshe. Së bashku me ta vazhdimisht, mua më kujtohet krimet që janë kryer. Së bashku me ta, unë kërkoj drejtësi.

Përderisa gratë në mënyrë të pamenduar pranojnë format e sistemit patriarkal të listuara këtu (militarizëm, nacionalizëm dhe të tjera) si bindje të tyre, këto forma do të jenë pengesa për solidaritetin e grave. Nacionalizmi kërkon lojalitet nga gratë bazuar në përkatësinë etnike; kjo i ndanë gratë. Përderisa ne e pranojmë nacionalizmin, (militarizmin, klerizmin dhe fundamentalizmin) si diçka që na ndanë dhe diçka që gabimisht paraqitet para nesh si emancipim, (nacionalizmi vërtetë mohon të drejtat e grave në zgjidhje dhe e zvogëlon atë në makinë për riprodhimin e anëtarëve të kombit dhe grupit etnik, diçka që i takon burrave) ne mund t'i kalojmë kufijtë që duken si nacionalizëm dhe krijojmë një botë vërtetë në solidaritet. Duke refuzuar të gjitha format e sistemit patriarkal është kusht për solidaritetin e grave dhe tregon praktikën e vërtetë të Grave në të Zeza dhe asociacioneve dhe koalicioneve të cilat ato i kanë krijuar në Ballkan dhe kudo në botë.

A jam unë Grua Solidare?

Nga Jasmina Mitrovic

Kur kam filluar të veprojë në solidaritet? A jam unë në solidaritet? A ka qenë dikush në solidaritet me mua, a e ka dëgjuar kush tregimin tim? Çështja e rëndësishme është se çdo grua është në solidaritet në atë masë që është e gatshme të përballet me pasqyrimin e saj, të pranojë atë ashtu siç është dhe të ndajë një pjesë të vogël të vetes me gratë tjera që kanë nevojë për tregim, këshilla apo shtrëngim duarsh pa buzëqeshje të rreme.

Solidariteti është zgjidhje që unë e kam bërë dhe ndarë me ata që kanë qenë apo janë që janë solidarë me mua, të cilat i kuptojnë cilësitë e tyre të veçanta dhe cilësitë e mia të veçanta. Kur unë e dëgjoj një tregim, mendohem fortë të kuptojë çdo fjalë që thuhet përmes shprehjeve të fytyrës, shtrëngimit të duarve në prehër, pauzave të çuditshme në mes fjalive dhe synimeve për të ndaluar, filluar një tjetër pjesë, apo të heshtet ajo që lëndon.




Dhe në fund të atij tregimi, heshtja kumbon thekshëm dhe guximshëm, jo gatshme për më shumë të vërtetë. Edhe unë jam mësuar për të dëgjuar heshtjen. Një buzëqeshje e frikshme që dridhet në buzë lidhet me një tregim. Ai tregim kërkon ndryshimin tim, vendimin tim për të pranuar etikën e kujdesit si zgjidhje për të vepruar ashtu si jam unë, për të biseduar vetëm me njerëzit e ngjashëm me mua në këtë mënyrë . Kjo është zgjidhja e etikës së kujdesit, udhëzimet për vlera të solidaritetit të barazisë në deklarata dhe mendime.

I tërë ky ritregim, heshtje, shënim, madje edhe storiet e fshehura na kërkojnë që vazhdimisht të mësojmë së kush jemi ne emocionalisht, socialisht dhe politikisht që nga fillimi. Ne jemi vetëm në rezistimin e vlerave dhe rregullave të jetës të imponuara nga sistemi patriarkal dhe në shmangien dhe parandalimin e diskriminimit. Ne duhet që vazhdimisht të mësojmë se kush është “ai tjetri” në tregimin tonë dhe nëse ne jemi “tjetri” në një tregim tjetër. Unë vazhdimisht i bëj vetes pyetje të ndryshme për shkak të gjitha gjërave që kanë ndodhur të cilat ne nuk i deshëm. A do ta kem unë përsëri forcën për t'u përballur me shprehjet e grave nga Prishtina, Bujanoci dhe Presheva? A do të jem në gjendje t'i shikojë ato në sy dhe të them se unë jam e trishtuar se dikush, në emrin, por pa njohur-

inë time, shkatërroi ëndrra, hoqi liri dhe njolloosi nderin? Nuk e di; Vetëm pyes. Solidariteti i grave tona është vetëm fillimi i defashizmit për të gjithë ne. Ne zgjedhim mirëkuptimin ndaj gjykitimit, buzëqeshjet ndaj lotëve dhe ndjeshmërinë ndaj urrejtjes. Armiku nuk e pret këtë nga ne. Solidariteti i grave është politikë e antifashizmit sepse dhimbja jonë është dhimbja e të tjerëve.

Solidariteti i grave është ndërkombëtar sepse identiteti kombëtar është vetëm një nga dallimet në botë. Për të qenë pjesë e solidaritetit të grave nënkupton t'i themi jo sistemit patriarkal, atributit, diskriminimit dhe vendimeve të të tjerëve. Unë kam zgjedhur që të jem jolojale ndaj sistemit patriarkal sepse është ajo fillimi i solidaritetit tim femëror. Unë mësoj që të përkujdesem njëloj për veten dhe të tjerët politikisht dhe emocionalisht. Unë zgjedh solidaritetin për shkak të politikës feministe. Feministet nuk lindin; feministet krijohen. Përsëritje për të gjitha gratë në solidaritet!



Gratë, Paqja dhe Siguria

Nga Mima Rashiç

Gratë po mundohen të krijojnë një lloj tjetër të sigurisë njerëzore. Gratë kanë disa qasje më ndryshe të sigurisë. Qasja e parë apo më e rëndësishme është ajo antimilitariste. Pastaj është qasja feministe ndaj sigurisë, që lidhet me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të OKB-së nr. 1325 si qasje speciale e sigurisë. Kjo është më e rëndësishmja ...

Gratë në të Zeza janë grup antimilitarist i zotuar për çarmatim. Në përvojën tonë, ne kemi parë se gratë nuk ndihen të sigurta. Gratë dëshirojnë që të kenë siguri ekonomike dhe siguri sociale. Megjithatë, siguria e shtetit është e lidhur vetëm me buxhetin e planifikuar militarist vetëm për sigurimin e kufijve dhe jo për sigurinë e grave. Ne duhet të përfshijmë çështjet gjinore. Sistemi patriarkal dhe militarizmi prekin të drejtat njerëzore të grave duke rritur shpenzimet militariste dhe duke iu hequr grave të drejtat riprodiktive dhe sociale; gratë duhet të shërbejnë rolin e nënave për ushtrinë, për burrat dhe kishën.



Që nga fillimi, Gratë në të Zeza kanë punuar me dezertorët e luftës dhe kanë themeluar një nga fushatat më të mëdha për ngritjen e vetëdijes.

Po ashtu, më 31 tetor 2005, Gratë në të Zeza sollën projekt-rezolutën "Gratë, paqja dhe siguria", bazuar në Rezolutën e KS të OKB-së nr. 1325, por të konvertuar për t'i përmbushur kushtet tona. Ne identifikuam gjenocidin në Srebrenicë dhe ndihmuam familjet e dëshmitarëve në tribunalin e Hagës. Gratë në jug janë duke e përgatitur aksionin më të madh: mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Si mbrojtës të të drejtave të njeriut, ne kemi përfunduar draftin e mbrojtësve të të drejtave të njeriut në Serbi.

Ndjekjet penale merren me të kaluarën kriminale. Që nga fillimi, Gratë në të Zeza kanë punuar në këtë çështje gjatë ditës ndërkombëtare për paqe dhe ditës ndërkombëtare për të drejtat riprodiktive të gruas. Ne i kemi lidhur këto ditë, duke menduar se militarizmi drejtpërdrejtë ndikon në të drejtat riprodiktive të gruas. Gjatë këtyre ditëve ne kemi organizuar aksione në rrugë.

Po ashtu, ekzistojnë edhe libra që kanë të bëjnë me sigurinë. Një libër, Gjithmonë i Pabindur, përfshinë pjesë mbi sigurinë, paqen, gratë, shëndetin dhe çarmatimin.

Gratë, Paqja dhe Siguria: Përpyqjet e Aktivisteve nga Kosova drejt Implementimit të Rezolutës 1325

Nga Igballe Rogova*

Që nga miratimi i Rezolutës 1325, aktivistet nga Kosova kanë punuar në drejtim të ngritjes së vetëdijes mbi rezolutën dhe mbi mënyrat e implementimit të saj në Kosovë, në rrafshin lokal dhe atë ndërkombëtar.

Gjatë takimeve të rregullta dymujore të RRDDK, 85 organizatat anëtare të rrjetit kanë diskutuar rregullisht mbi rezolutën dhe implementimin e saj. RRGK shpesh shkruan artikuj lidhur me Rezolutën 1325 në buletinin e vet tremujor që botohet si në formë të shtypur ashtu edhe në atë elektronike “Zëri i Gruas Kosovare”, i cili shpërndahet tek rreth 5000 lexues. Përveç kësaj, RRGK dhe LGK informojnë rregullisht qytetarët lidhur me Rezolutën 1325 përmes mediave të shkruara dhe elektronike; me qindra debate, intervista dhe artikuj mbi Rezolutën 1325 janë shkruar dhe/ose emituar që nga miratimi i rezolutës.

Gratë e Kosovës kanë ngritur zërin e tyre lidhur me çështje të ndryshme, përmes përpilimit të letrave dhe takimeve me vendimmarrës të ndryshëm.

Në qershor të vitit 2001, një delegacion i Këshillit të Sigurimit të OKB vizitoi Kosovën. Zyrtarët e UNMIK-ut që përgatisnin orarin e takimeve të delegacionin thanë që delegacioni nuk ka kohë që të takohet me gratë Kosovare. Aktivistet theksuan që Rezoluta 1325 u siguron të drejtën e takimit me delegacionin dhe kërkuar një takim përmes Komisionit të Grave për Refugjatët Gra dhe Fëmijë në Nju Jork. Ambasadori Anwarul K. Chowdhury, që udhëhiqte delegacionin pranoi të takohet me gratë në ora 21.30 pasi që delegacioni të ketë përfunduar takimet tjera të parapara. Në këtë takim, gratë Kosovare i prezantuan delegacionit një letër zyrtare që përmbante rekomandimet e tyre.

Në dhjetor të vitit 2002, një delegacion i Këshillit të Sigurimit të OKB-së vizitoi Kosovën. Kur UNMIK-u dështoi në informimin apo ftuarjen e grave lokale për tu takuar me delegacionin, gratë Kosovare avokuan dhe patën sukses në sigurimin e një takimi me ta pas orarit të rregullt. Aktivistet filluan të diskutojnë mbi çështjet që kanë të bëjnë me statusin final politik të Kosovës. Ambasadori i OKB-së i ndali duke thënë “Statusi është çështje e partive politike. Le të flasim për çështje grash. Për shembull, le të flasim për Rezolutën 1325”. Gratë Kosovare ishin të befasuara me mungesën e dukshme të njohurive të ambasadorit lidhur me rezolutën, parimet e së cilës do duhej garantuar grave të Kosovës pjesëmarrje në procesin e negociimit. Ato pyetën “A nuk mendoni që statusi është çështje që ka ndikim tek gratë? Kjo përcaktohet qartë në Rezolutën 1325”. Ato prapë rithek-

* Fjalimi i Igballe Rogovës është bazuar në një raport të shkurtër mbi nivelin që Rezoluta e KS e OKB-së 1325 është zbatuar në Kosovë, përgatitur nga RrGGK-së në vitin 2006.

suan brengat dhe idetë e tyre lidhur me statusin final të Kosovës, si dhe prezantuan një letër formale me rekomandime të tyre.

Duke filluar në qershor të vitit 2002, me iniciativë të grave Kosovare dhe me përkrahje të UNIFEM-it, akterë të ndryshëm u grumbulluan për të diskutuar dhe iniciuar hartimin e Planit të Veprimit për arritjen e Barazisë Gjinore (PVBGJ) në Korçulë të Kroacisë. Pas një procesi konsultativ që zgjati dhjetë muaj e në të cilin u përfshinë dhjetëra takime grupesh punuese në të cilat merrnin pjesë ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, përfshirë edhe gratë nga OJQ-të, politika dhe mediat, ky plan u lëshua për diskutim më 22 nëntor të vitit 2002 në një takim në të cilin mori pjesë edhe Kryeministri Bajram Rexhepi. Pas një procesi të revizionit të thukhtë, në të cilin komente dhanë që nga qytetarët e rëndomtë deri tek vendimmarrësit ndërkombëtarë, ky plan i veprimit u finalizua gjatë një takimi në Tiranë të Shqipërisë, në fund të marsit e fillim të prillit të vitit 2003. Pas

muajsh të punës avokuese në emër të aktivistëve lokalë, qeveria e miratoi këtë plan më 14 prill të vitit 2004.

Më 4 mars të vitit 2005, katër delegatë nga Kosova morën pjesë në Konferencën Beijing +10 në Nju Jork. Si panelistë në tri takime dhe si pjesëmarrës në të tjerat, ato ngritën vetëdijen mbi Rezolutën 1325 si dhe ndanë përvojat e grave Kosovare sa i përket asaj. Ato gjithashtu kërkuan zba-

Igballe Rogova i tregon pjesëmarrësve të konferencës mbi përparimet e Rrjetit të Grupit të Grave të Kosovës për zbatimin e Rezolutës së KS të OKB-së 1325.



tim të menjëhershëm të rezolutës në dy takimet e Urgent Action Fund, për publikimin e veprës “Rising Up in Response: Women’s Rights Activism in Conflict” nga Jane Barry, në një takim të OJQ-së në misionin e Britanisë së Madhe në OKB, si dhe në diskutimet pranë Women Waging Peace gjatë të cilave ambasadori Anwarul K. Chowdhury elaboroi mbi përvojën e tij në Kosovë gjatë vitit 2001 si kryesues i delegacionit të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. RRGK publikisht përgëzoi ambasadorin Chowdhury për punën e tij në kërkimin e përhershëm të implementimi të Rezolutës UNSCR 1325.

Në prill të vitit 2005, RTV xhiroi filmin e parë dokumentarë lidhur me Rezolutën 1325, e që bazohet në një punëtori rajonale të organizuar në Sarajevë. Në këtë film, lideret rajonale flasin mbi rëndësinë e rezolutës dhe mënyrat e shfrytëzimit të saj. Dokumentari është emituar në RTV21 si dhe në Bosnjë e Hercegovinë, Kroaci, Serbi dhe Nju Jork nga UNIFEM dhe DPKO. Pas emetimit të filmit, RTV21 organizoi një debat në të cilin pjesëtarët e RRGK dhe përfaqësuesit e qeverisë diskutuan mbi filmin dhe mbi implementimin e Rezolutës 1325 në Kosovë.

Duke filluar në maj të vitit 2005, UNIFEM, RRGK dhe Zene Zenama (nga Sarajeva) bashkëpunuan në hulumtimin dhe përpilimin e një raporti mbi shkallën e implementimit të Rezolutës 1325 në Kosovë dhe Bosnjë. Në Kosovë janë mbajtur intervista me organizata të ndryshme vendore e ndërkombëtare, qeveritare e joqeveritare për të kuptuar më shumë mbi përpjekjet e tyre drejt implementimit të Rezolutës 1325, përfshirë edhe PSSP-në Søren Jessen-Petersen. RRGK dhe Zene Zenama i dërguan një përmbledhje të projektraportit me rekomandimet e tyre tek Organizata e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në përvjetorin e pestë të rezolutës. Vetë procesi i intervistimit shërbeu për të ngritur vetëdijen e qeveritarëve lidhur me Rezolutën 1325 dhe përkrahu bartjen e informatave mes organeve qeveritare dhe joqeveritare. Si rrjedhojë u formuan edhe partneritete të reja. Një nga rezultatet e këtij procesi është edhe krijimi i njësisë për çështje gjinore në Trupat Mbrojtëse të Kosovës.

Që nga qershori i vitit 2005, UNIFEM-i ka punuar me njësitë për çështje gjinore në Trupat Mbrojtëse të Kosovës dhe Shërbimit Policor të Kosovës. Këto njësi janë formuar pas trajnimeve të mbajtura nga UNIFEM lidhur me Rezolutën 1325. UNIFEM-i në bashkëpunim me RRGK dhe KFOR vazhdoi të përkrahë SHPK dhe TMK përmes trajnimeve mbi çështjet gjinore, legjisllacionin, punëtori mbi barazinë gjinore, si dhe ngritje të kapaciteteve të njësisve gjinore dhe të menaxhmentit të lartë.

Më 28 shtator të vitit 2005, në një takim të ndërmjetësuar nga UNIFEM, pesë përfaqësues të RRGK u takuan me UNIFEM dhe me Departamentin për

Operacione Paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, përfshirë edhe Wolfgang Weisbrod-Weber, drejtor i DPKO për Evropë dhe Amerikë Latine. Përfaqësueset e RRGK prezantuan brengat e tyre lidhur me mungesën e kanalizimit të çështjeve gjinore në UNMIK dhe me pjesëmarrjen e grave në bisedimet mbi statusin. Zyrtarët e DPKO u pajtuan që të kenë bashkëpunim në të ardhmen dhe të ofrojnë ndihmë në ndikimin tek agjendat e zyrtarëve të lartë, për të siguruar se ata do të organizojnë takim me organizata të grave.

Në dhjetor të vitit 2005, liderë kyçë rajonal nga shoqëria civile dhe politika u takuan në Dubrovnik për të diskutuar mbi paqen dhe sigurinë. Ata u fokusuan në gjendjen në Kosovë dhe Serbi, duke diskutuar mbi mënyrat e shfrytëzimit të Rezolutës 1325 në qëllim të sigurimit të përfshirjes së grave të dy vendeve në vendimmarrje. Ky takim u inicua nga UNIFEM dhe shpjeu deri tek formimi i Lobit Rajonal për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në Evropën Juglindore.

Në shtator të vitit 2005, gratë Kosovare u takuan me të Deleguarin Special të OKB-së, ambasadorin Kai Eide. Aktivistet e filluan takimin duke diskutuar mbi çështjen e përfshirjes së grave në bisedimet për statusin final politik të Kosovës. Ambasadori u përgjigj në shaka "Mos më flisni si burra". Aktivistet mbeten të shtangura dhe kësaj iu përgjigjën duke thënë se Rezoluta 1325 u jep të drejtë që të flasin për statusin final politik të Kosovës. Ato theksuan rëndësinë e involvimit të grave në negociatat mbi statusin.

Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK), Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK), UNIFEM, KFOR, policia e UNMIK-ut dhe Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës kanë iniciuar një bashkëpunim drejt avancimit të implementimit të Rezolutës 1325. Saktësisht, UNIFEM dhe RRGK do të përkrahin njësitë për çështje gjinore në TMK dhe SHPK përmes trajnimeve, këmbimit të informatave dhe bashkëpunimit mbi aktivitetet që adresojnë rolin e gruas në vendimmarrje, trafikim dhe dhunë familjare. Në përgjithësi, kjo nismë mëton të rrisë nivelin e komunikimit mes grave dhe policisë dhe sektorëve të sigurisë.

Më 3 mars, gratë Kosovare u takuan me Presidentin Ahtisaari dhe theksuan nevojën e përfshirjes së grave në bisedimet mbi statusin final të Kosovës. Gratë Kosovare avokuan për mbajtjen e këtij takimi gjatë takimit që patën me zyrtarët më të lartë të Departamentit për Operacione Paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork.

Më 5 mars, RRGK nënshkroi një memorandum mirëkuptimi me Gratë në të Zeza nga Serbia përmes të cilit bëhen zotime për monitorimin e procesit të negociatave mbi statusin final të Kosovës, për tu siguruar që zërat e grave do të merren parasysh gjatë negociatave. Kjo iniciativë e përbashkët shpjeu tek krijimi i Koalicionit Paqësor të Grave.

Në javën që i parapriu 8 marsit, përfaqësuesit e RRGK dhe Lobit të Grave Kosovare (LGK) u paraqitën në më se pesëmbëdhjetë media të shtypura e elektronike (p.sh. emisione televizive, artikuj gazetash) në media kombëtare, me ç'rast ngritën vetëdijen e qytetarëve lidhur me Rezolutën 1325 dhe me rëndësinë e saj sa i përket çështjes së përfshirjes së një numri më të madh të grave në vendimmarrje, posaçërisht gjatë negociatave për statusin final politik të Kosovës.

Më 8 mars RRGK dhe LGK organizuan një demonstratë para teatrit kombëtar në Prishtinë. Këngëtarë e aktorë me famë performuan këngë e skeçe të përgatitura enkas për këtë ngjarje, me temë Rezolutën 1325 dhe rëndësinë e përfshirjes së grave në bisedimet mbi statusin final të Kosovës. 200 kopje të materialeve të shtypura mbi Rezolutën 1325 u shpërndanë pjesëmarrësve. Të gjitha kanalet kombëtare televizive dhanë pamje nga kjo demonstratë në edicionet qendrore të lajmeve të tyre. Pas këtij organizimi, pjesëmarrësit varën një pamflet të madh që shkruante "Rezoluta 1325 na garanton të drejtën për pjesëmarrje në bisedimet për statusin final" jashtë ndërtesës së parlamentit në qendër të Prishtinës, ku ende vazhdon të qëndrojë dhe të shihet nga të gjithë qytetarët dhe politikanët. Aktivistet Kosovare dhe organizatat lokale i kanë dërguar letra të shumta vendimmarrësve vendorë e ndërkombëtarë, përmes të cilave kërkohej përfshirja në ekipin negociator për statusin final të Kosovës, siç edhe garantohet me Rezolutën 1325. Letra të tilla i janë dërguar: të Deleguarit Special të OKB-së për Statusin Final të Kosovës Martti Ahtisaari, Këshillit të Sigurimit të OKB-së, PSSP-së Søren Jessen-Petersen, Presidentit Fatmir Sejdiu, Kryeministrit Agim Çeku, Komandantit të KFOR-it Giuseppe Valotto, ekipit negociator, dhe grupit të kontaktit të zyrave të kuintit në Kosovë. Kjo letër gjithashtu u lexua gjatë demonstratës së lartpërmendur.

Qershorin e kaluar, RRGK arriti pajtueshmëri me Taskforcën Shumëkombëshe, për ofrimin e një serie informatash për disa baza të KFOR-it. Këto bisedime filluan në muajin korrik, dhe u zhvillua asisoj që punonjësit dhe anëtarët e RRGK jepnin leksione mbi shoqërinë Kosovare, gratë në Kosovë dhe Rezolutën 1325 nëpër baza të KFOR-it në tërë rajonin që mbulohet nga Taskforca Shumëkombëshe.

Gjashtë seanca të tilla janë organizuar në bazat vijuese: në kampet finlandeze, suedeze dhe irlandeze. Së shpejti do të mbahen bisedime në kampin sllovak. Bisedimet janë kryer nga stafi i RrGK-së, dhe një organizatë e cila punon në zonën e siguruar nga ato trupa dha informata mbi problemet me të cilat përballlet komuniteti lokal. Ky zhvillim u vlerësua si tejet pozitiv nga të gjitha palët, pasi që mundësonte sajimin e një lloji të rrjetëzimit, ndërsa kampit i ofronte informata kontakti për personat tek të cilët mund t'i referojnë rastet tek të cilat hasin gjatë patrullimit në rajonet që mbulojnë.

Aspekti rajonal i Sigurisë i lidhur me Rezolutën e KS të OKB-së 1325

Nga Flora Macula

Grupet dhe rrjetet e grave në nivel rrënjësor kanë zhvilluar shumë aktivitete për parandalimin e konfliktit, gjatë konfliktit dhe promovimin e pajtimit përmes proceseve joformale. Megjithatë, gratë nuk janë të pranishme në tryezat formale të negociatave dhe pjesëmarrja e tyre në proceset formale të negociatave paqësore vazhdon të mohohet. Me synim të fuqizimit të ndikimit të perspektivës së grave në proceset e ndërtimit të paqes, gratë aktiviste janë duke përdorur normat dhe standardet ndërkombëtare për promovimin e mbrojtjes gjatë konflikteve të armatosura dhe pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrjet për paqe dhe siguri.



Flora Macula përshkruan punën e UNIFEM-it në rajon drejt zbatimit të Rezolutës së KS të OKB-së 1325.

Janë dy vargjet të standardeve të Rezolutës 1325 të KS të OKB-së mbi gratë. Paqja dhe siguria dhe CEDAW janë përdorur si mjete për shtytjen e agjendës së barazisë gjinore përpara në situata të konfliktit dhe të pas konfliktit. Rezoluta 1325 tregon se KS ka njohur rëndësinë e përvojave të grave mbi konfliktin në mandatin e tij të paqes dhe sigurisë dhe angazhon KS-në në avancimin e të drejtave të grave në proceset e zgjidhjes së konfliktit dhe proceset paqësore.

Ne jemi në një fazë të pas konfliktit, por në rajonin tonë situata politike është shumë e brishtë dhe e paqëndrueshme. Ndërtimi i marrëdhënieve ndërmjet linjave etnike dhe politike matanë kufijve, dhe brenda vendeve individuale, është esenciale për arritjen e paqes dhe stabilitetit. Lëvizja e grave në rajon ka qenë në pjesën e përparme të përpjekjeve për iniciimin e bashkëpunimit dhe rivendosjes së besimit të dyanshëm brenda dhe ndërmjet komuniteteve dhe ndërmjet vendeve. Rezoluta 1325 mbi gratë, paqen dhe sigurinë i referohet situatave të pas konfliktit dhe misioneve paqësore, dhe angazhon Këshillin e Sigurimit në avancimin e të drejtave të gruas në proceset e zgjidhjes së konfliktit, paqes dhe të zhvillimit. Rezoluta përmban 18 për përkrahjen e pjesëmarrjes së grave në negociata dhe konsolidime paqësore, dhe bën thirrje për rritje të përfaqësimit të grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes në institucionet që promovojnë sigurinë. Rezoluta, për më tepër, i bën thirrje të gjitha palëve të konfliktit dhe të ndërtimit të paqes që: t'i përgjigjen nevojave të grave në drejtësinë e pas konfliktit dhe institucionet qeverisëse; të adresojë nevojat e grave në çarmatime, demobilizim dhe riintegrim; të mbrojnë gratë dhe vajzat nga dhuna seksuale, dhe t'i jap fund mosndëshkimit për krimet kundër njerëzimit që prekin gratë.

Zbatimi i Rezolutës të KS të OKB-së 1325 në Kosovë dhe në rajonin e EJ UNIFEM-i dhe partnerë tjerë përkrahen aktivitetet në tre sektorë; Shoqërinë civile, Sektorin e sigurisë dhe Gratë në politikë në Rajonin e Evropës Juglindore. Përpjekjet për të ndërtuar marrëdhënie ndërmjet të gjitha këtyre sektorëve janë ndërmarrë në disa aktivitete të përbashkëta. Aktivitetet përqendrohen në katër elemente kryesore:

- 1) Integrimi i grave në proceset paqësor të vendimmarrjes;
- 2) Të drejtat e gruas dhe elidimi i dhunës ndaj gruas ;
- 3) Trajnimi në sektorin e sigurisë mbi Barazinë gjinore (përfshirë armët e lehta);
- 4) Monitorimi i Rezolutës së KS të OKB-së 1325 – Kanalet raportuese të OKB-së

Sektori i Shoqërisë Civile

Që nga 2003-4, si pjesë e projektit të saj të vazhdueshëm në Kosovë, UNIFEM-i në bashkëpunim me Kvinna till Kvinna përkrahu nj grup të grave udhëheqëse nga Ballkani që të mblidhen dhe të shqyrtojnë statusin e implementimit të Rezolutës 1325 dhe të kryejnë një seancë të “brainstorm” mbi mundësitë për avokim të implementimit të saj. Një grup punues rajonal i përbërë nga përfaqësues nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, është formuar që të planifikojë dhe organizojë një trajnim dhe punëtori rajonale mbi Rezolutën 1325, që u mbajt në Sarajevë. Në punëtor, gratë identifikuan se promovimi i Rezolutës 1325 është i nevojshëm dhe shprehën interesimin dhe përkushtimin e tyre të fuqishëm për të investuar më tutje në monitorimin e implementimit të Rezolutës 1325, veçanërisht në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë, ku OKB-ja vazhdonte luaj një rol të dukshëm në procesin e ndërtimit të paqes së pas konfliktit. UNIFEM-i më pas përkrahu përgatitjen e dy raporteve monitoruese mbi statusin e implementimit të Rezolutës 1325 përmes grupeve punuese në Kosovë dhe Bosnje dhe Hercegovinë. Deri në fund të këtij viti presim që të marrim raportet nga RrGK dhe Zenen Zenama nga Bosnja e Hercegovina. Një film dokumentar mbi punëtorinë mbi Rezolutën 1325 në Sarajevë i prodhuar nga RTV21 është prezantuar dhe shfaqur në të gjitha vendet e EJJ, posaçërisht në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Kroaci: filmi dokumentar është transmetuar përmes RTV 21 gjatë hapjes së debatit televiziv mbi Sigurinë dhe gratë.

Grupet e grave në Kosovë nën ombrellën e RrGK-së janë angazhuar në avokim për përfshirjen e tyre në bisedimet e ardhshme të tilla, dërgimin e letrave dhe raporteve tek zyrtarë të lartë, organizimin e protestave, dhe aktivitete tjera. Dega e Serbisë e rrjetit të grave në të zeza dhe rrjeti i grave të Kosovës gjithashtu kanë paralajmëruar synimin e tyre për t’u angazhuar në monitorimin e procesit

negociator ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës dhe avokojnë që perspektiva e grave të reflektohen si duhet. Është dhënë përkrahje për Gratë në të zeza të Serbisë dhe Rrjetin e grave të Kosovës në themelimin e Koalicionit paqësor të grave.

Aktivitetet e KPG-së: nxjerrja e deklaratave për zyrtarë të lartë në rajon dhe në nivelin global. Në vitin 2006, 60 anëtarë të koalicionit nga Kosova dhe Serbia u takuan në Strugë, në të njëjtën kohë kur në Vjenë mbahej rrethi i radhës i negociatave. Takimi iu kushtua dialogut drejt ndërtimit të besimit dhe adresimit të nevojave për pajtim, meqë kjo ishte hera e parë që nga lufta që gratë nga Serbia dhe Kosova u mbledhën së bashku.

Pjesëmarrja e anëtarëve të KPG-së në takimet e LGP-së në Vjenë dhe në ngjarjet tjera të ndërtimit të paqes ishin mbresëlënëse. Në anën tjetër, si RrGK ashtu edhe GZ janë duke zhvilluar aktivitete të ndryshme mbi paqen dhe sigurinë në shtetet e tyre.

Lobi i grave për paqe siguri dhe drejtësi në Evropën Juglindore

Duke iu përgjigjur kërkesës, UNIFEM-i përkrahu një grup të grave të mirënjohura që të mbledhen së bashku në dhjetor të vitit 2005 për një dialog joformal mbi sigurinë dhe të drejtat e grave në kontekst të ndryshimeve politike që kanë ngjarë në rajon dhe në pritje të fillimit të bisedimeve për statusin e Kosovës. Ky takim fillestar kishte një atmosferë besimi në mes të grave dhe më pas, nga data 16-19 korrik 2006 në Zagreb të Kroacisë u mbajt takimi i dytë joformal këshillëdhënës ndërmjet grave nga sektori politik dhe i shoqërisë civile të Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Si rrjedhojë e konsultimeve u themelua Lobi grave për paqe, siguri dhe drejtësi në Evropën juglindore.

UNIFEM-i ndihmoi Lobin e grave që të merr pjesë në takime të nivelit të lartë të aktiviteteve në Vjenë në shtator të vitit 2006, përfshirë një panel diskutimesh me titull "Ndikimi i grave në paqen e qëndrueshme në Ballkan" të hapur nga Drejtori ekzekutiv i UNIFEM-it Noeleen Heyzer. Veç kësaj, grupi u takua me ministra të qeverisë austriake si dhe mori pjesë në punëtorinë me titull "Proceset negociatore dhe përtej: Samiti i grave për paqe të qëndrueshme në Ballkan". Pas takimeve në Vjenë, UNIFEM-i aranzhoi takimin e tri përfaqësuesve të Lobit rajonal të grave me z. Martti Ahtisaarin, të Dërguarin e posaçëm e Sekretarit të përgjithshëm të OKB-së për Kosovën, që të diskutojë procesin negociator. Duke njohur se zgjidhja e statusit të Kosovës është kritike për stabilitet të qëndrueshëm, Lobi rajonal i grave i dorëzoi z. Ahtisaarit një letër të hapur duke bërë thirrje që të përkrah paqen e drejtë dhe të qëndrueshme në Kosovë. Krahas letrës për z. Ahtisaarin, Lobi nxori një deklaratë duke shprehur shqetësimin mbi

mungesën e lirisë së të shprehurit në Serbi dhe sigurinë e aktivisteve Serbe. UNIFEM-i vazhdon të përkrahë Lobin rajonal të grave në avokim dhe planin e tyre të veprimit për vitin 2007.

Takimi i LRG-së në Vjenë i organizuar nga RrGK dhe i përkrahur nga UNIFEM-i u mbajt më 19 dhe 20 prill, 2007. Krahas anëtareve të LRG-së (dy nga ta ishin nga Serbia, SB dhe NK) lobuan gjatë misionit të ambasadorëve të KS-së për mbledhjen e fakteve në Kosovë.

Ka edhe aktivitete tjera të cilat nuk i përmenda në këtë fjalim, por shpresoj që gjatë këtyre dy ditëve do të ndani informata dhe do të zbuloni më shumë mbi përpjekjet dhe do të vendosni për mënyrën e vazhimit të punës së bashku për të kontribuar për paqe dhe siguri.

UNIFEM-i ka bashkëpunuar me partneren e saj në Serbi, Gratë në të zeza, për ndërtimin e paqes dhe sigurinë me një propozim specifik të vendit i cili adreson efektet e fundamentalizmit fetar në të drejtat e gruas, hulumtimin e bazuar në avokim të të drejtës së riprodhimit dhe sigurisë së riprodhimit, dhe monitorimit të gjykimeve të krimeve të luftës brenda Serbisë me synim të konfrontimit me të kaluarën e nacionalizmit dhe dhunës. UNIFEM-i përkrahu Medica Kosova në arritjen e amendamentit të ligjit për viktimat civile të luftës që do të siguronte përfitime dhe status të veçantë civil për të mbijetuarit e dhunimeve gjatë luftës, si dhe OJQ-në NORMA (shoqatë e grave juriste) në sigurimin e punëtorive ndëretnike për gratë në enklavat serbe. Për punëtoritë, gratë serbe janë sjellë në Prishtinë në mënyrë që të njihen nga afër me institucionet e qeverisë së Kosovës dhe për të pasur qasje në të. Në njërin nga punëtoritë mori pjesë Ambasadorja mirëdashëse, Nicole Kidman, gjatë vizitës së saj në terren në tetor të vitit 2006 që ishte ndjekur nga dy anëtare të LRG nga Serbia, deputetet Natasa Micic dhe Sonja Biserko. Më vonë, në bashkëpunim me Komitetin e Helsinkit për të drejta të njeriut, Lobi rajonal i grave për paqe dhe siguri dhe NORMA organizuan një takim në një komunitet serb me synim të ndërtimit të urave mes grave serbe në enklava dhe grave deputete. Si rrjedhojë e dialogu, parlamentaret ndërmorën hapa për të siguruar një gjenerator për furrën e fshatit në një enklave serbe, në mënyrë që buka të mund të gatohet edhe nëse nuk ka rrymë.

Përkrahja e trajnimit të gjinive dhe ndërtimi i kapaciteteve për sektorin e sigurisë

UNIFEM-i nënshkroi Memorandume të mirëkuptimit për të siguruar trajnime për Akademinë kosovare për siguri publike, arsim dhe zhvillim (AKSPAZh). Asistencë teknike dhe financiare është siguruar për Shërbimin policor të

Kosovës (ShPK) dhe Trupat mbrojtëse të Kosovës (TMK). Synimi i këtyre trajnimeve ishte mainstrimi i çështjeve gjinore në këto tri institucione. Deri më tani ShPK dhe TMK kanë themeluar njësitë për çështje gjinore në nivele të larta që do të ngarkohen me avancimin e implementimit të Rezolutës 1325 brenda këtyre institucioni.

Në vitin 2006 përkrahja u përqendrua në ndërtimin e rregulloreve bazuar në ligjin për barazi gjinore duke ofruar konsultime eksperte gjatë punës me ekipin ligjor të TMK-së.

Rezultati: Themelimi i task-forcës për gjini dhe siguri (RrGK është anëtare) Së fundi, me synim të zgjerimit të punës së sektorëve të sigurisë në rajon, UNIFEM-i në Bashkëpunim me KOSSAC (Programi kosovar për kontroll të armëve të lehta) dhe SEESAC (Zyra qendrore e Evropës juglindore dhe lindore për kontrollin e armëve të lehta) organizoi një punëtori rajonale të konsultimeve "Mainstrimi gjinor në sektorin e sigurisë dhe kontrollin e armëve të lehta" për sektorët e sigurisë dhe organizatat hulumtuese të grave nga Kosova, Bosnja dhe Hercegovina, Shqipëria dhe Mali i Zi. Është zhvilluar plani i përbashkët i veprimt ndërmjet këtyre vendeve.

RrGK është duke bashkëpunuar për së afërmi me KFOR-in – përmes ofrimit të trajnimeve dy orësh në kampet ushtarake të KFOR-it.

Në proces është edhe aktiviteti që do të përfshin 11 OJQ të grave serbe dhe do të fillojë në dhjetor të vitit 2006, përmes KGSC aktivistet e komunitetit RAE filluan koordinimin e aktiviteteve të tyre. Janë realizuar aktivitete tjera siç janë; takime me anëtarë, këmbim përvojash, takime të rrjetit dhe ndërtim të kapaciteteve për rrjetin.

Në prapavijë të bisedimeve për statusin e Kosovës, në vitin 2006 Struga solli në pah punën e aktivisteve në nivelin lokal, dhe mundimet e tyre për krijimin e paqes së qëndrueshme dhe të drejtë në rajon.

Përkundër punës së filluar nga avokatët, në të gjitha vendet e pas luftës të Evropës juglindore, akoma ka mungesë të vetëdijes mbi Rezolutën e KS të OKB-së 1325 të vendimmarrësit si dhe të publiku i gjerë. Në një kohë kur situata politike mbetet shumë e brishtë avokimi për Rezolutën 1325 paraqet një mundësi për të sjellë gra dhe burra përtej kufijve etnikë dhe kombëtarë për të diskutuar dhe promovuar agjendën politike që përkrah parimet e paqes, të drejtave të njeriut dhe drejtësisë. UNIFEM-i është duke shikuar që të përkrah aktivizmin e grave për paqe në implementimin e Rezolutës 1325 në të gjitha vendet e Evropës juglindore.

Rekomandimet e Grupit Punues: Rrjetëzimi Horizontal

Pas diskutimeve të panelit, pjesëmarrësit e konferencës i ndanë në grupe punuese për të përcaktuar strategjitë e mënyrave konkrete për rrjetëzime horizontale në mes të aktivisteve nga Serbia dhe Kosova. Katër grupet punuese janë ngarkuar me identifikimin e aktiviteteve specifike, konkrete për muajt e mbetur të 2007 dhe për 2008. Rekomandimet e bëra nga grupet punuese do të rezultojnë në themelet në të cilat do të bazohen rrjetëzimet dhe aktivitetet e ardhshme të Koalicioni të Grave për Paqe.

Pas seancës prej një orë e gjysmë dhe pauzës së drekës, çdo grup punues prezantoi diskutimet e tyre dhe rekomandimet për aktivitetet e ardhshme.



Pjesëmarrësit e grupit punues diskutuan aktivitetet e ardhshme horizontale të rrjetëzimit për KGP.

Grupi Punues 2

Grupi punues diskutoi përvojat e rrjetëzimit dhe mënyrën që ata e definonin rrjetëzimin horizontal. Një shembull i dhënë ishte fushata kundër kancerit në gji. Grupi rekomandoi veprimet vijuese:

- Kontaktimin e viktimave të luftës në Kosovë dhe të punuarit me gratë e komunitetit serb për t'i ndihmuar ato në integrimin e tyre në jetën në Kosovë. Gjatë gjashtë muajve të parë të vitit të ardhshëm, koalicioni do të duhej të fillonte aktivitete të përbashkëta të definuara në detaje nga Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës dhe Gratë në të Zeza.
- Mbajtja e seminareve me gratë serbe. Së pari seminaret mund të përfshijnë diskutime të përgjithshme. Më vonë, diskutimet mund të përqendrohen në përballjen me të kaluarën dhe të tentojnë të shpëputen nga e kaluara.
- Ne nuk besojmë që duhet të shkojmë drejtpërdrejtë në vendbanime të viktimave të luftës. Unë i kam treguar disa pengesa në komunitetin tim në Gjakovë. Në vend të kësaj, ne do të duhej t'i merrnim viktimat që shprehin gatishmëri që të shkojnë një ekskursion për drekë apo ngjashëm, që do të duhej të definohej.
- E njëjta gjë mund të bëhet me gratë serbe. Për shembull, Sevdije Bunjaku tha se ajo njihet dhe punon me 12 organizata të grave serbe. Ne nuk mendojmë se do të ishte shumë e vështirë që të arrihet kontakti me organizatat që janë të gatshme për të bërë një gjë të tillë. Organizatat që punojnë për paqe janë të gatshme për të bashkëpunuar. Ne kemi menduar se muajt e parë duhet të përqendrohen në këto aktivitete, dhe gjysma e dytë e vitit mund të përfshijë vizita të viktimave të luftës.

Grupi Punues 3

Nëntëmbëdhjetë anëtarët e grupit punues të cilët kishin përfaqësues nga Kosova dhe Serbia identifikuan veprimet vijuese:

- Tani e tutje na duhet puna horizontale ndërmjet anëtarëve brenda koalicionit, posaçërisht në mes të grave serbe nga Kosova në Koalicionin e grave për paqe dhe grave nga Serbia.
- Neve na duhet një veprim i quajtur “më tako që të më kuptosh.” Ne kemi vendosur që katër aktiviste që përfaqësojnë dy apo tre grupe nga Kosova duhet të vizitojnë gratë në Serbi dhe anasjelltas. Ne do të organizojmë tubime dhe rrjetëzime në mes të grupeve ku do t'i kemi dy apo tri ditë punë. Do të kemi punëtori sikur kjo këtu për gra, për të identifikuar hapat drejt paqes.
- Duhet t'i krijojmë dy lista të adresave postare për gratë në Kosovë dhe Serbi për të distribuuar si duhet dhe për të marrë informata mbi atë që bëjnë rrjetet tona. Përfaqësueset e Kosovës janë paraqitur vullnetare për të përkthyer materialet nëse ka nevojë për një gjë të tillë.
- Solidariteti në mes të grupeve të grave. Ne jemi pajtuar se nuk informo hemi aq sa duhet dhe ngurtësohemi si kolegë dhe shokë. Për shembull, disa aktivistë janë sulmuar nga mediat. Ne duhet të reagojmë dhe të përkrahim njëra-tjetrën.



- Një nga problemet më të mëdhenj ishte kalimi i kufijve. Ne dëshirojmë që të marrim veprime ashtu që gratë nga Kosova të kenë qasje në Serbi.

- Është ngritur një çështje e rëndësishme, ajo e rinisë. Grupi ka insistuar në aktivizim më të madh të studentëve dhe nxënësve, në mënyrë që edhe ata të jenë të përfshirë në projekt.

Grupi Punues 4

Gjatë punës në grupe kemi identifikuar fushat e përbashkëta të aktivitetit dhe dallimet. Ne e dimë se diskutimet në lidhje me statusin politik të Kosovës mund të ndryshojnë kornizën dhe mënyrën e punës së grupit tonë, posaçërisht në lidhje me sigurinë. Ne kemi identifikuar aktivitetet vijuese për t'i ndërmarrë së bashku:

- Vizita të përbashkëta të grupeve të grave me qëllim të njohjes me punën e njëri-tjetrit.
- Ne mund të fillojmë këtë duke këmbyer profilet e grupeve. Ne rekomandojmë këmbimin e pro fileve deri më shtator në mënyrë që të dyja rrjetet të kenë profile të gatshme të anëtarëve.
- Ne mendojmë se deri në nëntor ne duhet të bëjmë një vizitë. Gratë nga Serbia duhet të vizitojnë Kosovën, e në veçanti Suharekën. Të dyja palët do të punojnë në organizim. Për shembull, mund të ketë bashkëpunim në mes të Grave për Paqe në Leskocv dhe organizatave në Prizren. Ne do t'i shohim nevoja dhe do të flasim për çështje të mundshme, në mënyrë që vizitat të mos jenë të llojit, por mbi tema specifike. Po ashtu, vizitat do të bëhen të njohura për publikun.
- Vizita në lokacionet e krimit, posaçërisht në Suharekë. Gratë në të Zeza tentuan që të kontaktojnë me familjet gjatë gjykimeve. Mënyra më e mirë përpara do të ishte nëse Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës ndërmjetëson diskutimet, që do të ketë peshë politike dhe një shkallë të seriozitetit. Pastaj, familjet e Suharekës mund të flasim me Rrjetin e Grupit të Grave të Kosovës dhe jo vetëm me Gratë në të Zeza. Ne do të jemi konsistente në qasjen tonë dhe kjo do të jetë e rëndësishme në një moment të tillë.
- Vizitimi i serbëve pasi që të përcaktohet statusi i Kosovës. Pasi të ketë ngjarë ky ndryshim, ne duhet t'i qasemi kësaj në një mënyrë serioze.
- Ka informata të pamjaftueshme në lidhje me ngjarjet politike në zonën tonë. Çdo të dytin muaj, organizata jonë duhet të dërgojë një raport mbi situatën politike.
- Ne duhet të reagojmë menjëherë me deklarata të përbashkëta, posaçërisht në Serbi për shkak të çështjeve të sigurisë. Është një pjesë e vogël që dëshiron të bashkëpunojë dhe siguria e tyre është në rrezik. Në rast të ndonjë ndryshimi politik, siguria e tyre do të rrezikohet edhe më shumë.
- Ne duhet të krijojmë plane proaktive për siguri individuale dhe grupe, duke përfshirë përfundime të mundshme pozitive dhe negative. Ne duhet t'i diskutojmë këto plane me Fondin për Veprime Urgjente para praktikisht në rast se ngjajnë pasoja negative. Në këtë mënyrë, ne do të ishim proaktiv.



Marija Perkoviq shkruan prioritetet e grupit punues.

Pas prezantimit, Rachel Wareham theksoi se ndjente që aktivistet nga Gratë në të Zeza ishin vërtetë duke insistuar në vizita në komunitete, si për shembull Suharekë, por që nuk dukej se qytetarët nga Suhareka ishin të gatshëm për një vizitë të tillë. “Unë nuk mendoj që të dyja anët janë të sigjerta,”tha ajo. “Nuk është e drejtë e një grupi të jashtëm që të takohet me familjet e viktimave.” Ajo tha se aktivistet shqiptare dhe serbe duhet të dëgjojnë atë që nuk thuhet gjatë takimeve të grupeve punuese. Ajo ishte e mendimit që gratë shqiptare nuk ishin duke e shprehur tërësisht shqetësimin e tyre për vizita të tilla. “Unë mendoj se kjo është një çështje komplekse dhe i nxis gratë shqiptare që të bisedojnë hap-tas me Stashën për pengesat potenciale,” tha ajo.

Violeta Selimi u pajtua se duhet të pyeten gratë në Suharekë para se të vizitohet komuniteti i tyre. Përndryshe koalicioni nuk do të dinte nëse gratë janë të gatshme për një vizitë të tillë.

Flora Macula pastaj theksoi se nëse një komunitet serb është sulmuar në Kosovë, grupi pajtohet që rregullisht të informojnë njëra-tjetrën mbi incidente të tilla dhe pastaj të lëshojnë deklarata të përbashkëta në emër të koalicionit, duke dënuar akte të tilla të dhunës.



Në grupin e katërt punues, pjesëmarrëset diskutuan aktivitetet e ardhshme horizontale të rrjetëzimit për KGP.

Grupi Punues 1

Koalicioni i Grave për Paqe është themeluar për shkak të situatës politike në Kosovë. Për këtë arsye, duhet të vazhdojmë të reagojmë mbi situatën në Kosovë. Ne nuk mund t'i referohemi koalicionit si ju, Gratë në të Zeza, dhe ne, RrGGK. Ky është koalicion. Prandaj, ne kemi menduar mbi aktivitete të cilat do t'i tregojnë publikut se ne jemi koalicion. Ne kemi dërguar letra dhe deklarata të përbashkëta, por mbrëmë në Strugë ne pamë se kemi mungesë të dukshmërisë publike si koalicion. Mbrëmë, aktiviteti u krye nga Gratë në të Zeza, por si koalicion neve na duhet diçka publike e atij lloji. Ne e kishim këtë ide mbrëmë. Të mendojmë se si do ta bëjmë porosinë tonë publike, pa Rrjetin e grupit të grave të Kosovës apo Gratë në të zeza. Në vend të kësaj, flamuj që lexojnë “Gratë shqiptare janë motrat tona” kanë nevojë për deklarata të reja në lidhje me situatën politike, por, po ashtu, si koalicion. Ne duhet të kemi ide të përbashkëta dhe të kemi performanca publike në tërë Kosovën. Prezantimet publike janë të

rëndësishme për dy arsye. Së pari, ne dërguan letra, por ne duhet që fizikisht të shihemi duke thënë se e dëshirojmë pavarësinë e Kosovës dhe integrimin e serbëve. Së dyti, janë shqiptarët në Kosovë të cilët i japin siguri njerëzve. Nuk janë policia dhe forcat e armatosura. Kur ata të shohin se ne jemi duke e dhënë një porosi paqësore, ata do të jenë më të vetëdijshëm.

Për sa i përket vizitave në lokacionet ku ka ngjarë dhuna, [Rachel \[Wareham\]](#) e theksoi një çështje të rëndësishme. Ne duhet t'i pyesim ata [njerëzit që jetojnë në këto komunitete]. Më parë ne i kemi pyetur dhe ata thanë "jo" për vizita të tilla, por ishte përvjetori i masakrës. Ata thanë "jo" për shkak se Kryeministri ishte atje dhe ata nuk e dëshironin atë apo publikun që të shohin dikë nga Beogradi të pranishëm atje. Ne duhet t'i pyesim ata përsëri nëse do të pranojnë. Nëse ata pranojnë, mund të aranzhojmë një vizitë. Dhe ne mund të kemi performanca publike. Ne madje mund të ngjyrosim autobusë sikurse që bëri UNHCR kur i solli refugjatët.

Gratë në të Zeza vetëm mund të duken si armike, por si koalicion ne mund të organizojmë një diçka të tillë. Për shembull, takimi me Sonja Biserko ishte i suksesshëm sepse gratë shqiptare dhe ato serbe ishin së bashku. Ne duhet të shkojmë së bashku si Koalicioni i Grave për Paqe, jo si Gratë në të Zeza apo Rrjeti i Grave të Kosovës. Ngjarjet mund të ndodhin së bashku dhe në këtë mënyrë mund të kursejmë para. Përfundimisht, ne diskutuam çështjen e të kaluarës. Ne kurrë nuk do të kemi kohë të mjaftueshme. Ne duhet të organizojmë seminare dy apo treditore që do të përqendroheshin vetëm në këtë temë. Ne mund të organizojmë një program arsimor. Për shembull, në Serbi akoma thuhet se gratë shqiptare nuk dalin nga shtëpitë e tyre dhe i kanë nga dhjetë fëmijë. Ata nuk kanë njohuri mbi atë që ka ndodhur në Kosovë. E njëjta gjë ndodhë me shqiptarët. Violeta [Selimi] ka ofruar që të shkojë në Serbi. Përmes programeve arsimore, ne mund të përdorim radion dhe pse jo, të botojmë një libër? Haya Shalom i tregoi grupit tonë mbi botimin e një libri me tregimet e tyre: atë që të dyja palët e kanë përjetuar së bashku.

Pas prezantimit final, [Radosava Mirković](#) rekomandoi që koalicioni të përfshijë një porosi tjetër në fushatën e vet publike në Prishtinë, "Gratë serbe janë motrat tona." "Atëherë ne [serbët e Kosovës] do të kemi një lloj sigurie," tha ajo. "Se rrjeti është me ne dhe se ata do të na ndihmojnë."

[Veprorë Shehu](#) shtoi një element tjetër, që nuk ishte definuar konkretisht, por që ishte pjesë e rrjetëzimit, tha ajo. Ajo sugjeroi që të rrjetëzohen me asociacionin e grave të Kosovës Jeta - Vita, që merret me shëndetin e grave, posaçërisht kancerin në gji. "Ne mund të këmbejmë informata mbi parandalimin e kancerit në gji," tha ajo. Ajo theksoi edhe rëndësinë e vizitimit të viktimave të luftës dhe marrjen e pëlqimit të tyre para se të sjellin vizitorë. "Ne nuk mund të imponojmë," tha ajo. "Vizitat duhet të jenë domethënëse. Gratë nuk duhet vetëm të thonë 'Në rregull, pajtohem sepse organizata që kërkon këtë vizitë na përkrahë.' Pëlqimi duhet të vijë nga thellësia e zemrës."

Përmbledhja dhe Përfundimet e Konferencës, Hapat e Ardhshëm

Nga Stasha Zajvoviq

Dita e djeshme ishte plot me aktivitete. Kishim shumë postera dhe nuk ishim në mundësi t'i përdorim të gjitha gjatë demonstrimit në rrugë. Unë e kam imagjinuar këtë si performancë të përbashkët. "Shqiptaret janë motrat tona" është një porosi emocionale dhe politike për ne. Në vitin 1995 ne e kemi shfaqur këtë porosi dhe nuk kemi mundur të paramendojmë se nuk do ta shfaqnim atë. Ne dëshiruam që të hyjmë në histori së bashku dhe të krijojmë historinë tonë alternative. Nevoja jomë feministe është që të hyjmë në çdo gjë që kemi përjetuar në të kaluarën dhe të shënojmë atë që kemi bërë në këtë protestë dhe të protestën e fundit. Ne kemi shumë përvojë në histori. Nuk do të ishte e përgjegjshme nëse nuk do ta shënonim këtë në histori. Ne do ta shënojmë këtë histori.

Ne kemi punuar së bashku në dy nivele, duke u mundur të krijojmë një bilanc në mes të politikës së emocioneve dhe politikës së efikasitetit. Po ashtu, ne kemi pasqyruar mendime mbi veten dhe dëshirat tona, të ndërtaura në përvojën tonë dhe kemi shkruar dhe krijuar teori. Këto teori janë në pajtim me emocionet tona dhe ne dëshirojmë që t'i japim vlerë këtyre teorive dhe emocioneve. Nga momenti që e nisëm këtë rrugëtim dhe kur ju pamë të gjithave në hotel, e patëm një gëzim të madh që të vijmë në këtë shtëpi me ju. Ne ishim efikase sepse flasim haptas për këto çështje.

Kemi shumë për të bërë në të ardhmen. Ne ishim të dukshme për njëra-tjetrën shumë kohë më parë, por duhet të bëhemi të dukshme për liderët politikë që marrin vendime dhe për komunitetin. Kjo është detyra jonë civile dhe feministe, si dhe detyra jonë që të kontribuojmë në drejtësi. Ne mund ta bëjmë këtë përmes solidaritetit të grave. Ne kurrë nuk do të shpërfillim atë që e ndajmë për njëra-tjetrën duke iu falënderuar këtij besimi që po e krijojmë.

Nga Flora Macula

Si gjithmonë, jam mundur të jem pragmatike mbi propozimet që ju i ofroni. Unë e kam një vërejtje të rëndësishme: ajo që mungon është planifikimi proaktiv. Çështjet në të cilat ju punoni janë të ndjeshme. Ne nuk e dimë se çka do të ndodhë pas dhjetorit. Ky koalicion duhet të ketë zgjidhje për të reaguar në rast të skenarëve të ndryshëm. Duhet të ketë përgatitje. Nëse çdo gjë është në rregull, ju keni ofruar atë që mundeni. Megjithatë, për shkak të planifikimit joproaktiv, ju keni dështuar që të tregoni se në çfarë drejtimi rrugëtoni. Ndërtimi i paqes është i përgjithshëm. Ju duhet të uleni së bashku si koalicion dhe të merrni parasysh atë që mund të ndodhë dhe si mund të reagoni.

Igo [Rogova] i përmendi aktivitete të vizitave te gratë në Kosovë, performancën e koalicionit, vizitën e mundshme për në Suharekë dhe vizitat në enklava. Unë

besoj se kjo mund të jetë e realizueshme. Ne duhet të kemi këmbim të informatave: lista postare, përcaktim të profileve të OJQ-ve, shpërndarjen e informatave në lidhje me situatën politike, themelimin e sistemeve të këmbimit të informatave në mënyrë që bashkëpunimi të mos ndërpritet pas pak javëve. Kjo është e domosdoshme. Nëse e keni një plan të mirë, ai duhet të përfshijë reagimet ndaj gjërave në Kosovë dhe Serbi. Ju duhet të keni kredibilitet për të reaguar ndaj të gjitha shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Seminare mbi ballafaqimin me të kaluarën: ne duhet të mendojmë se kush bën çka dhe çka duhet të bëhet në mënyrë të përbashkët. Shumë gra nga Kosova nuk mund të shkojnë në Serbi dhe të flasin me gratë atje. Përfundimisht, një libër që do të përfshinte tregime nga të gjitha anët do të sensibilizonte popullin në Kosovë dhe Serbi në lidhje me vuajtjet e njerëzve dhe mënyrën se si njerëzit i dëshmuar këto rrethana. Ne sigurisht që duhet të përfshijmë më shumë të rinj në këto aktivitete.

Iniciativa “më njih që të më kuptosh” mund të kryhet. Gjithashtu, ju mund të shtoni tjera gjëra në këtë iniciativë.


Unë ju uroj për punën që e keni bërë dhe mendoj se keni përparuar mjaft shumë nga pozita e parë.

Nga Igballe Rogova

Ndonëse koalicioni filloi në vitin 2006, rrjetëzimi jonë filloi në vitet 1990, ndoshta jo si rrjete, por si organizatat siç janë Motrat Qiriazit dhe Gratë në të Zeza. Ne gjithmonë kemi qenë të impresionuara me guximin e Grave në të Zeza, dhe ky rrjetëzim është mundësuar nga individët. Këta individë akoma ia dalin që t'i thyejnë kufijtë. Atëherë nuk ka qenë e lehtë që të udhëtohet. Ne quheshim tradhtarë, por kishte guxim të madh në mesin e grave në Beograd për të dalë në rrugë. Madje edhe sot ato dalin rrugë dhe ato rrezikohen për shkak se janë gra

që flasin kundër padrejtësive dhe japin një zë që dallon nga zëri kryesor politik.

Në emër të Rrjetit të Grupit të Grave, ajo dha shpërblime për aktivistet për trimëritë dhe përkushtimin e tyre.



*Lepa Mladjenovic
pranon shpërblimin nga Rrjeti i
Grave të Kosovës për aktivizmin
dhe rrjetëzimin e saj të vazh-
dueshëm.*

Bashkëpunimi i ardhshëm: Përshtypjet dhe Pritjet pas Konferencës



Në krahë të faljes politike: Përshtypjet dhe Pritjet e Aktivisteve pas vitit të dytë në Strugë

Përgatitur nga Miloshi për Gratë në të Zeza

“Të tjerët janë binarë për trenat tonë ...” - Marina Cvetajeva

Kjo ishte hera jonë e dytë në Strugë. Hera e parë ishte vitin e kaluar: takimi jonë i parë i grave nga Serbia dhe grave nga Kosova. Pastaj, ne përgatitem tekstin, Lotët dhe Qeshjen. Të njëjtat aktiviste, përsëri duke kaluar kufijtë pas takimit me gra tjera nga një vend tjetër, gra zëri i të cilave akoma dëgjohej shumë larg, në gjuhën e tyre, dëshmi të ndara të përshtypjeve dhe pritjeve të tyre ...

Përshtypjet mbi këmbimin e tregimeve dhe njohjen e përvojave të të tjerëve ...

“Përshtypja ime e këtij takimi ishte se marrëdhëniet tona ishin më të hapura sesa vitin e kaluar dhe ne folëm me më shumë sinqeritet mbi problemet me të cilat përballlemi të gjitha në rrethinat tona. Unë kisha rastin të mësoj shumë gjëra për të cilat nuk dija se kishin ndodhur në Kosovë.” - Nena, Leskovc

“Unë mendoj se të qenit bashkë, bazuar në vitin e kaluar në Strugë, është shumë i rëndësishëm. Gratë treguan shumë entuziazëm që u takuan dhe bashkëpunuan me njëra-tjetrën. Kjo premtori që takimet tona të jenë më të shpeshta dhe se do të fillojmë diçka. Sugjerime shumë konkrete kanë dalë nga punëtoritë. Ne kemi krijuar një shteg të përbashkët dhe tani vetëm duhet ta ndjekim atë.” - Marina, Krushevac

“Ky ishte takimi im i parë me shqiptaret e Kosovës të cilat mendonin sikurse unë dhe Gratë në të Zeza.” - Srna, Velika Plana

“Unë shkova me mendimin se ne ishim dy bota të ndryshme. Ne vërtetë i kemi dy përvoja të ndryshme, por kur unë i pashë gratë serbe dhe kosovare së bashku duke e përshëndetur njëra-tjetrën, ishte e qartë për mua se [përmes kësaj konference] kemi bërë një punë të pamasë dhe kemi filluar një rrugëtim të rëndësishëm. Për herë të parë, unë jam tani pjesë e atij procesi. Ndoshta gjatë pauzave do të duhej të pyesja gratë më shumë për përjetimet e tyre personale, për vuajtjet e tyre, por nuk guxoja. Do ta bëj atë një herë tjetër. Ishte shumë e rëndësishme për mua që të jem aty. Unë nuk do t'i kem më idetë e gabuara mbi këto marrëdhënie pasi që t'i kemi ndarë përvojat.” - Jovanka, Velika Plana

“Performanca ishte një nga më të mirat sepse ishim së bashku, duke i mbajtur duart.” Lila, Beograd

“Unë kam shumë përshtypje, pro e para është marrëdhënia stabile e miqësisë, besimit, ngrohtësisë dhe çiltërisë. Diskutimet mbi njërën nga temat më të komplikuar, përballjen me të kaluarën dhe përgjegjshmëria, ishin shumë serioze dhe plot me respekt për njëra-tjetrën. Kjo ishte vazhdimisht e pranishme. Shumëllojshmëria dhe qëndrimet e ndryshme të grave nga këto dy vende, jo vetëm që nuk ishte pengesë, por ne vazhdimisht zbuluam se i ndanin të njëjtat sfida. Ekziston një dëshirë e madhe për të punuar së bashku.” - Stasha, Beograd

“Shumica e përshtypjeve më të rëndësishme të mia nga takimi me gratë shqiptare ishte ngrohtësia, kujdesi dhe dashuria me të cilat rrethohesha. Prania e Biljanës, Haya, Christina dhe Rachel në panel dhe në punëtori, përsëriti praktikën tonë të mirë. Në aheng, unë kisha paksa probleme kur e pashë kërcimin dhe këngët. Pyetja ishte pse dhe si ndodhin gjëra të tilla në këtë hapësirë. Unë

nuk kam përgjigje për atë pyetje.” - Senka, Beograd

“Ishte shumë e veçantë për mua që përsëri t’i shoh mikeshat e mia nga Kosova. Unë isha shumë i pikëlluar që nuk i pashë Arjetën dhe Luljetën, por shpresoj se do t’i shoh përsëri së shpejti. Për herë të parë, unë e mbajta një flamur të shkruar në vitin 1995 ‘Gratë shqiptare janë motrat tona.’ Kjo kishte domethënie të madhe për mua emocionalisht.” - Milosh, Beograd

Përshtypjet e grave serbe për gra specifike kosovare ...

“Përshtypja ime më e madhe është gruaja nga Klina e cila akoma është në kërkim të burrit të saj. Ajo ka themeluar organizatën e grave që kërkojnë burrat e tyre.” - Goca, Leskovc

“Përshtypja ime më e madhe ishte kur erdha në Strugë. Unë nuk isha atje vitin e kaluar; Nuk u takova me gra kosovare. Tani, është shumë e veçantë për mua që kam krijuar kontakte personale me Nafijën nga Prishtina. Unë i premtova asaj disa gjëra dhe do ta mbajë fjalën. Unë u takova me disa gra tjera me të cilat drekova dy herë në të njëjtën tavolinë. Ne biseduam me shumë sinqeritet.” - Lila, Leskovc

“Unë jam e tepër e gëzuar sepse shoqja ime Sevdije më fali mua. Asaj iu deshtë një vit që të mendojë se pse kërkoja falje nga ajo për krimet e kryera në emrin tim. Unë jam e lumtur sepse ajo dhe Igo me thanë që të përshëndes familjen time dhe se unë nuk kam nevojë të kërkoj falje nga to. Ato ma falen mua. Ky është një hap i madh për mua.” - Svetlana, Vlasotince

“Unë jam e lumtur që kisha rast të shoh mikeshat e mia kosovare përsëri. Është pikëlluese që këtë vit e pash vetëm Radën dhe Milenën dhe asnjë grua tjetër serbe të cilat jetojnë në Kosovë. Unë jam e lumtur që shoqja ime Rema ndau tregimin e saj me mua; Unë e ndava timen me të. Ndonëse ne pimë kafe pa sheqer, kafeja që ne e pimë në dhomën 407 ishte më e ëmbla që kisha pirë ndonjëherë sepse e piva me mikeshat e mija nga Kosova.” - Jasmina, Vlasotince

“Për mua, ishte shumë e rëndësishme që Igballja e bëri një hap para. Deri më tani ne kemi punuar si Rrjeti i Grave në të Zeza - Serbi dhe Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, por jo së bashku. Ky është një hap përpara.” - Lepa, Beograd

Përshtypjet e Koalicionit të Grave për Paqe, Rrjetit të Grave të Kosovës dhe Rrjeti i Grave në të Zeza - Serbi

“Unë mendoj se ne kemi lëvizur jashtë asaj që është menduar vitin e kaluar, por kemi qëndruar margjinale dhe të paqarta. Rrjetëzimi horizontal është bërë temë

qendrore.” - Slavica, Beograd

“Natyrisht se unë plotësisht e lumtur sepse ky koalicion do të thotë shumë për mua. Për mua, personalisht, ai ka perspektivë të gjerë dhe afatgjate. Unë e shoh atë si model për krijim të paqes në rajonin e Ballkanit.” - Nuna, Sarajevë

“Koalicioni i grave nga Kosova dhe Serbia. Për mua personalisht, më së shumti më lanë përshtypje dy gratë serbe që erdhën me shqiptarët. Unë nuk kam menduar se aktualisht ekzistonte një bashkëpunim i tillë. Përshtypja ime më e madhe ishte organizimi i Grave në të Zeza. Ato të gjitha erdhën nga Serbia. Ato janë organizata e vetme në rajon me autoritet të tillë për të kryer këtë punë. Gratë në të Zeza ishin të suksesshme.” - Biljana, Beograd

“Unë jam e fascinuar me atë që gratë kosovare bëjnë, posaçërisht me rikualifikimin e tyre nga bashkësia ndërkombëtare. Mund të mësojmë shumë nga ta.” - Dushan, Beograd

“Për vite më radhë, unë nuk kam dalë nga një takim me ndjenja kaq të këndshme. Është ky kthim në kohën tonë të artë të aktivizmit. Çdo gjë funksionoi mirë. Gratë nga Kosova me ngazëllyen me energjinë e tyre dhe shikimin e tyre për të ardhmen. Ato e dinë se çka dëshirojnë. Unë shpresoj që ato të mos mashtrohen nga dëshirat e veta. Unë shpresoj se ato do të jenë në gjendje të vazhdojnë bashkëpunimin. Miket e mia nga Gratë në të Zeza ishin brilante. Nuk e di kë të veçoj.” - Senka, Beograd

“Unë u takova me gra të reja nga Kosova. Po ashtu, do t'i bëja komplimente grave tona. Panelet ishin të suksesshme. Përshtypja ime më e madhe ishte mikeshja ime Biljana sepse ajo vazhdimisht me ne. Ajo mori pjesë në mënyrë aktive. Punëtoritë ishin të shkëlqyeshme. Unë dëgjova tregime tjera të vështira nga gratë; ishte prekëse. Ne jemi pajtuar për të gjitha gjërat. Ne kemi punuar mirë. Mbrëmja në diskotekë ishte e mrekullueshme.” - Lila, Beograd

Gratë presin punë të përbashkëta, bashkëpunim ndërpersonal, vizita të dyanshme dhe shoqërizim. Gratë dëshirojnë rrjetëzime horizontale në mes të grupeve. Ato dëshirojnë që Koalicioni i Grave për Paqe të krijojë rrugën e tyre, të shënoj veten në një histori alternative ...

“Unë mendoj se së shpejti do t'i shohim gratë dhe do të kemi më shumë kontakt. Unë shpresoj për bashkëpunim shumë më të thellë, më të ngushtë.” - Nena, Leskovc

“Pritjet e mia janë veprime konkrete për të vazhduar bashkëpunimin me gratë kosovare.” - Goca, Leskovc

“Ndryshe me vitin e kaluar, kur ne u takuam vetëm gra nga Kosova, këtë herë ishim më specifike. Ne kemi filluar diskutime dhe do të fillojmë të punojmë në nëntor.” - Milka, Leskovc

“Pritjet e mia janë që pritjet e mia të realizohen.” - Lila, Leskovc

“Pritjet janë që çdo anë të bëj atë që e diskutoam.” - Svetlana, Vlasotince

“Unë pres bashkëpunim dhe shoqërizim të mëtutjeshëm me gratë kosovare. Unë pres që hapi i bashkëpunimit që e kemi bërë të rritet në një marsh drejt suksesit dhe të vërtetës. Unë dua që të shohim njëra-tjetrën më shpesh.” - Jasmina, Vlasotince

“Unë pres takime tjera me popullin kosovar në mënyrë që t'i dëgjoj idetë e tyre.” - Srna, Velika Plana

“Pritjet e mia janë që rrjetëzimi horizontal të ndodhë këtë vit.” - Slaviqa, Beograd

“Unë pres që ky koalicion të strukturohet dhe që obligimet që marrin përsipër anëtarët të përbushen.” - Nuna, Sarajevë

“Unë pres që koalicioni të zhvillohet dhe që të bëhet rrugë për marrëdhënie të mira në rajon. Ai do të përcaktojë standardet që do t'i miratojnë të tjerët.” - Biljana, Beograd

“Unë pres që puna e përbashkët të vazhdojë.” - Dushan, Beograd

“Unë pres që do të bëjmë veprime së bashku. Ne shkruam letra, por tani do të bëjmë performanca. Ky është një hap para, pas procesit që e kemi filluar së bashku. Me përziejme dhe shoqërohemi më shumë. Më nuk kemi 'ne' dhe 'ata'. Ne jemi gjithnjë e më pak 'ne' dhe 'ata'. Ne jemi shumë më afër njëra-tjetrës. Hapi i veprimeve politike, daljeve në rrugë si koalicion, vazhdon procesin emocional që e kemi filluar.” - Lepa, Beograd

“Tani gratë e njohin njëra-tjetrën më mirë dhe janë të lidhura personalisht. Duhet të ketë bashkëpunim personal me të gjitha grupet në Kosovë.” - Lila, Beograd

“Pritjet e mia ishin që të dëgjojmë diçka të re. Një gjë e tillë do të ishte e këndshme për mua. Ato pritje u përbushën.” - Senka, Beograd

“Pritjet e mia tani për periudhën në vijim janë vërtetë në kornizë të rrjetëzimit horizontal, që ne në të vërtetë ta fusim këtë në praktikë duke organizuar takime dhe për tu pajtuar mbi aktivitetet. Ne do të punojmë shumë seriozisht dhe me

këmbëngulësi në këtë drejtim. Unë jam shumë, shumë e kënaqur dhe ndjem shumë mirë sepse i kryem disa gjëra shumë të rëndësishme. Ne vazhdojmë aty ku kemi ndaluar, tani shumë më shumë së më parë.” - Stasha, Beograd

“Unë pres që do të shkoj te Tahira në Klinë, te Lola në Gjakovë dhe te Violeta, Igo dhe Selveta në Prishtinë. Unë pres drejtësinë e pavarësisë së Kosovës.” - Milosh, Beograd

Tridhjetekatër aktiviste morën pjesë në këtë takim, nga Beogradi, Novi Sadi, Vrbas, Velika Plana, Krushevc, Kraljeva, Zajecari, Novi Pazari, Leskovci, Vlasotince, Presheva dhe Nishi. Takimi zgjati dy ditë. Tema e ditës së parë të takimit ishte “Drejtësia Tranzicionale: Qasja femine.” Ajo është ndarë në dy pjesë: diskutimet në panel në të cilat tema ishin “çka është drejtësia tranzicionale? Pse është e rëndësishme qasja femine?,” “Drejtësia tranzicionale dhe shoqëria civile,” “Modelet e drejtësisë tranzicionale në përvojën e Grave në të zeza,” “Nga mosndëshkimi përmes llogaridhënies në drejtësi,” dhe “Drejtësia tranzicionale: Roli i shoqërisë civile – Vështirësitë dhe sfidat.” Pjesa e dytë ishin punëtoritë. Katër punëtoritë u mbajtën në temat “Etika femine dhe përgjegjësisë,” “Etika femine dhe kujdesit dhe përcjellja e gjytimeve për krime lufte,” “Vizita në lokacionet e krimeve të kryera në emrin tonë dhe falja politike,” dhe “Modelet e drejtësisë tranzicionale: Përvojat e grave në të Zeza.” Atë mbrëmje, një performancë në rrugë me titull “Gratë pajtuese: Ne ecim ngadalë për arritur atje sigurt” është mbajtur, ku gratë nga Kosova dhe Serbia morën pjesë së bashku.

Tema e ditës së dytë ishte siguria. Seanca plenare është mbajtur me temat “Solidariteti i grave: Përvojat e mira dhe pengesat,” “Rezoluta 1325 Gratë, paqja dhe siguria dhe përvojat e Grave në të zeza,” dhe “Aspektet rajonale të sigurisë.” Gjatë pjesës së dytë të ditës, punëtoritë janë organizuar mbi rrjetëzimin horizontal.



Beograd, 10 shtator 2007

Letër për aktivistet kosovare pas konferencës së dytë në Maqedoni, në vjeshtë 2007, me titull:

NJË DËSHIRË E MADHE PËR TË PUNUAR SË BASHKU

Të dashura aktiviste të Kosovës,

Ne akoma jemi duke i ritreguar përshtypjet tona. Ne akoma i pasqyrojmë takimet tona përderisa hamendemi dhe planifikojmë të gjitha gjërat që mund t'i bëjmë pas konferencës sonë të dytë në Strugë. Thënë shkurt, ne duket se jemi bërë më të afërta së bashku dhe ia kemi dalë që të ndërtojmë besim të dyanshëm në mesin tonë. Pas afro 20 viteve të politikës përjashtuese të Serbisë dhe thyerjes së gjithçkaje që është shqiptare, ne e kemi ndërmarrë një hap historik! Këto nuk ishin takime të veçanta në mes të disa nesh, prandaj, kjo nuk është përjashtim apo diçka që ndodhë njëherë - ky është koalicion!

Këmbimet emocionale që ndodhën herën e kaluar, shpalosja e rrëfimeve personale e ka mundësuar këtë udhëtim; ajo krijoi dëshirën për të punuar së bashku, jo vetëm se na përshatet politikisht, por edhe se ne ndjejmë një nxitje emocionale për diçka të tillë. Përplot me ide dhe entuziazëm për të krijuar politikë më ndryshe të jetës së përditshme, ku, në vend të kontaminimeve nacionaliste, ne do të krijojmë hapësira të hapura për këmbime, ku jemi të gatshëm për të dëgjuar njëra-tjetrën, ku ne dëshirojmë të jemi së bashku në veprime konkrete, jo vetëm si frazë por duke larguar pengesat e vetëdijes politike mbi Serbinë dhe Kosovën. Tanimë është bërë e qartë se ne e kemi tejkaluar nocionin "ne" dhe "ju" dhe gjithnjë e më shumë kërkojmë për hapësira që lejojnë takime politike, në mënyrë që t'i transformojmë ato në veprime. Në një anë, ballafaqohen tregimet tona personale, përderisa në anën tjetër ne mbahemi për duar dhe bëhet e padallueshme se kush është kush në rrugë, sepse ne kemi një cak të përbashkët politik! Ky është koalicioni jonë!

Ju faleminderit për të gjitha përqafimet e ngrohta që na i dhatë, për organizimin e jashtëzakonshëm të konferencës dhe për një aheng të shkëlqyeshëm!

Motrat e juaja në paqe,

Aktivistet e Rrjetit të Grave në të Zeza në Serbi / aktivistet e Koalicionit për Paqe

Prishtinë, 19 tetor 2007

Letër për aktivistet serbe pas konferencës së dytë vjetore të Koalicionit të Grave për Paqe në Strugë, Maqedoni

Të dashura Mikesha nga Rrjeti i Grave në të Zeza - Serbi,

Në takimin tonë në Strugë, përsëri kemi demonstruar se solidariteti dhe dashuria e grave shtrihen përtej kufijve gjeografikë, fetarë apo etnikë. Siç treguan diskutimet tona, ndonëse jetojmë në rrethe të ndryshme, ne ndjehemi ngjashëm për çështjet me të cilat përballemi. Ne ngrihemi për njerëzit që kanë nevojë. Ne ngrehim zërat tonë dhe bërtasim në padrejtësi. Ne luftojmë vetëm që të na dëgjohen zërat tonë.

Koha që e kemi kaluar së bashku na ka ndihmuar që të kuptojmë më mirë realitetin e të tjerëve, rëndësinë e përkrahjes së njëra-tjetrës dhe rrugën tonë si koalicion. Ne presim me padurim që të ecim para me aktivitetet e planifikuara gjatë konferencës në Strugë. Ne kemi besim se iniciativat e identifikuara përmes konferencës do të na ndihmojnë që të vazhdojmë përkrahjen e qytetarëve në kalimin e kufijve, shtrirjen përtej ndarjeve etnike dhe fetare. Përmes këtyre iniciativave ne do të vazhdojmë me përpjekjet e koalicionit për të ndërtuar një të ardhme vërtetë të drejtë dhe paqësore për Kosovën, Serbinë dhe rajonin.

Ne dëshirojmë të ndajmë me ju se koha që kemi kaluar së bashku ka qenë një inspirim. Konferenca ka ripërtërirë energjinë tonë dhe ka ofruar motivim shtesë për të vazhduar me përpjekjet tona drejtë paqes dhe drejtësisë.

Rruga jonë para nuk do të jetë e lehtë. Ne do të përballemi me shumë pengesa. Ne jemi të rrethuar me urrejtje dhe injorancë. Por ato nuk do të na ndërpresin rrugën, sepse ne jemi aktiviste femra. Ne besojmë në aktivizmin tonë. Ne besojmë në paqe. Ne besojmë në drejtësi. Dhe më së rëndësishmi, ne besojmë në njëra-tjetrën dhe në të ardhmen të cilën mund ta ndërtojmë së bashku.

Në paqe dhe dashuri,

Anëtarët e RrGG-së

Lexim tjetër mbi çështjet që kanë të bëjnë me konferencën

Etika Feministe e Përgjegjësisë

Nga Milka Rosiq

Gratë për paqe – Leskovc

Gjatë ndarjes së Jugosllavisë, frika më kishte kapluar. Ndjehesha e paralizuar dhe nuk mund të bëja asgjë. Mendova se asgjë nuk varej nga unë dhe të tjerët kishin të drejtë që të vendosnin në emrin tim mbi të ardhmen time. Nuk isha e vetëdijshme për faktin që secila nga ne si individë mund të ndërmarrim veprime tona të rebelimit. Njerëzit përreth meje ishin fjetur. Nuk kishte as një rreze të vetme shprese që kjo marri disi të ndërpritej. Unë mendova se asgjë nuk varej nga unë, por unë isha e mashtruar. Kur unë u takova me Gratë në të Zeza, unë mësova se kishte gra dhe burra anëmbanë vendit të cilët, në mënyra të ndryshme, gjykonin në favor të ndaljes së luftës e cila mernte më shumë jeta dita ditës. Vetëm atëherë e kuptova se frika ime mund të shprehej ndryshe, përmes rebelimit jo të dhunshëm, përmes deklarimit të qartë se unë nuk dua që askush të vritet në emrin tim. Unë ika nga një rreth i mbrapshtë. Me gratë tjera, vendosa që të filloj t'i kujtoj ngjarjet e të kaluarës sonë të fundit, duke i thirrur ata me emrat e vërtetë, dhe duke i dënuar ata në gjykata ashtu që të mos ndodhin më. Përmes punëtorive dhe aktivizmit rrugor me miket e mia nga Rrjeti i Grave në të Zeza - Serbi, mësova shumë gjëra për të cilat nuk isha e vetëdijshme. Kjo shkaktoi ndjenja zemërimi, turpi, tërbimi dhe fajit te unë, si anëtare e një kombi që shkaktoi kaq shumë gjëra të këqija. Çdo herë që takoja femra që kanë vuajtur tmerre për shkak të politikave të gabuara të regjimit të kaluar, unë ndjehesha fajtoreshë dhe e zhgënjyer me veten sepse në kohën e këtyre ngjarjeve, unë qëndroja në shtëpi me familjen time dhe shikoja gënjeshtër në televizion që helmonin mendjet tona. Tani, e di se unë duhet të shndërroj ato ndjenja të sapozbuluara në veprime. Përmes veprimeve të rezistencës dhe mosbindjes civile, unë vazhdimisht paralajmëroj njerëzit përreth meje dhe ata në qeveri që kurrë më të mos fillojnë rrugën e politikave të gabuara.

Për mua, rruga për në Srebrenicë me Gratë në të Zeza do të thotë tregim i solidaritetit dhe ofrim i përkrahjes për familjet e viktimave përmes solidaritetit politik dhe ndërtimit të besimit ju ndjeheni të turpëruar për shkak të krimeve të shkaktuara nga kombi juaj. Megjithatë, ju mburreni kur të shihni sinqeritet në sytë e tyre. Ata besojnë në atë që bëni dhe thoni, "Pirolla ju qoftë! Ju jeni gratë më të mira në botë." Përderisa ne qëndronim në Potocari dhe tregonim respekt, unë u ndjeva e tërbuar përsëri, duke kujtuar ditën e mëparshme, komentet, ofendimet dhe kërcënimet në Beograd. Për dallim, kur ishim në Srebrenicë, njerëzit na afroreshin me ngrohtësi dhe na falënderonin për ardhje. Gjatë qëndrimit tonë, pikëllimi, tërbimi dhe acarimi në mua u zëvendësua me këngën e djemve, fjalim-

in e hoxhës dhe tregimin e gruas. Kjo është një vepër tjetër e konfrontimit me të kaluarën e fundit që është kryer në emrin tim. Ne krijojmë njohuri më të thellë me problemet e ballafaqimit me të kaluarën dhe drejtësinë tranzicionale duke treguar dëshmi të filmuara dhe filma të metrazhit të gjatë. Bashkëqytetarët tonë kanë rastin të punojnë me ndryshimin e vetëdijes dhe të zgjojnë përgjegjësinë qytetare në mënyrë që të ketë më shumë femra të forta, të gatshme për të ndryshuar vlerat tradicionale dhe të caktuara që ndikojnë të ardhmen tonë në shërbim të sistemit patriarkal.

Përcjellja e gjykimeve të krimeve të luftës: Ndëshkimi i krimeve – Rruga për në paqe të drejtë

Nga Gordana Stojiljloviq
Gratë për Paqe – Leskovc

Karakteri i agresionit kundër Bosnje dhe Hercegovinës nuk është shprehur asnjëherë aq qartë sikurse në Srebrenicë, lokacionin e gjenocidit perfid, brutal dhe më të madh. Asnjë vend nuk është më publik se ai, ku, përkundër pranisë së ushtarëve të OKB-së, u masakruan boshnjakët. Në fillim të agresionit kundër Bosnjës, shumë boshnjakë refugjatë nga Vlasnica, Bratunac, Zvornik, Rogatica dhe Vishegrad u mblodhën aty. Duke i ikur thikave të çetnikëve ata u munduan të gjenin siguri në Srebrenicë, duke mos dyshuar se ajo do të ndodhte pas shpalljes së saj si zonë e sigurt e OKB-së. Një vrasje e tmerrshme gjenocidi ndodhi. Fashistët serbë dëbuan, arrestuan apo masakruan banorët e Srebrenicës dhe mijëra boshnjakë refugjatë nga zona e afërt e Drinit. Mbetën vetëm dëshmitarët dhe varrezat masive. Fatkeqësisht, nuk janë zbuluar të gjitha varrezat masive. Të mbijetuarit thirrin më kot për mijëra e mijëra të zhdukur, fëmijë, prindër, vëllezër, burra dhe të afërm të tjerë. Është e palejueshme që të mohohet e vërteta e gjenocidit të tmerrshëm kundër boshnjakëve në atë zonë apo edhe ringjallja e saj. Masakra është kryer nga fashistët serbë. Kudo në okupimin e Serbrenicës, forma të veçanta të luftës dhe të shkatërrimit gjenocid, siç është ndalimi i ujit dhe bllokimi dhe ndalimi i dërgesës së ndihmave humanitare, barërave, rrymës dhe gjërave tjera të domosdoshme biologjike, janë drejtuar kundër popullatës së izoluar boshnjake. E tërë kjo ka ndodhur në komandë të Ratko Mladicit, Arkanit, Shesheljit dhe udhëheqësve politikë dhe qeveritarë të Serbisë me bekimin e Kishës Ortodokse Serbe. Sot, madje pas presionit të hatashëm të publikut ndërkombëtar dhe themelimit të Tribunalit të Hagës dhe Gjykatave vendore për Krime Luftë, kriminelët akoma ecin lirshëm mes nesh; ne të cilët punojmë për ndëshkimin e krimeve quhemi tradhtarë. Gjykata speciale për krime luftë në Beograd është institucioni i vetëm që trajton krimet e luftës dhe tenton t'i gjykojë kriminelët në mënyrë objektive. Gratë në të Zeza kanë marrë pjesë në shumë seanca gjyqësore të pjesëtarëve të njësisë paramilitare Shkorpionët të akuzuar për vrasjen e civilëve boshnjakë gjatë gjenocidit të Srebrenicës në korrik të vitit 1995. Shumë gra nga të gjitha pjesët e Serbisë të cilat besojnë se mënyra e vetme për të ringjallë vendin tonë është përballja me të kaluarën e kanë përcjellë këtë gjykim. Unë isha njëra nga to. Së fundi, ne përcollëm edhe gjykimin për krime të kryera nga stafi i Ministrisë së Punëve të Brendshme kundër civilëve shqiptarë të Kosovës në mars të vitit 1999 në Suharekë. Veç kësaj, kontakti me familjet e viktimave, përkrahja dhe solidariteti me to, është një pjesë shumë e rëndësishme e këtyre aktiviteteve. Falja politike, kërkimi i faljes për krimet e kryera në emrin tonë, është grup i veprimeve që pranojnë krimet e kryera në emrin tonë dhe kërkon drejtësi dhe ndëshkim për kriminelët. Në gjykime, ne kishim mundësinë për të dëgjuar dëshmitë e publikut mbi krimet dhe vuajtjet e viktimave. Në gjykime, mund të shihet qartë se policia, ushtria dhe institucionet shtetërore të Serbisë ishin prapa krimeve.

Shokët e mi të ri folën mbi atë që ndodhi në Godinjska Bara, në shtëpizat në fshat, ku civilët iknin nga Srebrenica në drejtim të maleve. Atje, burra dhe djem janë kapur nga Shkorpionët dhe janë vrarë në mënyrë mizore dy herë. Ata u vranë me armë zjarri. Pastaj, trupat e tyre janë dërguar në një vilë dhe janë vrarë për herë të dytë; pastaj trupat janë djegur. Kryerësit e veprave vepruan ashtu si u urdhëruan nga komandanti i tyre. "Pakot u likuiduan." Në mesin e viktimave ishin tre djem, përfshirë 17 vjeçin Sajo, birin e Hana Fejzic, dhe 13 vjeçin Alvedin, vëllai i Safeta Muhic, e cila tani është amvise dhe nënë e dy fëmijëve. Në gjykim, Safeta e përshkroi takimin e saj të fundit me vëllanë e saj, përqaftimin e tij të fundit. Vëllai i saj i vogël tha, "Motër, unë nuk mund të ju udhëheq rrugën, e as nuk mund të qëndroj me ju." Ai shkoi me babën e tij. Safeta, nëna e saj dhe gjyshja u nisën për në Potocari për të kërkuar siguri me OKB-në. Atje, çetnikët shpeshherë shkonin në fabrika, duke çuar meshkuj dhe duke i ndarë femrat e bukura. Ata e ndanë shoqen time Safetën, ndonëse ajo ishte vetëm 13 vjeçe. Nëna e saj i luste ata që ta lëshonin te familja e saj. Më në fund, një nga çetnikët e liroi Safetën. Asaj i kujtohet, "Është vështirë të flitet për atë. Rrugës për në Potocari, ne me mundime ecëm mbi të vdekurit, të rraskapiturit dhe moshuarit. Neve na u zu fryma nga rënkimi, britmat dhe vajtimet e mijëra vetëve. Të gjithë ishin vrarë. Aeroplanët fluturuan mbi Potocari dhe e gjuajtën me artileri në drejtimin tonë." Tragjedia e saj nuk përfundoi. Dëshira e saj për ta gjetur vendndodhjen e vëllait të saj është e madhe. Ajo është dëshira njerëzore; do të ishte e rëndësishme për mua. Herën e parë që dëgjoji diçka për të ishte në vitin 2003. E vërteta për të u bë e njohur gjatë një gjykimi në Hagë, pasi u tregua një xhirim videokasete. Edhe pas tetë vitesh të zbrazëtirës dhe heshtjes, shpresa e saj akoma është e gjallë. Ajo ishte shumë e re, por iu është dashur që t'i identifikojë dhe konfirmojë vetes dhe të tjerëve se kurrë më nuk do ta shihte fytyrën e vëllait të saj. Ishte ndarja e tyre e fundit. E kuptoj dhimbjen e saj dhe e kam keqardhje për të. Unë u mundova ta ndihmoj përmes aktivizmit tim, duke nxitur shtetin nga i cili vij që të përballet me gjërat e këqija që i ka shkaktuar në emrin e tërë kombit. Në gjykim, Safeta u kthye dhe pyeti, "A janë ata qenie njerëzore? Çka janë ata?" Fytyra e saj ishte përplot dhimbje; zëri i saj i lënduar dridhej i tëri derisa përjetonte traumën edhe një herë. Gjatë kafesë në pasdite, unë e pashë në të një person të fuqishëm dhe të pjekur. Këto ngjarje përfunduan fëmijërinë e saj dhe e detyruan atë që të rritet pa fëmijëri të lumtur.

Nura Alispahic jetoi në Srebrenicë para luftës. Ajo kishte dy djem. Njëri nga ta, Admiri, u vra nga një predhë në portë. Ajo e dërgoi birin tjetër, i cili ishte 16 vjeç, te të afërmit në male për shkak se dëgjoji se çetnikët ishin duke i grabitur të gjithë burrat dhe djemtë mbi moshën shtatë vjeçe. Herën e fundit që e pa ajo ishte në kasetën e treguar në Tribunalin e Hagës, të cilin e transmetoi B92. Ai

zbret nga një kamion me duar të lidhura prapa shpinës. Nura thotë, “Do të doja ta dija se kush e vrau birin tim me duar të lidhura prapa shpinës së tij.”

Në këtë tregim, unë dëshiroja të ndjell për ju një pjesë të vogël të së vërtetës, ngjashëm me mijëra të tregimeve tjera. Unë e pyes veten mbi mijëra të ngjashëm të cilët po ashtu janë pa një apo dy prindër dhe pa ngrohtësinë e shtëpisë së tyre dhe të gjirit të nënës. Fëmijëritë e tyre dhe e drejta e tyre për jetë është marrë nga ta.

E vërteta dhe drejtësia janë tragjedi sot. Drejtësia nënkupton respektimin e interesave të viktimave, familjeve të tyre, dhe mirëqenien e shoqërisë si tërësi. Ne duhet që vazhdimisht të punojmë në zgjerimin e vetëdijes politike mbi nevojën e zëvendësimit të të vërtetave zyrtare. Çdo krim duhet të ndëshkohet sepse ajo është rruga e vetme për një paqe të drejtë.

Përballja jonë me të kaluarën është vizitimi i lokacioneve të krimeve, bashkëdhimbja për viktimat e luftës dhe ndërtimi i marrëdhënieve paqësore në mesin e grave. Për ne, përballja me të kaluarën nënkupton mekanizma të drejtësisë tranzicionale në luftë dhe paqe. Ne e bëjmë këtë vazhdimisht në aktivitetet tona. Ne e bëjmë këtë duke vizituar lokacionet e krimeve, duke marrë pjesë në përkuajtje dhe duke krijuar platforma për paqe në Bosnje, Kroaci dhe në Kosovë.

Nga krimi i organizuar deri të gënjeshtra e organizuar Për gjykimin "Lënda: Suhareka"

Nga Millosh Urosheviq

1987/8/9/1990/1. – 1998. - Aparthaejt: gjykimet politike të montuara, ndërimi i udhëheqësisë së krahinës, "kidnapimi" gjuhësor, heqja e Autonomisë Kosovës, mbyllja e shkollave dhe Universitetit në gjuhën shqipe, largimi i punëtorëve të arsimit dhe të shëndetësisë, njësitë policore dhe ushtarake brutalisht shkatërronë të gjitha demonstratat- qindra të vdekur, masakra e Malishevës, vrasjet në Klinë dhe Podujevë, vrasjet e minatorëve në Stari Trg në Trepçë.

1998 – Masakrat ndaj civilëve shqiptar në Drenicë (Prekaz i Poshtëm, Likoshan, Obri e Epërme, Llaushë, Qirez, Rogovë)

1998 – 1999 – Luftë ose konflikt i armatosur i UJ-së (Ushtrisë Jugosllave)/NSP-së (Njësitë Speciale Policore) dhe UÇK-së (Ushtria Çlirimtare e Kosovës)

1999 – Masakrat ndaj civilëve shqiptar në tërë Kosovën (Reçak, Podujevë, Suharekë, Dubravë, Mejë, Krushë e madhe dhe e Vogël, Celine, Fshati i Thatë, Studime e Epërme dhe e Poshtme), depëtimet masive të popullatës shqiptare (960.000, përsëri organizim shtetëror për pastrimin etnik, vrasja e shqiptarëve eminent (Fehmi Agani, Bajram Kelmendi).

1999 – 2001 - Gjykimet e montuara ndaj liderëve të shquar dhe lidereve të shquara të popullit shqiptar të Kosovës pranë gjykatave në Serbi (Albin Kurti, Flora Brovina, Grupi i Gjakovës, vëllezërit Mazreku, studentët shqiptar)

2 - 5 tetor 2006 -Sot para trupit gjykues të gjykatës së qarkut në Beograd filloj gjykimi për krimin në Suharekë. Ditën e parë të shqyrtimit, është lexuar aktakuza dhe të akuzuarit janë deklaruar për aktakuzën (fajësinë-pafajësinë). Gjykimin e përcjellin aktivistet e Rrjetit Gratë në të zeza. Ne aktivistet e Rrjetit Gratë në të Zeza e përcjellim këtë gjykim para së gjithash që të jemi me familjaret e viktimave. Ky është një akt i respektimit të dinjitetit të viktimave, solidarizim me familjarët dhe akt i pranimit të krimit të kryer në emrin tonë. Me këtë ne përipiqemi të bashkëndejmë /ndajmë dhembjen e tyre për humbjen e më të dashurve. Me familjaret bashkëbisedojmë, këmbëjmë informata, bashkarishtë pimë kafe dhe buzëqeshim.

Dhuna: Etapat: Shteti i krimit të organizator

Me datën 26. mars 1999 në picerinë Kalabria dhe në rrugën e Reshtnit, pjesëtarët e MPB të Republikës së Serbisë: Radosllav Mitroviq-kolonel dhe ndihmës komandant i xhandarmerisë, Radojko Repanoviç - ndihmës komandant i stacionit, Nenad Jovanoviç- polic i kriminalistikës, Sllagjan Çukariq - polic, Millorad Nisheviq - pjesëtare i Sigurimit Shtetëror, Miroslav Petkoviç -rezervistë, Zoran

Petkoviq- rezervistë, Ramiz Papiq- policë nga Sjenica, i privuan nga jeta gjithsej 48 persona dhe nga ta 46 persona anëtar të familjes Berisha, nga të cilët kanë mbijetuar Shygrete Berisha, Vjollca Berisha dhe Gramos Berisha. Trupat e tyre janë varrosur në një varr masiv në Kosovë, në poligonin e gjuajtjes ushtarake në Prizren, dhe mbas një jave me urdhër të të akuzuarit nga ana e Tribunalit të Hagës gjeneralit Vllastimir Gjorgjeviq, janë transportuar në Serbi dhe janë varrosur në Batajnicë, prej nga janë riatdhesuar dhe kthyer familjeve në Kosovë.

I akuzuari i parë Radosav Mitroviq në territorin e komunës së Suharekës ka pasur përgjegjësin komanduese, dhe mu për këtë është përgjegjës, sepse sipas aktakuzës vartësve të tij pjesëtarëve të MPB të Serbisë iu ka urdhëruar: „ Nisuni, çfarë pritni, vrisni, transportoni a duhet që unë ta bëjë këtë në vend të juaj.“ Nga qëndrimi i tij përfundohet se është fjala për “bulon” (Hana Arent) profesional, me vite i trajnuar në tërësinë e makinerisë vrasëse të MPB-së së Serbisë. Ai për merita kriminale është nderuara me medalje ‘flamuri jugosllav me yll’. Me titull komandanti i tretë i xhandarmërisë, i dëgjueshëm, ekzekutues. Këtë krim si shumë të tjerë i ka organizuar, udhëhequr dhe zbatuar shteti. Pikë së pari shteti është ai i cili duhet të iu kërkojë falje familjeve të viktimave. (2,3,4. dhe 5. tetor 2006).

Dëshmitari polici Vellibor Velkoviq, i cili ka dëshmuar për tërë krimin., thotë se:- “më 24 mars ka ndodhur krim lufte dhe për këtë sot unë jam këtu.“ Ai ka dëshmuar se ka refuzuar të shkojë në detyrë për të vrarë Shqiptarë, sepse ka llogaritur se kjo është vepër penale dhe nuk ka asnjë kusht të plotësuar nga rregullat zyrtare që policia të përdor armët. Kjo është dëshmi se krimin e ka organizuar dhe udhëhequr, asgjë nuk ka ndodhur rastësisht, shihet qartë se ka ekzistuar qëllimi. Për të akuzuarit ka thënë: “Ata saktë e dinë se çfarë kanë bërë.” (7-9 tetor 2006).

Dëshmitari N.N. ka dëshmuar: “Ka ekzistuar njësi e veçantë e policisë në Suharekë, njësinë e ka udhëhequr Vellko Radenoviq (Velko Radenoviq). Në ndihmë iu kanë ardhur njerëz nga Krushevcit të quajtur Çegrovi. Komandant i njësisë së veçantë të policisë ka qenë Radosav Mitroviq (Mitroviq Radosav) “Çegar1”. „Kjo është një ndër dëshmitë se tërë aksioni për pastrim etnik të popullsisë shqiptare në Kosovë ka qenë e organizuar nga ana e shtetit. (10 - 12 janar 2007).

Dëshmitari N.N. ka treguar se ka pasur shumë ushtarë: UÇK-ja e armatosur, Serbët civil të armatosur, përbërja rezervë e policisë, njësit e rregullta policore, policia speciale, njësit e veçanta policore, ushtria e rregullt (mendohet në ushtrinë jugosllave v.p.). Dëshmitari N.N. për situatën në Kosovë ka thënë se ishte “gjendje e jashtëzakonshme normale“ (1-5 shkurt 2007).

Në qendrën zeytare ishte masakër!“ – ka thënë dëshmitari Trajko Trajkoviq (Trajkoviq Trajk)- rom, i cili atëherë kishte 16 vjeç. (4, 5, 6, 7.dhe 8. qershor 2007.) “Nuk më kujtohet a kishte të shtëna, nuk më kujtohet a kishte shpërngulje njerëzish, nuk më kujtohet plaçkitja, vërtet asgjë nuk më kujtohet dhe nuk e kam idenë, nuk më kujtohet se kur jam bërë anëtar i PJP (njësit e veçanta të policisë v.p.)” Dëshminë e tij ky dëshmitarë e ka përfunduar me fjalinë: “Pothuajse të gjithë serbët ishin rezervist”. Duke filluar nga viti 1989 në Kosovë ka ekzistuar vetëm policia serbe dhe terror shumë i madhe ndaj popullsisë shqiptare. Policia ishte kujdestare besnike e aparthejdit. Të gjithë serbët në Kosovë kanë qenë polic. (2-5 qershor2007).

Lufta kundër civilëve

Prokurori Miolub Vitoroviq e ka pyetur të akuzuarin Mitrovic, se a ka thënë ai: “Nëse do të ketë bombardime nuk do të ketë serb por për sigurt nuk do të ketë as shqiptar”, që ka nxitë reagim të avokatit mbrojtës.

I akuzuari i dytë Radojko Repanoviq ka qenë komandant i stacionit në Suhreki (stacioni policor v.p.). Ai ka pohuar se një territor të madh e ka kontrolluar organizata separatiste terroriste UÇK. Vështirë që të miturit e familjes Berisha: Genc, Granit, Dafina, Drilon, Vlorjan, Edon, Doruntina, Majlinda, Herolinda, Altini, Redon, Ismet, Eron, Kushtrim, Arta, Zana, Merita, Hanumsha, Mirat ishin anëtar/e të UÇK-së. Këta ishin vetëm fëmijë të cilët për shkak të emrave në një moment historik janë gjendur në vorbullën e pastrimit etnik. (2-5 tetor 2006).

Dëshmitari Velibor Velkoviq, “jo lojal ndaj të vetëve”, decidivisht ka thënë se shqiptarët nuk kanë shtënë në ta dhe se viktimat kanë qenë të pauniformuar (civil v.p.). Të gjitha kufomat kanë qenë civil, askush nuk ka qenë i uniformuar. E autorizuar e të dëmtuarve Natasha Kandiç e ka pyetur njërin nga dëshmitarët: “A keni dëgjuar për viktimat masive në Krushë të Vogël dhe të Madhe, Pastasellë, Celinë, këto kanë qenë vrasje të cilat kanë ndodhur në territorin e komunës së Prizrenit”? Në këte avokati mbrojtës Veljko Gjurgjiq reagon: “Nëse shtröjmë pyetje për tërë territorin e Kosovës atëherë ne do mbesim për pesë vjet këtu”. (7-9 nëntor 2006).

Civilët nuk ishin të marrë/çmendur që të shkojnë në stacione policore kur ata ikin nga policia. Të plagosurve nuk iu kam ndihmuar sepse jam frikësuar. Policia i ka mbrojtur serbët e unë të ndihmojë Shiptarima (shqiptarët v.p.), këtë nuk kam guxuar ta bëjë. Dëshmitari i mbrojtur A deklaroi se policët janë sjellë si kaubojt, ne ishim si buburreca, askush dhe asgjë nuk ka guxuar të iu thotë asgjë (dhjetor 2006).

Dëshmitari A disa herë e përsërit se në fotografi ka shumë fëmijë dhe gra. Kjo është njëra ndër dëshmitë se policia serbe në Kosovë nuk ka luftuar kundër Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës por kjo ishte luftë kundër popullsisë civile. Nga kjo nxirret përfundimi se të gjithë fëmijët e vranë janë terrorist çka është

absurde. (10-12 janar 2007).

Dëshmitari A thotë se policia ka pasur urdhër që të hapë zjarr në pjesëtarët e UÇK, por gjithashtu shton se asnjë fishek nuk është ndezur. Kjo flet për faktin se policia serbe në Kosovë nuk ka luftuar kundër pjesëtarëve të armatosur të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës por ka udhëhequr luftë kundër civilëve. (1-5 shkurt 2007).

Në Suharekë nuk ishte UÇK-ja, çka dëshmon se ushtria dhe policia serbe nuk kanë luftuar kundër UÇK-së por ishin civilët e pafajshëm. (2-5 prill 2007).

Viktimat janë shndërruar në xhelat e xhelatët në viktima. (15-17 maj 2007).

“Detyra e jonë ishte shkatërrimi i grupeve terroriste”. Në fakt makineria terrorizmit shtetëror në mënyrë të vazhdueshme e ka terrorizuar popullsinë shqiptare. (2-5 korrik 2007).

Koordinimi i aksioneve për pastrim etnik

I akuzuari Radosav Mitroviq lavdërohet që ka merita për shpartallimin e demonstratave të viteve të tetëdhjeta në Kosovë, si dhe të atyre të nëntëdhjetave në Serbi. Thotë se si paraardhësit e tij çdo herë kur ka qenë e nevojshme kanë dhënë gjakun për këtë vend. Në Kosovë në vazhdimësi ka qenë që nga shkurti i vitit 1998 deri më 14 qershor 1999. Ishim dëshmitarë të pastrimit etnik ditorë si krim i organizuar shtetëror. Sot (3.10) i akuzuari i parë e vazhdon dëshminë e tij: „ Unë me njerëzit e mi kam bërë pastrimin e terrenit“. Në territorin e Prizrenit – Rahovecit – Suharekës është bërë pastrimi etnik i popullsisë shqiptare. “Forcat e mia e kanë shtënë në dorë terrenin, e kanë pushtuar. Unë jam avancuar në kolonel, unë nuk kam qenë nën komandë ushtarake, unë jam përgjigjur për tri çeta. Të gjitha urdhrat janë drejtuar nga Prishtina”. I akuzuari në vazhdimësi e përsërit se ata vetëm kanë bërë pastrimin e terrenit nga „terroristët shqiptarë“ („šiptarskih terorista“), dhe se përsëri e relativizon termin pastrim etnik të popullsisë shqiptare. (2-5 tetor 2006)

Të gjithë ata njerëz të cilët në atë moment historik kanë pasur një emër të caktuar kanë qenë shënjestër e pastrimit etnik dhe vrasjeve të organizuara. Njëra nga dëshmitë, dëshmon se pastrimi etnik ka qenë i organizuar nga ana e shtetit dhe ka pasur për qëllim territorin e pastër etnik pa njerëz me emër të caktuar. Dëshmitari Vellibor Velkoviç ka përmendur grupe të ndryshme gjithashtu: e para ka shkuar “grupi për vrasje”, pastaj “grupi për grumbullimin e kufomave” dhe në fund grupi për pastrim. (7- 9 nëntor 2006)

Kur avokatet e mbrojtjes pyesin: “A ka punuar policia sipas detyrave?”, dëshmitarët dhe të akuzuarit përgjigjen pozitivisht (pohojnë). Dhe nuk shtrohet pyetja se “Çfarë do thotë të veprohet sipas ligjit në polici gjatë kohës së gjendjes së

luftës?”. Kjo nënkupton se është e lejuar, madje e dëshirueshme të vriten „armiqtë“, civilët shqiptarë, duke mos pritur drejtësinë. Me pastrimin etnik është krijuar territori i pastër etnik pa njerëz, pa gjuhë. Askush nga ta nuk ka shprehur (besuar v.p.) se për krimet e tyre do të përgjigjet. I pyetur se “A ka vepruar policia sipas ligjit?”, njëri nga dëshmitarët e ka pohuar. Askush nuk e ka thënë se ai ligj ka kërkuar të vriten sa më shumë shqiptar dhe të krijohet territor sa me i madh i pastër etnik. (15-17 maj 2007)

„Djali i im Zoran-i ka ngarë autobus te shqiptari, për shqiptarët, atje vetëm shqiptarët kishin agjenci. “Dëshmitarja me këmbëngulje në gjykatore e ka përdorur emërtimin ‘shiptar’, i cili emërtim është fyes për Shqiptarët, madje pa kurrfarë frike që do të ketë pasoja për fjalët e saja, fjalor i urrejtjes, fjalor i cili i ka hapur rrugën pastrimit etnik të popullsisë shqiptare në Kosovë. Askush nuk ka reaguuar, duke filluar nga trupi gjykues.

Pyes vetëm se çfarë do thotë të jesh i dëgjueshëm në polici? Kjo do thotë pa asnjë fjalë të kryhen të ashtuquajturat detyrat e veçanta, të cilat në të vërtet kanë qenë vrasje, pastrim etnik, dhunime. (2-5 korrik 2007)

Komploti i heshtjes/krimi i heshtjes/barra, trashëgimia e heshtjes ose gënjeshtërta shtetërore e organizuar

I akuzuari Radosav Mitroviq ka thënë se nuk i ka kushtuar vëmendje se a kanë qenë të djegura shtëpitë për rreth stacionit policor, gjithashtu nuk i ka kushtuar vëmendje kolonave të refugjatëve shqiptarë që e kanë lëshuar Kosovën, kjo ishte punë e policisë rrugore. Pastrimi etnik ka qenë në duar të policisë dhe ai si komandant nuk i ka kushtuar vëmendje. Ai e ka potencuar se ka pasur përgjegjësin komanduese, ka komanduar vetëm njerëzve të tij. “ Nëse luftojmë, luftojmë të gjithë, kemi shpirt kolektive. Unë kam qenë epror trim dhe çdo herë kam shkuar sipas GRADAVE“ Ai ka kryer punë profesionale. (2-5 tetor 2006)

Kryetarja e trupit gjykues duke menduar në vrasjen e civilëve shqiptar, ka pyetur: “A e ka kundërshtuar ndokush një gjë të tillë?”, në të cilën pyetje dëshmitari A është përgjigjur: „Kush ka guxuar të iu kundërvihet?“ (dhjetor 2006)

Gjatë dëshmisë së një dëshmitari, në dëshminë e tij se policia u ka ofruar mbrojtje popullsisë shqiptare, prokurori Vitoreviq e pyet: “Si pra atë ditë kur janë vrarë 48 persona nuk kishte kurrfarë mbrojtje të policisë?” Dëshmitari N.N. në pyetjen e të autorizuarës së të dëmtuarave Natasha Kandiq: “A ka marre të holla policia nga Jashar Berisha“, thotë se „policët tanë nuk kanë marrë të holla.“ Ky është mohim i faktit të njohur që gjatë pastrimit etnik policia ka marrë të holla nga njerëzit për shpëtim të jetëve të tyre gjatë pastrimit etnik. Fjalë për fjalë janë mohuar faktet e njohura botërisht, fshehja e përgjegjësisë komanduese, mohim i çdo lloj përgjegjësie. Dëshmitari N.N. vazhdon praktikën e dëshmitarëve paraprak të cilët janë përpjekur të fshehin të kombinuar mirë politikën kriminale dhe të fshehin (mbulojnë) përgjegjësinë e gjeneralit Obrad Stevanoviq. (1-5 shkurt 2007)

Dëshmitari N.N. vazhdon praktikën e mohimit të çfarëdo njohurie mbi vrasjen e familjes Berisha. Si shumica e të gjithë dëshmitarëve paraparak është përpjekur të mbroj shtetin dhe përfaqësuesit e tij nga akuzat. Romet e pambrojtur nuk janë frikuar që publikisht të thonë qartë atë çfarë dinë. Të vetmit të cilët thanë se kanë pasur shumë vështirë, të vetmit të cilët janë sjellë si njerëz dhe që ishin njerëz. (2-5 prill 2007)

I akuzuari Radosav Mitroviq lavdëron profesionalizmin dhe ndershmërinë e eprrorëve të tij gjeneralëve Obrad Stevanoviç dhe Sreten Llukiq. I akuzuari Radosav Mitroviq është deklaruar i pafajshëm për krime luftime ndaj popullsisë civile dhe njoftojtë të dhënat për përgatitjen e tij profesionale. “Në Suharekë policia e rregullt ka kryer punën e saj. Popullsia shqiptare është shpërngulur nën presionin e organizatës terroriste UÇK.” Krejt kjo prezanton falsifikim, racionalizim, me një fjalë mohim i krimit. I akuzuari Radosav Mitroviq thotë se për njerëzit e tij detyrë ka qenë “mbrojtja e atdheut të tyre, mbrojtja e vendit”. Dhe ka shtuar: „Unë jam komandant me përgatitje të lartë profesionale.” (2-5 tetor 2006)

Dëshmitari N.N. këmbëngul se shkaktar i zhvendosjes së popullsisë janë lufta dhe bombat e NATO-s. (7-9 nëntor 2006)

Dëshmitari N.N. e mohon përzjerjen (pjesëmarrjen) e Serbisë në organizimin e aksionit të pastrimit etnik. Në pyetjen e trupit gjykues, a ka pasur djegie të shtëpive të shqiptarëve, dëshmitari thotë: “Ata vetë i kanë kallur shtëpitë e tyre dhe kanë ikur.” Kjo është dëshmi e organizimit shtetëror të gënjeshtërs. (1-5 shkurt 2007)

Të gjithë dëshmitarët në vazhdim janë përpjekur të fshehin faktet, kanë dëshiruar të mbrojnë së pari veten e tyre, pastaj eprrorët e tyre e në fund Serbinë. Mohimi i ekzistimit të krimit, gjegjësisht njohurin për krimin ata dëshirojnë të fshehin përgjegjësinë e Serbisë si shtet i cili i ka organizuar krimet. (5-9 mars 2007)

Vrasja e shqiptarëve të Kosovës paraqitet si gjë normale dhe për ta nuk është biseduar, sikurse kurrë nuk kanë ndodhur, apo kanë ndodhur por kanë qenë të justifikuar (arsyetuara) me të ashtuquajturën luftën kundër terrorizmit. Dëshmitarët kanë zgjedhur harresën si zgjedhje e tyre politike. Heshtje për krimin e organizuar shtetëror. Kanë zgjedhur për të mos ditur asgjë, asgjë të mos iu kujtohet, që asgjë mos të thonë. Dëshirojnë të mbrojnë vehten e tyre, eprrorët e tyre dhe shtetin. Të gjithë ata nuk kanë asnjë lloj empatie ndaj viktimave, viktimat shqiptare nuk ekzistojnë në hartografinë e krimeve. Të gjithë këtyre dëshmitarëve iu shtrohet si normativë që të mos dinë asgjë se çfarë ka ndodhur me shqiptarët. Kanë zgjedhur heshtjen (injorimin). Kanë zgjedhur për të mos ditur, janë përcaktuar për atë se asgjë nuk iu kujtohet. Dëshmitari N.N. përpiqet të

fshehtë faktin në mes të kësaj ka qenë pastrimi etnik i organizuar. Më së miri për shtetin është që të zbulohen sa më pak dëshmi të cilat flasin për krimet e shtetit. (15-17 maj 2007)

Ky dëshmitar ish-kryetar i Komunës së Suharekës është gënjeshtar profesional, ai saktësisht dinë se çfarë duhet thënë, dinë bindshëm të gënjej, dhe i bindur se asnjëherë nuk do të ketë kurrfarë pasojash për gënjeshtret e tij. Ky dëshmitar si zyrtar shtetëror i regjimit kriminal, zbatues i ligjit i cili gënjen zëshëm. Dëshmitari është shembull i atij Gjermanit i cili ka punuar në fusha afër kampit të Aushficit dhe mbas luftime ka deklaruar se nuk dinë se çfarë ka ndodhur atje. Ai ka zgjedhur që të mos dijë apo të mos i kujtohet. Dëshmitari mohon dhe demanton rolin e tij të bulonit (pjesë e makinerisë ushtarake v.p.) në tërësinë e makinerisë së kimit të organizuar shtetëror të pastrimit etnik, të kryer më qëllim që një territor në tërësi të pastrohet nga njerëz të padëshirueshëm, emra atë padëshirueshëm, gjuhës së padëshiruar; të krijohet territor i pastruar, i pa emer dhe memec. Për ne kjo është dëshmi se në Kosovë gjatë bombardimeve nuk ka qenë pa pushtet por ka pasur arbitraritet (vetëgjyqësi), nuk ka qenë anarki por ka qenë sistem. Zyrtarët shtetëror ose shërbyesit e shtetit gënjejnë jo vetëm për shkak të interesit personal por edhe për interes të shtetit të cilin dëshirojnë ta mbrojnë. Të gjithë këta respektojnë vetëm një ligj, ligjin e pafytyrësisë së një gënjeshtre. (4-8 qershor 2007)

Dëshmitarja Vera Petkoviç, nëna e të akuzuarve Zoran dhe Miroslav Petkoviç, ka thënë: „Për fatkeqësinë e familjes Berisha mua asgjë nuk më është e njohur, sepse nga vendi i përmendur unë banoj larg.“

„Nuk me kujtohet se ka pasur të shtëna, asgjë e pa zakontë nuk ka qenë që të më interesoje.“ Ka thënë njëri nga policët dëshmitarë. MPB e Serbisë po gënjen. Detyra e tyre profesionale ka qenë të vrasin, përndjekin sa më shumë Shqiptarë dhe për këtë të mos dinë asgjë më vonë. Gënjeshtria ka qenë, është bërë dhe ka mbetur njëra ndër profesionet e përkryera të cilën e kanë ushtruar. Një dëshmitar, zyrtar i lartë shtetëror ka thënë se nuk e di se a ka pasur polici tjetër në Prizren: “kam dëgjuar se ekzistojnë PJP (njësit e veçanta të policisë v.p.)”. Dëshminë e tij e ka përfunduar me fjalët: “Njësia e ime nuk kanë vrarë, ajo e ka kryer me ndërgjegje dhe përgjegjësi punën e saj.” Po, të gjithë e dimë këtë, me ndërgjegje dhe përgjegjësi e kryejnë punën e vetë, kur policia ka qenë në pyetje, ka qenë dëboni ose vritni sa më shumë shqiptar. Detyrë e veçantë e tyre ka qenë pastrimi etnik i popullsisë shqiptare nga Kosova. Nga Kosova gjatë vitit 1999 janë përzënë/dëbuar rreth 960.000 Shqiptar. (2-5 korrik 2007)

Sulmi në mbrojt-sit-set e të drejtave të njeriut

Para se të filloj procesi gjyqësor, avokatët e mbrojtjes kanë kërkuar të përjashtohet kryetarja e trupit gjukues. Gjithashtu, avokaten e mbrojtjes me çdo kusht janë përpjekur që ta diskreditojnë Natasha Kandiç, duke e propozuar si dësh-

mitare në mënyrë që të mos mund të merr pjesë në proces.

Mbrojtja ka tentuar që ta diskreditojë edhe avokatin e të dëmtuarve Dragolub Todoroviq, me fjalët kush ia ka dhënë autorizimin.

Në vazhdim, mbrojtja ka vazhduar me sulmin verbal ndaj Natasha Kandiç: Ajo nuk ka arsimim në drejtësi, nuk e ka të dhënë provimin e jurisprudencës, ajo nuk është eksperte, nuk dinë të parashtroj pyetje, kërkojmë që ajo të largohet nga kjo gjykatore... Kjo është një dëshmi që në këtë vend sulmohen mbrojtësit e të drejtave të njeriut, siç është Natasha Kandiç, si janë Gratë në të zeza, e jo kriminelët. (2-5 tetor 2006).

Goran Petrenjoviq, avokati i mbrojtjes, përsëri ka provuar që ta diskreditojë të autorizuarën e të dëmtuarve Natasha Kandiç, por ajo është përgjigjur se është avokate dhe se profesionalizmin e saj e ka dëshmuar në lëndën e Grupit të Gjakovës më 1999. Përsëri Goran Petronijeviq e sulmon Natasha Kandiç, por ajo përsëri i përgjigjet se si ai është dëshmuar/ treguar në gjykimin e Grupit të Gjakovës, kur ka thënë: “më vetë faktin se është e pamundshme që të dëshmohet fajësia individuale, që të gjithë ju jeni përgjegjës kolektivisht.”

Avokati i mbrojtjes Goran Petronijeviq përsëri provoi që ta diskreditojë Natasha Kandiçin: “Ajo nuk dinë të parashtroj pyetje”. Ai shton se policia i ka kthyer popullatën nëpër fshatrat e tyre. Natasha Kandiç tha se: “.. po njerëzit janë kthyer mbrapsht në 14 prill 1999, por janë ndaluar në Mejë, më 27 prill dhe se janë masakruar (7-9 nëntor 2006).

Prokurori Vitoroviq padinë e tij e sqaron ashtu që vë në pah faktin se përgjegjësia ndaj viktimave është mbi çdo përgjegjësi. Ai është shumë i durueshëm dhe se përpiqet shumë që dëshmitarët të i sjellë situatë që të tregojnë gjithë çfarë dinë për rastin për të cilin gjykohen. Të autorizuarit e të dëmtuarve, avokati Dragolub Todoroviq dhe Natasha Kandiç insistojnë në atë që të zbulohen numër sa më i madh i hollësive / detajeve që janë në lidhshmëri me situatën në Suharekë. Natasha Kandiç me këmbëngulje insiston edhe në rastet tjera, gjithashtu në vrasjet masive të Shqiptarëve të Kosovës, por është e ndërprerë si nga ana e avokatëve mbrojtës ashtu edhe nga kryetares së trupit gjykues. Trupi gjykues sikurse nuk dëshiron që e vërteta për vuajtjet dhe viktimat e tjera të nxjerren në pah gjatë këti procesi (5- 9 mars 2007).

Familjarët e të dëmtuarve dhe gazetarët nga Kosova komentojnë sesi vërehet ndryshim në punën e trupit gjykues. Në fillim kryesuesja e trupit gjykues është përpjekur që të zbuloj se çfarë në të vërtetë ka ndodhur, ndërsa tash sillet sikur dikush e ka stopuar. Prokurorëve nuk iu lejojet që dëshmitarëve të iu parashtrohen pyetje të drejtpërdrejta, por prokurori duhet që këtë ta bëjë përmes saj si kryetare e trupit gjykues. Kryetarja e trupit gjykues sikurse përpiqet që dëshmitarët të thonë/ tregojnë sa më pak informata që do të mund ta dëmtonin shtetin e Serbisë (2-5 prill 2007).

Vizita Vendeve ku janë Kryer Krime në Emrin tim

Nga Lilana Radovanović

Unë quhem Lila, dhe unë jam aktiviste e Grave në të Zeza - Beograd që nga viti 2000. Është kjo koha kur filloi rezistenca ime aktive ndaj regjimit kriminal të shtetit të Serbisë, udhëhequr nga Slobodan Millosheviq. Deri atëherë unë kam kundërshtuar çdo gjë që është duke u bërë në emrin tim; unë nuk e aprovova dhe ndjehesha fuqimisht kundër asaj të keqe, dhune, fashizmi, militarizmi dhe klerizmit të rritur të shoqërisë dhe shtetit, që kishte gëlltimit vendin tim.

Unë kam lindur në një fshat afër Beogradit dhe, fatmirësisht, gjyshi dhe vëllai im ishin liruar nga shërbimi ushtarak, prandaj ata nuk morën pjesë në asnjë luftë. Prandaj, në fëmijërinë time unë jam kursyer nga tregimet e luftës; ku meshkujt krenohen për aventurat e tyre, qoftë gjatë luftës apo në baraka, si vartës të eprorëve të tyre dhe yjeve të tyre të metalta në shiritat e krahut. Në fund të viteve të shtatëdhjeta, filloi një çmenduri nacionaliste, e lansuar nga Akademia e Shkencave dhe Arteve, që bënte thirrje për krijimin e Serbisë së Madhe me sloganin "Të gjithë serbët në një shtet." Fillova të strehoj ankth, frikë dhe tmerr sepse krismat e armëve kishin filluar; kërcënimet ishin artikuluar mbi "të tjerët" dhe "ata më ndryshe." Thjeshtë ndjeja që Jugosllavia nuk do të shpërndahej në mënyrë paqësore dhe fatkeqësisht kjo u bë e vërtetë. Të gjithë ishim dëshmitarë të egërsirave që pasuan.

Meqë unë isha rritur në një frymë antimilitariste, me idenë se të gjithë njerëzit janë të barabartë pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, kombëtare, racore dhe fetare, unë nuk u dorëzova në atë histeri nacionaliste që kishte përshkuar Serbinë. Po ashtu, mediati në masë të madhe e ndihmuan shpërndarjen e urrejtjes racore, fetare dhe etnike, ashtu që të tjerët ishin shpifur, çnjerëzuar dhe shpallur armiq. Makineria shtetërore e propagandës luftënxitëse na çonte porosinë se "të gjithë na urrejnë dhe dëshirojnë të na shkatërrojnë." Ata që vijnë nga Serbia që ishin të një mendimi të ndryshëm trajtoheshin si armiq më të mëdhenj sesa e tërë bota, të cilët, sipas televizionit shtetëror, ishin "duke përgatitur komplot kundër tërë popullit serb."

Së pari, për shkak të mendimeve të mia politike, unë hyra në konflikt me të afërmit e mi dhe pastaj me tërë rrethin. Pastaj, në një pikë kohore, në vitet e nëntëdhjeta, shumica e njerëzve të rrethit tim ishin kundër regjimit të Slobodan Millosheviqit, por motivet tona nuk ishin të njëjtë. Për ta, ai ishte fajtor or mjerimin, varfërinë, urinë, inflacionin dhe papunësinë; unë isha i tërbuar sepse ai organizonte dhe urdhëronte krime. Njerëzit kidnapoheshin nga trenat, torturoheshin dhe vriteshin; njerëzit dëboheshin nga shtëpitë e tyre për shkak se kishin emra të ndryshëm. Te Gratë në të Zeza unë gjeta aleate, mike dhe motra në paqe. Me to, unë mund të bisedoj mbi ngjarjet në vazhdim e sipër; ne e kemi dënuar

regjimin Serb në solidaritet dhe unë e kam gjetur fuqinë që të flas me zë të lartë. Unë më nuk isha e vetëm; unë gjeta persona që mendonin si unë. Ndjehesha mirë dhe mund të artikuloja idetë e mia më zë të lartë dhe publikisht. Në mjedisin tim, unë isha një e huaj që doli nga konsensusi fetar dhe kombëtar. Unë isha njeri që nuk përshtatej që nuk i mbronte “tonët” por “ata.” Unë isha një e huaj, një armike dhe tradhtarë për kombin serb dhe popullin serb.

Gjatë luftës, Gratë në të Zeza kanë vizituar vendet problematike dhe zonat e prekura nga lufta. Udhëtimi im i parë në një lokacion të krimit që ishte kryer në emrin tim ishte në Srebrenicë në vitin 2002, kur neve nuk na u ndalua hyrja nga policia e Republika Srpskës. Në shtator të vitit 2002, ne udhëtuan për në Sarajevë. Para pamjeve të shtëpive të rrënuara, dritareve të thyera nga predha të mortajave, ndërtesave të zeza dhe me vrima plumbash, unë u pushtova nga një ngërç dhe u mbulova me turp dhe përlulje. Fillova të dridhem dhe të qaj. Jadranka më tha, “Qetësohu. Ti nuk ke bërë asgjë.” Unë e di së nuk kam bërë asgjë, por a kam mundur të bëj më shumë që ta parandaloj këtë?

Ne udhëtuan me autobus me gratë që vijnë nga njëzet qytete në Serbi. Ne ikëm shumë herët. Ka zhurmë dhe biseda, “Lila, ma jep një sandviç .” “Ma sjell ujin të lutem.” “Kur do të bëjmë një pauzë për cigare dhe kafe...” Pastaj arritëm në Srebrenicë. Ne u afruam në Qendrën Memoriale ngadalë dhe qetë. Njerëzit na lëshonin rrugën, na afroreshin, na falënderoheshin për ardhje dhe komentonin, “Këto janë Gratë në të Zeza; ato janë me ne.” Unë i përcjell gratë tona. Askush nuk flet. Vetëm dënesat e thyejnë qetësinë. Askujt nuk i pengon vapa e korrikut. Fëmijët afrohen me lëngje dhe ujë. Diçka me kaplon; ndjenja të turpit dhe të fajit; bëhet edhe më e vështirë që të përballohet kjo ndjenje kur e shoh se na respektojnë. Unë vazhdoj të përsëris, pse, pse, pse, kush janë këta përbindësia, kush ka mundur ta mendojë, ta urdhërojë dhe ta kryejë një krim të tillë? Në të gjitha hymë në autobus në qetësi dhe pritnim nisjen. Senka qante dhe e pyeta pse tani, çka ndodhi, dhe ajo më përgjigjet, “Kjo është e tmerrshme. Shiko, fëmijët janë duke na bërë me dorë, dhe mund ta shohin autobusin dhe të dinë se prej nga jemi.” Nuk ka biseda. Askush nuk kërkon asgjë. Ne të gjitha psherëtimë pa fjalë, duke menduar për dhimbjen e familjeve që i takuam. Kjo është ajo që ndodhin kur ne e vizituar Srebrenicën, Prijepolen, Pribojin, Vishegradin, Tuzllën... Unë kam qenë në Prijepolje dy herë, në përkujtimin e krimeve në ShtRPCi, kur 19 civilë të nacionalitet boshnjak u kidnapuan nga treni, u torturuan dhe u vranë. Më kujtohet procesioni gjatë qytetit dhe ne duke mbajtur flamuj që lexonin: “Ne e mbajmë në mend” dhe “Për të gjitha viktimat e luftës.” Pastaj ne hodhëm trëndafila të bardhë në lumin Lim. Dhimbja dhe vuajtja e familjeve të viktimave mbeten të unë për një kohë të gjatë. Unë e vizitova Pribojin një herë, në përkujtimin e krimit të Sjeverinit, kur 16 udhëtarë, po ashtu të kombësisë boshnjake, u nxorën nga autobusi dhe u vranë. Përsëri, trëndafila të bardhë dhe lumi Lim. Pasqyra e nënës dhe babait dy djemtë e të cilëve u

vrane është e ngulitur në kujtimin tim. Në Vishegrad, në “Urën e Drinit,” lumi i bë i kuq me 3,000 trëndafilat që u hodhën në valët e tij të gjelbra për tre mijë personat që u hodhën në lumë. Përsëri, në pritemi me mirëseardhje dhe përzemërsi nga njerëzit me të cilët ulemi në varrezat myslimane. Unë e kam vizituar Tuzllën dy herë. Herën e parë ishte në përkujtimin e përvjetorit të masakrës në qendër të qytetit, kur një predhë mortaje u lansua nga ushtria serbe dhe vrau 72 civilë në maj të vitit 1995. Pasqyra e atyre 72 varreve akoma rri pezull në sytë e mi. Herën e dytë, unë e vizitova Tuzllën me ftesë të grave të Srebrenicës, ku ne, Gratë në të Zeza, u bashkuam me to në një procesion përgjatë rrugëve të qytetit. Ishte me rastin e protestës që gratë e Srebrenicës e organizojnë çdo të 11-in e muajit, në shenjë përkujtimi të gjenocidit. Secila nga ne mbante një copë stofë që kishte në të qëndisur emrin e anëtarit të vranë të familjes. Me gratë e Srebrenicës ne monitoruam gjykimin e “Shkorpionëve,” dhe unë shpenzova shumë kohë me to ndërmjet dhjetorit të vitit 2005 dhe prillit të vitit 2007. Çdo vit, një tjetër grua e gjen veten në një lokacion të ri të krimeve dhe kalon nëpër katarsizë.

Feminizmi im më lejon që të zgjedh se për kë do të përkujdesem dhe kë do t'i gjykoj si njerëz “të mi”, si zgjidhje personale dhe jo si zgjidhje që më është imponuar nga lindja apo gjaku.

Unë sinqerisht besoj në një politikë të të kërkuarit falje për krimet që janë kryer në emrin tim. Unë i shoh vizitat e mia në lokacionet e krimeve si një akt i solidaritetit me viktimat e atyre krimeve, si një shprehje e respektit për viktimat dhe si mënyrë e të kërkuarit falje për krimet e kryera në emrin tim.

Është detyra ime që t'i adresohem komunitetit ku jetoj dhe të kërkoj përgjegjësi për ato krime, për të kërkuar që të gjithë të dyshuarit për krime të luftës të dorëzohen në Tribunalin e Hagës dhe që të gjithë kryerësit të gjykohen para gjykatave vendore, para Këshillit për krime lufte pranë Gjykatës speciale që është themeluar në Beograd në vitin 2003. Unë kërkoj që autoritetet të cilat janë duke i mohuar krimet e organizuara shtetërore të dënojnë krimet kundër njerëzimit dhe gjenocidit si akte kriminale.

Unë ndjehem që është shumë me rëndësi që, pas vizitave të tilla në vendet e krimin, t'i adresohem rrethit tim, të afërmeve të mi dhe miqve të mi dhe t'iu tregoj qartë se pse shkova unë atje dhe çka përjetova unë, me dëshirë që kjo e keq të mos ndodhë kurrë më.

Arti i rezistencës: Motivet, Simbolizmi dhe Simbolet në Estetikën e Grave në të Zeza

Nga Nevenka Marinković dhe Snezhana Tabački

Gjatë 16 viteve të vigjiljes në hapësira publike, marshe, protesta, performanca, publikime dhe edukime, Gratë në të Zeza simbolikisht kanë përfaqësuar të gjitha tmerret e luftës, krimet, nacionalizmit, militarizmit dhe iluzioneve si dhe vlerat e së vërtetës. Format elementare të estetikës së tyre autentike, të përshtatura si duhet, janë akoma të gjalla sot. Në këtë tekst, ne do t'i përmendim disa nga motivet, simbolet, ngjyrat, vizatimet dhe përbërjet të cilat përsëriten dhe do të tregojmë praninë dhe natyrën e simboleve në artin e Grave në të Zeza.

Teshat e zeza dhe të zisë

E zeza është magjike, e panjohur, melankolike, joracionale, pikëlluese, por edhe spirituale dhe substanciale. Duke e zgjedhur të zezen, ngjyrën që përfaqëson trupin e munguar, fiks dhe të heshtur të gruas të veshur në të zeza, si simbol i përhershëm, aktivistet kanë mohuar dhe hequr dorë nga domethënia e zakonshme e të zezës dhe kultit të vdekjes, njëkohësisht duke dërguar një porosi të qartë dhe të dukshme kundër vdekjes, vuajtjes, brutalitetit të luftës, çmendurisë kolektive dhe refuzimit dhe harresës së krimeve. Kjo e zeze bën thirrje për rezistencë të plotë, konkrete dhe të organizuar të politikës së luftës, nacionalizmit, militarizmit dhe sistemit patriarkal.

Shenjat e paqes dhe dega e ullirit

Në kohët e lashta, degët e ullirit janë konsideruar si simbole të mençurisë, paqes, pasurisë dhe festimit. Grupit artistik Shkart ka kombinuar degën e ullirit me një simbol të stilizuar femëror në prapavijë të zeze. Ky simbol është miratuar nga grupet tjera të Grave në të Zeza kudo në botë.



Dora e Fatimes

Dora e Fatimes është simbol i përdorur shpeshherë. Filloi të përdoret në Izrael. Është i thjeshtë dhe ka dimension paqësor në kontekst dhe shprehje. Për gratë në të zeza, ai simbolizon paqen, solidaritetin global të grave dhe ruajtjen. Disa herë ky motiv kombinohet me porosi kundër luftës.

Qarku (Qëndrimi në një qark, Performanca e qarkut)

Në estetikën e Grave në të Zeza, qarku është simbol i lidhjes së njerëzve dhe bashkësisë, ndjenjës së keqardhjes dhe solidaritetit me të gjitha viktimat e luftës dhe dhunës.

Ngjyrat e ylberit dhe flamujt e paqes

Gratë në të Zeza përdorin ngjyra të ylberit që prodhojnë dritë. Shumë civilizime identifikojnë ngjyrat me dritë. Flamujt e Grave në të zeza përdoren në këtë mënyrë, por vetëm japin një përshtypje kromatike. Ngjyrat e ylberit simbolizojnë paqen dhe dritën, harmoninë dhe marrëveshjen, por edhe idetë mbi dallimet dhe llojlojshmëritë, shtimin e ngjyrave, nevojën për të jetuar dhe respektuar jetën individuale, për të ndryshuar gjërat dhe për të filluar përmirësimin.



Pistoleta, palltoja ushtarake dhe helmata

Pistoleta, palltoja ushtarake dhe helmata si simbole ushtarake, janë pjesë e estetikës së luftës. Duke përvetësuar dhe deformuar këto objekte, Gratë në të Zeza bëjnë një deklaratë ironike mbi militarizmin që na rrethon. Ideja është që këto subjekte të jenë të padobishme. Ato përdoren për të promovuar dhe përkrahur deklaratat, parime dhe praktika antimilitariste.

Vizatimet e stilizuara - Picasso dhe Matisse

Shpeshherë në publikimet dhe posterat e Grave në të Zeza përdoren vizatime të artistëve të falshëm apo të panjohur. Për shembull, është e njohur se Picasso, pas vitit 1945, popullarizoi shumë variante të motivit të pëllumbit të bardhë të paqes. Më së shpeshti ishte figura e thjeshtë e gruas - pëllumb. Kjo u bë imazh i njohur në fanellat e Grave në të Zeza.

Një motiv i njohur dhe i shpeshtë i Matisse është femra lakuriq. Është zvogëluar në një formë të rëndësishme, simbolike që duket sugjestive, por në të vërtetë është vetëm e përpunuar dhe e thjeshtësuar. Në deklaratat e tyre, "Gjithmonë e pabindur," Gratë në të Zeza përdorin



motivin e një përbërje të Matisse, të punuar fillimisht në një ekran japonez, të femrave lakuriçe duke u mbajtur për duar, duke e formuar një Rreth që simbolizon përkrahjen dhe solidaritetin e grave.

Kuvarice (Formë tradicionale e zburimit emri i të cilës do të thotë 'Gjellëbërëse')

Kuvarice janë stofa të qëndisur, që janë varur në kuzhinat e gjysheve tona. Çdo mëngjes, kuvarice i përkujtonin ato mbi rolin e tyre si gjellëbërëse, nëna dhe rojtare të moraleve patriarkale. Gratë në të Zeza e njohin kuvarice, i kanë përvetësuar ato dhe i kanë riprodhuar, duke e imituar stilin, por duke shkatërruar kontekstin. Krahas etikës morale, ato drejtpërdrejt transmetojnë porosi anti-patriarkale.

Slogane protestimi

Së fundi, kur flasim për artin unik dhe të njohur të estetikës së rezistencës që promovojnë Gratë në të Zeza, nuk mund t'i tejkalojmë flamujt dhe sloganet që barten gjatë vigjiljeve protestuese. Zakonisht, ato nuk tregojnë gëzim, por rebelim, dramë njerëzore dhe tragjedi. Veç kësaj, porosi të shumta janë krijuar dhe shkruar në letër, tekstil, alfat, mure dhe dru, me tekstile të ngjyrosura, bojë tempera, shkumës, dhe fije të qëndisura, në të shkruar latine dhe cirilike në gjuhë të ndryshme (përfshirë shqipe, hungareze, arabe, angleze dhe serbe), në lloje të ndryshme të letrave, në bardh e zi apo me ngjyra dhe në formate të ndryshme (nga madhësia e flamujve dhe posterave që do të barten, nga një, dy apo madje dhjetë persona), disa herë artistikisht të papërkryera por disa herë të patëmeta.

Gjithashtu duhet të theksojmë bashkëpunimin tonë me grupet artistike që përfshijnë teatrin Dah, Institutin për teatër të angazhuar, Shkart, qendrën për dekontaminim kulturor dhe Stani Pani Collective. Kombinimi i përvojave të ndryshme me poezi, dizajn grafik, arkitekturë, performanca, spektakle rrugore, teatër, pantomimë dhe tinguj që shqetësojnë dhe qortojë këto grupe kanë sjellë ide të reja.

Me Gratë në të Zeza, ata kanë krijuar një rezistencë aktive, bashkëkohore estetike kundër luftës.





Lista e pjesëmarrësve

Nr.	Emri	Organizata	Vendi
1	Rabë Rrustemi	Antigona	Skënderaj
2	Marija Perkovic	Gratë në të Zeza	Vrbas
3	Milena Stefanovic	Lepsa Buducnost	Priluzje
4	Ljiljana Radovanovic	Gratë në të Zeza	Beograd
5	Resmije Tahiri	Safe House	Pejë
6	Merita Halitaj	One to One - Kosova	Prizren - Pejë
7	Beti Muharremi	Open Door (Dera e Hapur)	Prishtinë
8	Igballe (Igo) Rogova	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë
9	Meli Osmani	Legjenda	Viti
10	Sevdije Bunjaku	Kalabria	Prishtinë
11	Svetlana Trajkovic	Gratë në të Zeza	Preshevë
12	Mihane Ahmeti	Gratë në të Zeza	Preshevë
13	Svetlana Saric	Gratë në të Zeza	Vlasotince
14	Nada Dabic	Esperanca	Novi Sad
15	Marte Prenkpalaj	Motrat Qiriazzi	Has - Prizren
16	Alba Loxha	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë
17	Nexhmije Cuca Fetahu	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë
18	Besa Shehu	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë
19	Remzije Asllani	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë

Nr.	Emri	Organizata	Vendi
20	Nicole Farnsworth	Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës	Prishtinë
21	Radosava Mirkovic	Lepsa Buducnost	Priluzje
22	Memnuna Zvizdic	Zene Zenama BiH	Sarajevë
23	Selvete Gashi	Lulebora	Prishtinë
24	Drita Vukshinaj	Handikos	Prizren
25	Rachel Long	Gratë në të Zeza	Beograd - Seattle
26	Veprora Shehu	Medica Kosova	Gjakovë
27	Ida Udovic	Kvinna till Kvinna	Kosovë
28	Biljana Sipcic	Gratë në të Zeza	Vrbas
29	Christina Wassholm	Kvinna till Kvinna	Beograd
30	Staša Zajovic	Gratë në të Zeza	Beograd
31	Biljana Kovacevic - Vuco	YUCOM	Beograd
32	Haya Shalom	Gratë në të Zeza - Israel	Israel
33	Nevzeta Josifovic	Gratë në të Zeza	Beograd
34	Milos Urosevic	Gratë në të Zeza	Beograd
35	Marina Nikolic	Gratë në të Zeza	Krusevac
36	Jovanka Brkic	Gratë në të Zeza	Velika Plana
37	Snezana Djordjevic	Gratë në të Zeza	Krusevac
38	Mirjana Rasic	Gratë në të Zeza	Zajecar
39	Gordana Stoilkovic	Gratë për Paqe	Leskovac

Koalicioni i Grave për Paqe

Nr.	Emri	Organizata	Vendi
40	Jasmina Stevanovic	Gratë në të Zeza	Zajecar
41	Besa Selimi	Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore	Prishtinë
42	Teuta Hyseni	Përkthyes	Prishtinë
43	Emina Demirovic	Përkthyes	Prishtinë
44	Arben Fetahu	Përkthyes	Prishtinë
45	Hyjnor Jasiqi	Përkthyes	Prishtinë
46	Slavica Stojanovic	Gratë në të Zeza	Beograd
47	Ajshe Nuhiu	Vita - Jeta	Prishtinë
48	Jasmina Mitrovic	SoS Vlasotince	Vlasotince
49	Nizama Bruncevic	Urbanin & Gratë në të Zeza	Novi Pazar
50	Ranka Ivanovska	Gratë në të Zeza	Vrbas
51	Milka Rosic	Gratë për Paqe	Leskovac
52	Nevena Kostic	Gratë në të Zeza - Gratë për Paqe	Leskovac
53	Ariella Futral	Urgent Action Fund	USA
54	Violeta Selimi	ODA	Prishtinë
55	Tahire Gashi	Zana	Klinë
56	Lidija Pajovic	Gratë në të Zeza	Nis
57	Shemsije Seferi	Alma	Pejë
58	Ljiljana Nestic	Gratë për Paqe	Leskovac
59	Rachel Wareham	Motrat Qiriazzi	Austria
60	Snezana Obrenovic	Gratë në të Zeza	Kraljevë

Përmes Solidaritetit të Grave deri tek Paqja e Drejtë

Nr.	Emri	Organizata	Vendi
61	Snezana Tabacki	Gratë në të Zeza	Beograd
62	Nafije Latifi	Jeta - Vita	Prishtinë
63	Advije Gashi	Norma	Prishtinë
64	Melihate Misliu	Aureola - Struga	Strugë
65	Gyli Beqiraj	RTV 21	Prishtinë
66	Osnat Lubrani	UNIFEM	
67	Flora Macula	UNIFEM	Prishtinë
68	Nurije Zhaku	Aureola - Struga	Strugë
69	Lepa Mladjenovic	Autonomous Women's Center	Beograd
70		RTV 21	Prishtinë

